

S T E F A N M A R T I K O

P A R A S E T Ë B Ë H E T N A T Ë . . .

T I R A N Ë , 2 0 1 9

AUTORI: STEFAN MARTIKO

TITULLI I LIBRIT: PARA SE TË BËHET NATË...

REDAKTOR: JOSIF PAPAGJONI

FAQOSJA: ANDREA LLUKANI

NË VEND TË PARATHËNIES

Para se të shkruaja te ky libër dhe gërmën e fundit më kapi një frikë e tmerrshme mos më digjej i tëri nëpër duar dhe unë nën flakët e tij po bëja harakiri. Kisha shumë ftohtë dhe më dukej se sa herë e shfletoja librin cipat e akullit binin një nga një si brymë mbi atë që brenda tij ishte gjallë akoma. Më trembte dhe më tepër fakti se prej tij vinin shumë zëra njëherësh dhe jo një zë i vetëm. E kisha përfytyruar thjesht si një trokitje për të hyrë brenda një tëpanjohure. Por zërat e tij i dëgjoja si prej nëndheut dhe një çast mendova se mos ky libër më qe shndërruar në një varrezë fjalësh. Ja pse nxitoj tani para fundit t'i jap atij thjesht një certifikatë vdekjeje. Që përmban brenda edhe faljen e madhe për atë që nuk kisha mundur. Sepse shkruarja e një libri arrihet vetëm përmes torturës dhe mëdyshjeve që do ta lenë atë përherë të papërfunduar. Për mua kish qënë para së gjithash detyrim mbajtja e një premtimi ose larja e duarve prej një borxhi që nuk do ta mësoja kurrë se ndaj kujt e kisha patur. Ky libër qoftë edhe si kjo lule që rritet në ballkonin tim vetëm shton indiferencën e kësaj bote e cila në pellgjet e saj të gjakut përpëllitet. Një libër që më mirë të mos ishte shkruar, por njeriu peng i një pasioni të çmendur nuk guxon kurrë të shkojë në tempull për të kërkuar këshilla. Dhe kjo ka qënë burim i tërë marrëzive njerëzore, gjer te Don Kishoti që i paraprin kësaj turme vetëm e vetëm për të thyer në dyluftime imagjinare

shpatat e ndryshkura. Kjo krijesë që sapo doli prej mendjes së mitrës nga askush, as prej krijuesit të saj nuk do të pritet me lule, bile enkas ajo nuk do të ketë as ditë lindjeje. Duke paragjykuar gjithçka në të është shkruar, krijuesi do të anatemohet sepse s'arriti kurrë të bëhej zëri i të gjithëve. Në këtë libër duket sikur unë jam banor i vetëm i kësaj shtëpie që pas pak do të mbyllet me çelës e ndoshta kurrë më s'ka për tu hapur. Por prej gjithë mundit tonë të përbashkët në krye të arës vetëm një thes me gurë do të jetë mbledhur. Më tremb edhe më tepër çasti kur te kopertina e këtij libri do jetë dikush duke pritur ndihmë për të marrë prej andej këshillën e fundit, kur nuk ka gjetur asnjë mundësi tjetër shpëtimi. Meqënëse unë jam vetë mamia dhe ligji që identifikon lindjen, do të jem unë përsëri i vetëm që do ta çoj atë në varrezë të vdekur. Hyrja për te ky libër duket që tani e mbyllur sepse prej zjarrit ka lindur e prej hirit të tij asgjë më s'ka për të mbetur. Siç po shihet ky fjalim ceremonial po zgjatet pafundësisht por vetëm nëpër pemët prej ballkonit shoh ndonjë zog që mbi gjethen e vet në shenjë nderimi ka ndalur. Lëvizja tjetër njerëzore vazhdon pandërprerë sepse në të vërtetë asgjë nuk ka ndodhur, thjesht po varrosen me këtë ceremoni vetëm ca fjalë të gjuhës për të dhënë shenjë se u thye dhe shpata e fundit e ndryshkur.

6.8.19

PARA SE TË BËHET NATË

Drita po tërhiqet ngadalë duke na lënë edhe pak kohë sa të vendosemi në gjysmerrësirën për të kapërcyer përfundimisht ylberin e dritës. Duhet të bëhemi gati për tu zhytur në errësirë. Muzgu, ky prag i ndritshëm i natës ka për të na falur edhe atë pak kohë që na duhet të miqësohemi pa dhimbje me natën. Aty ku do të na braktis drita do të hapet një dritare për të hyrë ëndrrat. Do të nisim një jetë tjetër nën të cilën do të flejë edhe guximi ynë i trembur. Edhe mëkatet që nxitojnë për tu fshehur para se të dalin natën si fantazmat. Është një prag ku dikush është duke na përshëndetur me një shami e cila ndërron në çast ngjyrat gjersa bëhet krejt e padukshme. Drita na kish dhënë fuqinë dhe arsyen, nata do të japë gjykimin që vjen prej zotit të çdonjerit, i cili në errësirën e vet sapo e ka shpikur. Do të zgjedhim këmbën me cilën do të kapërcejmë pragun e muzgut. Dhe sa shumë që jemi lodhur duke tërhequr këtë litar që sa herë u bë gati të këputej. E ulëm në gjunjë tanë edhe arsyen dhe nisëm të numërojmë me gishta atë që krijuam dhe çfarë na kishin rrëmbyer të tjerët. Sepse i vjen radha një gjykimi tjetër ku në nënvetëdijet tona lufta e madhe sapo ka nisur. Ç’kemi bërë është e dënuar të qëndrojmë tërë natën nën tempull. Aq sa një çast do na duket se ëndrrat janë e vërteta dhe jo realiteti të cilin neve në fund të ditës e kishim braktisur. Nata bëhet kështu gjyqi i ditës dhe njeriu duar e këmbëlidhur nën këta vargonjë do të

përpëlitet. Veprat e mira mbeten atje lart për t'i sjellur dritën ditës tjetër. Luftën e kemi me të keqen për tu bërë ajo sprovë më e papërballueshme. Gati dhe trekëndshat atë për ta varur. Para se të bëhet krejt natë do të kapërcejmë këtë ylber gjersa harku i tij krejt të jetë këputur. Dhe yjet që do të dalin një e nga një me dritën e tyre që nuk mjafton as për të ndriçuar vetveten. Gjithçka rrodhi me dritën e ditës tani nis të bëhet e pashpjegueshme. Po vjen koha e iluzioneve dhe ëndrrave. Shpirti nis të jetojë ndërsa trupin është duke e kotur gjumi. Prova e vërtetë e njeriut tek po merrë nën gjykim ekzistencën. Filtra të hollë ku mbeten sipër shumë paqartësira. Përsëri kishim gabuar diku, në një hap, në një fjalë për të ardhur te nata e gjatë e pendesës. Aty ku drita u nda prej errësirës së saj e cila po shkon drejt një gjyqi të tmerrshëm. Fatlumët do shohin ëndrra të bukura kurse mëkatarët nëpër konvulsione do të ulërijnë/ rënkojnë/ tërë natën.

Gusht, 2019

TË PARËT E MI

Si kanë qënë vallë ata, të shkurtër, të gjatë, rondokopë, gjaknxehtë, të dashur, të etur, prej vdekjes të trembur? Tani që shoh gjurmët e fundit të rrënojave të shtëpive ku ata jetuan historia nuk është e aftë të më tregojë ç'fat i keq atë e kish përshkuar. Përveç disa këngëve të mbetur nga ajo kohë dhe disa të dhënave prej defterëve turq , si dhe ca shënimeve të shkurtër të ndonjë udhëtari evropian që andej kish kaluar rastësisht. Dhe tjetër pothuaj asgjë s'ka mbetur. Muret e fshatit të vjetër u shkatërruan prej vandalëve dhe me gurët u kryen disa ndërtime publike sikur malit t'i ishin sosur gurët. E shkuara e përdhunuar; ajo edhe më keq vdiq te pjesa e vetme e gjallë e mbetur. Kjo është ana tragjike që të çidentifikon pa njohur akoma mirë veten. Të parët e mi. Sa do të doja këtë çast t'i kisha njohur përmes fytyrave, të folurit, zakoneve e shumë fakteve të tjerë me të cilat mbushet zakonisht historia. Në kujtesën time ka aq pak fakte sa është tepër e vështirë të operosh përmes tyre për të ndërtuar të shkuarën tënde. Unë as që nuk e di pse jam brun, pse flas kaq i përmallur për ata gurë që ndërtuan shtëpitë e gjyshes sime Lulë, për barin dhe lulet që kanë një aromë tjetër, për kërmijnjtë dhe boblat që gëlonin pas shiut të verës nëpër rrëpirat e maleve rreth e rrotull. Po si mund të ndërtohem unë prej tyre kur kam vetëm tre emra historikë te të cilët janë kapur breza të tërë. Poemës sime do t'i mungojnë përherë shumë pjesë, ndërsa kujtoj tani fragmente të shkëputur prej së vetmes poemë epike që ishte ruajtur me fanatizëm, njëlloj si amanetet e fundit të

çdo të vdekuri që këtu e 250 vjet më parë. Një vajzë e rrëmbyer një mbrënje tek mbushte ujë te burimi prej ca kaçakëve të viseve të largët. Ndodhi romantike me rrëmbime e dashurishë të çmendura. Historinë e kësaj ngjarjeje e zbuloi poema që u përgojua por që kurrë s'arriti të shkruhej. Vetëm atëherë kur një vëlla i vajzës së rrëmbyer si një Konstandin i vdekur, do ta zbulonte atë prej një elegjie që vajza tashmë e martuar këndonte mbi djepin e djalit të saj.. E kishte thurur vet vallë si një barde e mbyllur në burgun e një bote të panjohur? / Të jesh-o të kesh-o /ujët e Mandukës-o/ Sha kryet e Dukës-o/. Duka do të ketë qënë vëllai i vetëm i vajzës. Këto vargje të një kënge që ka mbërritur pakëz më e gjatë mu bënë shpëtim për historinë, si vjega e vetme ku ne mund të kapeshim për të ndërtuar të shkuarën. Vëllai e dëgjoji këtë elegji përgjatë kërkimeve të tij për të gjetur motrën e tij të vetme të grabitur dhe, kështu kënga fitoi rol parësor në dinjitetin e përdhosur të historisë. Vëllai e rrëmbeu motrën bashkë me fëmijën e saj për tu mbyllur kështu një kapitull i historisë, i cili do të na ndihmonte për të ndërtuar një tjetër.

Të parët e mi. Veshur me tirqe e fustanella të bardha, trupvegjël e kërcimtarë të hareshëm. Sokrati i cili për fat të keq historia nuk e solli bashkë me mbiemrin e tij dhe Spiro Buti janë heronjtë e vetëm të kësaj lashtësie 260-vjeçare të cilët jetonin në kohën e romaneve të verdhë të Perëndimit. Një roman që dhe unë muind ta kisha shkruar për të pastruar gjakun tim prej rrjedhave gjenalogjike. Qofsh i artë ti çast i historisë që më ve në kërkim si udhëtar që të nis rrugën për të mbërritur gjer te Çezari. Por më parë duhet të kaloj përmes dy perandorive të mëdha të rrrëmujshme, ku dhe unë kam qënë në një farë mënyre pjesa e tyre.

12.1.09

MIQTË E EKRANIT

Njeriu që i pret zgjidhjet të gatshme para ekranit të TV-ve njëlloj sikur ta quante të përfunduar ciklin e vet, gjellë që ia përgatitin të tjerët dhe është i ftuar në tavolinë për t'i konsumuar ato pa shije. Po nuk dëgjove lajmet për oraret e trenave apo grevave që pushtojnë fiks në ora 10 x ose y rrugë, e drejta jote është rrëmbyer prej një tjetri. Te ekrani ku secili paguan që ta shohin të tjerët por që këta të tjerë do të paguajnë edhe më shumë nesër nëse nuk janë bërë ende miq të ekranit. Kjo ndërvarje e çuditshme mund të quhet pak a shumë fytyra e qytetërimit të sotëm i cili është i mbërthyer me gozhdët ku ka kryqëzuar veten. Unë nuk e ruaj më dot atë prej së keqes . Ajo tashmë është duke përgatitur recetat e gatshme që kërkojnë vetëm njëlloj përkujdesjeje; atë të zbatimit të rendit apo radhës së këshillave të cilat të lejojnë të shumëzohesh prej tyre. Një lloj bote e globalizuar që ka ndërhyrë kaq shumë te neve për të na nxjerrë prej vetes ku është ngritur në parim politika e zbatimit. Kryengritjet tani janë bërë kaq të panevojshme sepse më parë u pa dështimi i vet ëndrrave dhe i vizioneve. Ky kompromis i ri sollti një lloj paqeje që herë-herë bëhej e mërzitshme por nga ana tjetër janë shtuar medikamentet për shërimin e dhimbjeve të kokës. Nuk e dimë sa do zgjasë kjo lloj paqeje por instrumentet po sofistifikohen për të na vënë edhe më tepër në gjumë ndërgjegjet.

Janar, 2010

NJERËZ NË UDHË

Po shkoj drejt një njeriu por më mungon një mënyrë e caktuar sjelljeje. S'kam ç'bëj dhe duhet të shkoj por nuk është aq e lehtë t'ia përplasësh në fytyrë të gjitha. Dikush tjetër do të kish nxjerrë revolverin prej sirtarit dhe akti tashmë do ishte kryer. Unë jam plot dilema sepse për atje besoj se mund të shkohet përmes shumë rrugëve ose dhe përmes shumë kthesave e vendpushimeve si dilema që presin të zgjidhen. Sa të vështirë e kam të zgjedh njerën prej tyre e cila do të zgjidhte njëherë e mirë tërë dilemat e mia. Që më vonë të mos më sillte asnjë lloj pendese dhe kjo të quhej njëherë e mirë punë e kryer për së mbari, ose për së paku në mënyrën e vet më të mirë të mundshme. Kjo që bërë shkak i një vonese të gjatë njëlloj si moti i cili që prishur e ndrequr kaq herë gjatë rrugës. Unë do t'i them atij se kaq shumë kohë kisha ndarë me të mirësinë dhe keqardhjen, që kurrësesi unë s'e kisha lejuar të kthehej në urrejtje. Do t'i flisja për një rezultat që s'e kisha arritur kurrë se ç'është në të vërtetë njeriu. Më shumë vetja apo më tepër të tjerët. Në aktin e fundit dora e tij e kishte nënshkruar, por duart që e mbanin mbërthyer nuk dukeshin. Ky njeri do ma paguaj shtrenjt shqetësimin që më ka sjellur. Unë më në fund e lava borxhin ndaj vetëdijes e cila më nisi për ta zbatuar këtë urdhër. –Do ma paguash- i thash me një prishje të menjëhershme të kontratës. Do t'i le varur tërë shpresat e tua. S'do të jem më me ty në udhë. Nuk do të të pështyj megjithëse meriton edhe më shumë se kaq. Por këtë e tutje indiferenca ime do të jetë arma shkatërrimtare e iluzioneve të tua. Ti tani je duke vdekur brenda meje. Por mua ky fakt as më gëzon e as më hidhëron edhe nëse ti do të ndërsest demonë të tjerë kundër meje.

1.11.09

PËRBALLË TMERRIT TË FORCËS

E vetmja forcë që e shkatërron atë është indiferenca. Duke i bërë shkëmbit sfidë, duke e lënë lumin të përmytë gjithçka dhe pastaj i penduar të kthehet në shtrat. Forca e madhe që kërkon nga unë një përgjigje tjetër. Në përpjekje për ta mundur fuqinë e saj kam hapur një tunel dhe kjo ëshë lloji i një sfide tjetër. Indiferenca ndaj forcës më është dukur si një zgjidhje e mrekullueshme. T'ia kaloj asaj ujin nën rrogos dhe të ndjej fëshfërimën e krimbave si po e kalbin pak e nga pak trupin e saj. Ai është një përbindësh edhe kur na paraqitet thjesht si frymë. Atij i duhet lënë hapur porta të hyjë dhe ti pas hijes së tij të fshihesh. Ty thjesht të mbron vogëlsia jote përballë pushtetit të madh. Indiferenca jote nuk gjen dot mënyrë tjetër për ta mundur përbindshin. Mos i dëgjo fare këngët e Madonës për t'i shpëtuar dhe presionit. Është apo nuk është vallë një përbindësh? Por njëlloj edhe shpërbërja e tij si zemërimi i lumit. Një superfuqi që nuk kontrollon më dot veten. Dhe indiferentizmi im që vetëm sa i lëshon frerët. Por a s'jam dhe unë brenda saj njëlloj i rrezikuar për të përfunduar në gropë ku ajo po bie? Sfida ime është një zemërim i heshtur që mund ta urtësoj dhimbjen time. Unë kompesoj kështu mungesën e forcës, ajo që mungon për t'iu kundërvënë ballë për ballë titanëve. Të jetoj nën hisen time të diellit. Të praktikoj karatenë dhe Jogën. Të ngre lart një mijë antena për të zbuluar anët e dobëta të superfuqisë. Unë kam ca

mundësi të vogla që me shumë përkujdesje mund ta mundin forcën si kompesim të asaj që dhe unë dikur e kisha ëndërruar. Nuk rrëzohet kështu Qeveria e Madhe e Mosarsyes sepse dhe arsyja ime është mjaft e dobët. Dhe përdor mënyra çartiste atë për ta rrëzuar. Unë i ul perdet e mia herët dhe e kthej shtëpinë time në një univers të vogël por dikur dhimbja ime do të ulërij për t'i hapur asaj portën. Ajo nuk e beson dot që luftëtari t'i dorëzojë kaq shpejt armët. Ndoshta në mendjen time jam duke projektuar një varr shumë të vogël për perandorinë e madhe. Vetëm kështu mund ta kem urtësuar dhimbjen time. Unë kompesoj mungesën e forcës pët t'iu kundëvenë asaj me dinakërinë time. T ë jetoj nën hisen time të diellit. Unë kam vetëm ca mundësi të vogla që me pak guxim e kurajo mund të mundin fuqinë e paarsyshme të forcës.

15.5.14

NË NJË KËND TË UNIVERSIT

Të nisem tani nëpër natë në po atë rrugë por e di se nuk do të kem shoqërues tjetër përveç misterit. Madje edhe ende pa u nisur ethet më kanë mbërthyer. Si do ta çoj këtë trup tashmë 60-vjeçar që dikur e përshkoja pa kuptuar dhe që në mënyrën më mizore në kujtesën time e kisha futur. Janë jo një as dhjetë ditë që tani tani u bënë të panumërueshme. Kjo shtypje me këmbë të zbathura është tokamuku që rreh çdo ndodhi në kujtesë atë për ta shndërruar. Po e nis me Rrokullimën, vendi i parë historik i udhës ku ne prisnim mbrëmjen dhe një karvan kuajsh që mbartnin etërit tanë. Njëlloj si te Folkneri, tanimë realiteti i asaj që po ndodhte të kuptohej se i përkiste një kohe tjetër. Në fakt tani unë nuk e përshkoj dot udhën por vihem në ndjekje ta atyre që sapo janë nisur. Sa kanë kapërcyer Ceretat, një arë e madhe për tu shkëputur më vonë krejtësisht nga fusha për t'iu ngjitur përpjetë një mali të lartë. Por aty është një pengesë natore e ndriçuar prej dritës së hënës. Tamam Hënë jo ajo e emocioneve njerëzore gati klandestine që gjuan nën dritën e saj thëllëza të bukura. Ata që po i ngjiten Siodelit- një shteg i ngushtë ku trokojnë në çrregullsi të plotë patkonjtë e kuajve të venë në radhë, ngaqë shtegu për të hyrë në histori është tepër i ngushtë dhe nuk ka mundësi tjetër. Ky është një udhëtim i njeriut të Çezarit para se të mbërrijë te pushteti. Teatër madhështor ku mund të rrinë fare mirë dhe ngjarje shumë të vogla. Për fat të

keq ngjarje të tilla historia këtu kurrë nuk do t'i shkruaj. Vargu i pendestarëve po ngjitet përmes luginës së Siodelit në Qafën e Korës. Aty është drita dhe dita pas natës është gjurma që zbulohet njëherësh prej lashtësisë së saj dhe e shkuara e largët e saj po shfaqet. Ata kanë janë duke iu afruar Rrokullimë, aty ku ne jemi ende duke lozur, njëfarësoj për të bërë gallatë me kohën. Zilet e kuajve tringëlljnë në një ritëm tjetër aq sa natyra të mos pengohet të kthesa e Tërthores, aty ku ajo edhe mund të jetë çmendur. Mali aty pritet në mënyrë të çuditshme, avulione të thellë që e kanë çarë malin për të hapur një shteg të ngushtë për dy këmbë të një njeriu të vetëm. Të tjerë tani po kapërcejnë Bishtin e Shkallës dhe po i ngjiten qafës së Fiktit. Këtu po ndodh ajo që çdokush mund ta kishte menduar para se të shpresonte se po i shfaqej bregu tjetër. Tani skena është plot natë. Shkëmbinj të latuar prej këmbëve po hapin një horizont të ngushtë aq sa për të parë një dritë tjetër më afër. Prej Qafës së Fiktir rruga ngjitet drejt Fitesë ku ka prapë një humbje të drejtpeshimit dhe natyra përgatit për njeriun një kurth tjetër. Ju gjëra të largëta që tani i jeni sulur kujtesës sime. Unë isha ende duke o rrokullisur aty te ajo rrëpirë e vogël por shfaqen ende ca ravgime të dritës, që sapo ka kapërcyer bregum përtej Gridave. Është dielli i gjakosur që po mbytet në det, por kjo është ngjarje që te ky çast do të vijë përmes reflekseve të largët. Ngjarja është duke u zhvilluar ende në lindje. Pa mbërritur ende në perëndimin e saj. Prej Fitesë dhe sa shumë pak udhë ka mbetur. Tani ndjehet jehona më tepër se zëri dhe shkaku më tepër se pasoja që tek ne ende nuk ka mbërritur. Kulmi që atje sipër nuk është ende i sigurt se ëndrrën mund t'ia shëroj dikush tjetër. Personazhet e Folknerit tani po trajtojnë si një shkencë bindjet e veta. Ata po arratisen por as në vetvete nuk janë dot aq të shpjegueshëm sa kjo e tëra tu kthehet në bindje. Ata po ecin pambarimisht ndërsa

unë si shkreptimë në errësirë shoh kreun e karvanit të kuajve pas mëngores të Arës së Manastirit të më shfaqet. Lojërat tona tanimë mbaruan. Karvani është tepër i gjatë dhe çdo fëmijë prej nesh ngre ankthin në pritje. Rrokullima e vogël e humbi kuptimin e saj dhe si plasdarm ajo do të na ngrjë në fluturime të tjera të mistershme.

10.12.09

THJESHT, SEPSE JEMI TË VDEKSHËM

Thuaj diçka dhe gjuha bëhet diçka tjetër. Ne nuk e kuptojmë ç'ndodh me të në çast sepse nëse ndodh tani ajo vazhdimisht është duke ndodhur. Ne flasim por vetëm përmes frymës e cila s'është gjë tjetër përveçse ajër i komprimuar. Por ne prapë nuk e dimë se duke folur kemi konsumuar vet kohën. Ne ulim një perde dhe mbyllim grilat – dhe ndërpreme komunikim me botën. Kemi hyrë thellë brenda vetes. Duket sikur koha është e pambarueshme por papritur e gjejmë veten rob të një iluzioni. Po shkojmë për të fjetur. Nuk rrimë dot 24 orë në këmbë. Shtrihemi, rënkojmë. Jemi të gjallë. Të uritur dhe të etur. Duam dashuri dhe ta falim atë. Jemi duke u konsumuar si kohë dhe si lëndë. Jemi lule që sapo çelë nis periudha e vyshkjes së saj. Po si? Vetëm përmes frymëmarrjes sonë dhe djegies së oksigjenit në natyrë. Ndërkohë s'kemi venë re sa e shtrenjtë ishte pjesa jonë që ka ikur në të shkuarën. Po derdhim për të lotë dhe e shohim atë përherë e më shumë në ëndrra. Por gjithçka në të vërtetë ndodh vetëm sepse duhet të ndodh patjetër. Ne nuk jemi planete të pabanueshëm pa ujë e pa frymë. Ne prandaj gjallojmë sepse nuk jemi të pavdekshëm. Po si t'i bindemi këtij fataliteti, si ta pranojmë duke mos e shkatërruar atë që kemi ndërtuar? Ç'është kjo kontratë trashëgimnie që lidh jetën me vdekjen? Po çlirohet njeriu nga vetja duke ia dorëzuar atë dikujt tjetër. Ne gjallojmë thjesht se jemi të vdekshëm. Dhëmbët me të cilët përtpim ushqimin do të bien të fundit.

21.5.10

NJERIU I VESHUR ME BOMBA

S'isha më ai që në çastin e mëparshëm mendoja se isha. Mendoja se isha dikush që më s'jam madje do të thoshase s'jam ai që isha dhe se kurrë s'kam për të qënë. Kjo sepse atë çast unë kisha tradhtuar veten, atë të respektuarën, të njohur, publike. Tani ndodhem brenda hekurave të burgut. Ai i marri që nuk e kish pyetur fare dëshirën se ç'isha unë për të dhe nëse ishte e arsyeshme që këtë çast me të të shkoja. M'u fut ajo, si një i huaj brenda vetes portën e të cilit e kisha harruar hapur. Ja pse nuk jam ai që mendoj se jam. Sigurisht që unë vendosa të shkoj me të ndërsa le mbrapa nderin tim, këshillat e Zotit dhe familjen time. Nuk ishte fare e vështirë mjafton t'i jepja udhës veten time, t'ia çorodisja asaj mendjen, të futja prapësitë në sjellje dhe të ikja pa lajmëruar fare. Të ngrije alarmin pas vetes, bori e sinjale policie, prishje të festës në ekrane paksa për të lajmëruar tragjedinë. Kjo nuk është pak po të mendosh se ç'farë e ndritur që ajo që lulëzoi, një thashë e theme kaq të madhe. Jo rendi por njeriu përbrenda që prishur. Kish braktisur qytetin, moralin, kish marë arratinë dhe kish dorëzuar çdo dokument që e kompromentonte me shtetin, shoqërinë e familjen. Nuk që ndarë as përgjysmë por i ishte dhënë i tëri asaj dhe nuk la pas asnjë letër pendese. Një ikje totale për të ngritur një qytetërim tjetër pa e përmbysur këtë ekzistuesin. Ja kjo kishte ndodhur. Dhe tani do më duhet të tregoj se ç'ndodhte ndërkohë te qyteti

i braktisur prej meje. Askush s'e vuri re në fillim mungesën, asnjë udhë nuk i tha tjetrës, asnjë tellall nuk e kish ngritur më tepër zërin. Por sidoqoftë qyteti qe çarë si me thikë në një nga brinjët e tij. Ai nuk e fshihte dot plagën dhe s'do të mburrej si mëparë se ishte aq i lirë e i begatë sa nuk i mjaftonte gjë tjetër. Një kambanë ra diku në një kishë të vogël në periferi të qytetit dhe më vonë lajmi u bë publik e shkoi vesh më vesh. Njerëzit kishin kohë pa përtypur fjalë të tilla aq sa rrezikohej që vet gjuha t'i humbiste këto fjalë që dikur kishin qënë krenaria e saj. Kështu i ndodhi atij që gabimisht tani mendon se është ai që është. Ai nuk e di se ka ikur prej vetes dhe meqënëse nuk e gjen dot shkakun brenda vetes, e la atë të lirë të arratiset. Sikur të qe e mundur-tha të isha ndarë përgjysmë. Të isha në të njëjtën kohë këtu dhe aty dhe një gjysmë të kërkonte tjetrën dhe gjysma tjetër të thërriste të mbeturën aty për t'iu vënë pas më vonë për ta ndjekur. Tani është e vërtetë që unë s'jam më ashtu siç shkruhet rëndom për qytetarin e zakonshëm:njeri i regullt, pa vese, familjar i mirë dhe nënshtetas i denjë i Republikës. Njeriu i përditshëm i ngjanë shumë atij përveçse i mungon guximi. Ai shkon e kthehet njëqind herë te udha por më në fund e përshkon atë duke marrë frymë thellë. Ky është lloji i njeriut tjetër që ka vendosur ta fsheh atë që ruan brenda vetes. Ai gabon rrallë por e shkel një mijë herë në ditë atë së cilës i është përbetuar për besnikëri të përjetshme. Ky është njeriu më i kudogjendshëm që shpesh flet me vete duke iu përgjigjur pyetjes së atij tjetrit nga brenda. Monologu nuk ka ekzistuar kurrë sepse ne dhe në rastin që jemi duke i folur një tjetri i cili vetëm kur shpërthen si bombë nëpër këmbët tona, na kujton se ne atë e kishim mbartur kudo e kurdo me vete. Ruajmë përherë një distancë të largët me atë tjetrin, madje pranojmë të bëhemi dhe gjykatës të tij. Asnjë avokat vullnetar për ta mbrojtur. Njeiu i periferive tona

tashmë e ka zbuluar kejt veten. Ndodhetnënjë rënie të lirë e të vazhdueshme drejt një bote larg ku lakuriqësia jonë s'ka më mundësi për tu fshehur. Ai që ka ikur në të kundërt të shpellës së Platonit i ngopur e i velur është ngujuar atje për të vjellur tërë qytetërimin tonë mijëravjeçar. I ikuri besoj të mos jetë bërë armiqësor ndaj botës dhe mos të kthehet një ditë si kamikaze për të vrarë ëndrën e vet. Dhe ç'është duke ndodhur vallë brenda tij në çastin që vishet me bomba dhe fle e zgjohet në këtë shpellë të urtë njerëzore, që më vonë do të shpërthejë e tëra në një zemërim të tmerrshëm. Ku ishim ne vallë kur ai iku dhe pse nuk i kishim mbyllur portat e qytetit? Ne këtu kemi mbyllur vetveten prandaj nuk e pamë të ikurin që i iku qumështit të gjirit të nënës së vet. Po me çfarë ushqehet tani kjo foshnjë në zemër të pyllit? Vetëm me urrejtje duke pritur orën e hakmarrjes së madhe kur përplasen si dy planete qytetërimet e e thërmohen për të bërë të mundur që gjithçka të fillojë prej hiçit. Njeriu përpjestohet kështu mes së shkuarës dhe së ardhmes së vet duke rrëshqitur si pa u ndjerë nëpër tranzicionin e së sotmes.

4.3.188.5.16

MOSHA E NJË BURRI

Si ta zbulosh moshën e një burri nëse nuk të tregojnë asgjë thinjat dhe rrudhat. Si të zgjedhësh këndvështrime të tjerë për të zbuluar tek ai kohën kur ky burrë e ka kaluar lumin në vahun më të rrezikshëm. Gjurmë të atij çasti me siguri tani janë shenja që na ndihmojnë për të bërë zbulimin e nevojshëm. Por gjithçka do të varet prej mënyrës së leximit të tyre. Një burrë e fsheh moshën për të sfiduar përbuzjen dhe ve në kokë një kapele me pendë duke çarë ajrin me një shpatë të dikurshme. Moshë e një burri do të na zbulohet si rrathët e prerë të trungut të lisit. Rrathë pas rrathësh gjer sa të gjendemi para së vërtetës që do na jepet si shuma e tërë përvojave. Atje është gjithçka dhe asgjë nuk ka për të humbur. Në lëkurë dhe në eshtra. Tek ai vështrim i mprehur për larg si për të na zbuluar perspektivën. Moshë e një burri tani lexohet te ky pergamen i lashtë për t'i bërë tërë kohët të pranishme. Te duart dhe ato supet e rëna-ngrica të atyre dimrave të ashpër. Sa më tepër i afrohem këtij pergameni nis të lexoj dhe heshtjet, çaste magjike kur ai pa kohën dhe mori vendime të rëndësishme. Jetë e ngjeshur fletë pas flete dhe sa etje të shuara që i bëjnë fjalët të kërcasin akoma para se të artikulojnë. Është ky monument që nuk është ngritur ende dhe po silltet rrotull periferive të qytetit. Tani që po i afrohet qendrës eja dhe ti të zbulosh shkakun e dhimbjes tënde. Shikoje atë fytyrë sikur të jetë e jotja se vetëm prej vështrimit tënd ajo nis e gjallërohet dhe shkrimi i lashtë në të nis të bëhet i lexueshëm.

Dhjetor 2017

URIA DHE ETJA

Më mirë një etje e pangopur që është vet natyra e krijimit se sa një ngopje e vazhdueshme që të detyron të harrosh vet natyrën e ujit. Një etje e pangopur do të kërkojë përherë burime të rinj uji. Uji i tërë rrëkerave do të gurgullojë nga brenda. Vetëm ajo e mbush me kuptim jetën. Prej saj lindin një mijë shqisa të tjera ndërsa dhe po aq të tjera mund të kenë vdekur. Përherë do vrapoj prej urisë dhe etjes. Ajo pikë e nxehtë që mund të hedh në erë me gjithçka trupin tonë prej të cilit janë ndërsyer një radhë pa fund shqisash. Ajo që s'e kemi më në dorë dhe na ngatërron Polin e Veriut me atë të Jugut. Një uri e etje e ngopur s'është asgjë përveçse një radhë shqisash të tërhequra në pozicionin fillestar dhe të mbetura pa asnjë lloj ngarkese.

10.12.17

TRUPI I FEMRËS

Në respekt të estetikës unë dua një femër me një trup të përkryer siç iu afrua Praksiteli Deas. Sepse unë ndjej një prani tjetër të frymës dhe linjave. Unë kam pranë vet mbretëreshën. Ajo është mrekullia që i kemi borxh përuljen dhe përmbushjen estetike të vetes. Ne ndjejmë një pushtet tjetër. Një trup femre i zgjedhur përherë si shumë e tërë mungesave tona. Ç'është ky trup që rrezaton një radioaktivitet të papërballueshëm? Bukuri që rrëmbehet prej të gjithëve për tu bërë edhe më e bukur. Linja që mprihen edhe më tepër duke zhvendosur në hapësirë masa të mëdha ajri.

Nëntor 2017

PARA PASQYRËS

Unë duhet të heshtja ose të flisja ndryshe dhe prej së folurës sime të kullonte djersa e gabimeve. Vetëm kjo do të kishte qënë dëshira e fundit pasi isha pëdorur tepër nga të tjerët. Ky është dhe mësimi më i vyer që kam nxjerrë prej vetes. Më duhej të zgjidhja një pozicion të ri për të mos fyer viktimat e mia. E tërë e folura ime duhej përcjellë në formën e një lutjeje që çliron shpirtrat prej mëkatit. Kjo është mënyra për të ulur një flamur e për të ngritur një tjetër në lartësi më të përlulura që zgjojnë te njeriu energji të fjetura. Dhe vetëm nëse do të ndjeja nevojën për tu shprehur, kjo thjesht me synimin të pastroja të vërtetën e cila po mastrubohej me të shkuarën nëpër ato qoshe të thella. Një fëmijë nuk e fshin dot aq lehtë gabimin prej dërrasës së zezë, pa i mbartur më parë ato si gjurmë te kujtesa. .Këtej e turje do të ngarkohesha me një peshë edhe më të rëndë e cila do t'i shfaqej përvojës si një mësim tepër i çmuar. Si duhet vallë të sillemi me diktaturat që na kanë kyçur brenda shtëpive tona? A mundemi dot të ishim së paku shtiza dhe bezja por jo vet flamuri? Në shoqëri tani kemi një rol tjetër, atë të pastrimit të saj si një pasqyrë ku të tjerët mund të shohin më qart gabimet e vetes.

29.2.16

E FSHEHTA TORTURONJËSE

Një nga pamjet e rralla që ndryshon papritur rrjedhën e përjetimeve tona. Edhe kjo duhet të ketë qënë pjesë e misterit. Po i sillem rrotull asaj që është mbyllur ndaj meje. Të më japë qoftë edhe një mundësi të vetme për të nisur pushtimin e madh. Brirët që i ka fshehur për të shpallur më vonë luftën. Do të përdor tërë forcën dhe ineligjencien time. Si t'ia dalloj së largu luanit krifat? Kaq do më mjaftoj për të ndërtuar një plan sulmi. Por asgjë prej këtyre nuk duket dhe shigjeta në harkun tim rri përherë e ngrehut. Më duhet kjo përplasje me dikë që mund të jetë dhe armiku im i përjetshëm. I përfytyrojmë luanët por stepa prej luanëve është e braktisur. Sa më ka trembur përherë ideja e kënetës ku lumenjtë vdesin. Është diçka përherë që më pengon por unë s'arrij dot ta zbuloj ku ajo rri fshehur. I ulërij asaj që më del në shteg por në këtë duel mes guximit dhe frikës shpatat vetëm sa mprihen te dhëmbët. I thërras për luftë por ky iriq edhe më keq është kokolepsur duke ndehur vigjilencën e veshur lëkurën e trashë vetëm me gjëmba. Ato i mbron frika ndërsa unë s'po gjej dot një thembër Akili për ta nxjerrë nga vetja këtë të keqe të lemerishme. Unë do të jem i munduri ndërsa armiku im do të mbetet përherë i padukshëm.

6.3.16

KASAFORTAT

Skicën e saj si ide e shoh ende. Afrohen e largohen vija drejt njera-tjetrës. Një lloj fushe ku ushtarët janë ende prej plumbi. Por nuk vrasin dot se akoma nuk i kemi mbushur me mendje. Përpiqemi ta kufizojmë fushën mos të dalin topat në udhën e madhe. Të matim shpejtësinë në rëndesën për tu bërë një lloj flurudhe e cila do të na tërheq vështrimin në një tjetër qiell. Plani është përfytyrimi para se të nisin matjet konkrete, para se Çezari të japë urdhrin drejt Galisë për tu nisur. Kartagjena është ende larg në një plan tjetër. Sa të kthehen ambasadorët me mesazhet lidhur me fjongo të kuqe ku janë shkruar kushtet e luftës. Plani vazhdon të jetë një sprovë e mendjes para se trupat të nisin marshimin. Më parë kurrë s'do të dihet ç'është etja e shkretëtirës, ç'janë dhimbjet e malarjes dhe sa e ç'helm ka në majë të shigjetave të armikut. Këto vogëlsira do të pasqyrohen më vonë pas përvojës e cila do të plotësojë ato pika ku dyshimi pasqyrohej përmes reminishencave. Tani plani është shtruar mbi tryezë. Vështrohet nga lart –posht, nga posht-lart. Sa mendje vallë aty janë bashkuar në një të vetme? Ç'kam parasysh nuk është e tëra pasqyrë e ndërgjegjes sime. Vështroj si shfaqet nëpër fletë një pjesë e thelbit tim i trembur prej guximit të vet, përsëri në pelena do të fshihet. Po ndërtojmë atë që më vonë do të verë në lëvizje mijëra duar, po aq këmbë dhe po aq sy që do të qajnë për humbjen e tyre. Këto hollësi nuk duken në plan

asgjekundi por në nënvetëdijen tonë ka nisur të zvarritet krimbi i një dyshimi të thellë, që shpesh parakalon tërë këtë ushtri në marshimin e saj. Dhe si vallë kjo frikë mund të pasqyrohet në të për të mbyllur shtigje të tjerë për t'i hapur udhë vetëm optimizmit për fitoren e madhe. Plani është ende në kasafortë por ne nuk e dimë se brenda kemi kyçur një bombë që një ditë do të shkatërrojë të ardhmet tona. Shoh prej një vrime të vogël kafshëzën brenda kafazit. Ndërsa kafshëza fle ushtritë kanë nisur marshimin dhe retë e luftë sa vjen e po shtohen. Mendja jonë tani ka heshtur. Asaj i mjafton ky urdhër për të venë në provë forcën, shpejtësinë, aftësinë manovruese të trupave. Plani prej vrimës së vogël tani po rritet, e shoh si i rriten dhe kthetrat. Mendja jonë-kjo mëkatore e madhe e ka dhënë tashmë urdhrin e saj. Lufta është shpallur. Nëse gjithçka do të shkojë sipas planit mendja si matematiciene tani ka për detyrë të numërojë të vrrarët. Derisa kjo përvojë u bë mendja e një njerëzimi të ri. Syri ynë i verbër që na sheh me ç'lloj shigjeta me helm e kemi verbuar. Unë për 45 vjet kam qënë pjesëtar i planit të madh –një vidë e mbërthyer në të unë isha gërmë e një fjale e cila si nina-nana më kish venë në gjumë për net të tëra. Prej çelësave që mbyllin kasafortën unë trembem për vdekje. Nuk e di kur do shkojë ushtar për tu vrrarë për Atdheun. Unë që u bëra mendje shumë vonë nisa të bëj një plan familjar të vogël të harruar në shumë e shumë vite për shkak të Planit të Madh. Por edhe ky plan rri mbyllur me çelës. Ishim bërë kasaforta të vogla fshehur brenda një kasaforte të madhe. Kjo është e panjohura, ajo që më lejon të shoh vetëm përmes një rreze të vogël drite, aq sa bindje kemi dhe po e bëjmë përherë gati që një ditë ta mbyllim edhe atë në kasafortën tonë të familjes

17.5.10

DHIMBJA SI TUNEL I THELLË

Kur Amanda e vogël u rrëzua prej lojës rrëshqitëse në Parkun e Lojërave dhimbja që ndjeva më vonë ishte shumë herë më e madhe se ajo e fillimit. U shndërrua në dhimbje për të dobtit, të pafuqishmit-një lloj humbje e pamatë të cilën nuk isha në gjendje ta përkufizoja ose në të vërtetë isha unë që kisha dal përtej orbitës së saj. Kur mbesa ime e vogël pushoi së qari ne e ngritëm kukullën tonë në duar si për tu çliruar prej fajit. Nëse do arrij ta përshkruaj saktësisht atë që ndjeva, besoj se do të kem udhëtuar brenda një tuneli të thellë për të sjellë dëshmi të forcave të egra që kërcënojnë ekzistencën tonë. Njëlloj si Amanda e vogël është ky njerëzim i madh mijëra e mijëra vjeçarë në mëshirën e forcave të errëta. Amanda kish rrëshqitur prej duarve tona dhe kish rënë në një abis prej ku ne tani jemi duke e ngritur. Dhimbja ime u bë e madhe dhe e pafundme sa më shumë mendoja për njeriun e pambrojtur dhe që s'isha dot zot dhe, ideja e një zoti shkonte gjer në kufijtë e një pafundësie të pazotërushme. Mbesa ime ishte diçka e vogël që zvogëlohej akoma, njëlloj si dhimbja ime e cila si frymë mbetej për një çast në ajër para se në largësi të ishte tretur. Kjo ndodh brenda njeriut por nuk mund të them si i kish përshkuar qelizat e trupit, ajo shkullmë ajri para se të shpërthente përjashta. O zot sa të pambrojtur jemi para forcës së egër e të panjohur. Le të ngrejme një mijë diga mbrojtëse, furia e saj e çmendur ka për t'i kapërcyer

ato për tu ngulur si thikë në trupin tonë, në mishin e njomë që ia kanë rrëmbyer prej duarve shpatën. Kisha parasysh një abis si ai që më ishte shfaqur kaq e kaq net nëpër ëndrra të fëmijërisë sime. Lëshohesha tëposht me një shpejtësi lemeritëse për t'iu dorëzuar diçkaje që kurrë s'do arrija ta identifikoja. Ishte një rënie në pafundësi ku ti s'je më dhe ku bota e mbetur pezull është duke thithur frymën tënde të fundit. Po si u shumëfishua ajo dhimbje në trupin tim pa asnjë plagë nëpër gjymtyrët e mia? Ndoshta ishte diçka tjetër ajo që dot s'mundemi për ta shprehur dhe që s'kemi as fuqi për ta ndalur. Ndoshta isha unë vetë ai që po rrëzohesha prej lojës rrëshqitëse në Park. Në trurin tim kjo ndjesi ishte përcjellur me një shpejtësi ku e ku më të madhe se sa çdo lloj veprimi i lëvizjes së dorës, i fluturimit të zërit për të shpëtuar Amandën prej rënies. Dhe një keqardhje që nuk ishte gjë tjetër veçse ai fund ku në ëndrrat e asaj fëmije të vogël ishte zhytur. Muret mbrojtës nuk janë aq të pathyeshëm sa duken. Kështjella si ide ishte ajo që ndërtoam duke mbyllur brenda saj frikën tonë, por ulërimat e bishës depërtonin nëpër të çarat e mureve përmes kafkave tona. Ne do kishim dashur të ishim të pavdekshëm por atëherë për fare dhe s'do të kishim qënë. Tani që po e shkruaj ajo u kthye në një dhimbje tjetër të shumëfishtë meqënëse kish vendosur të bëhej e njohur. Ajo që tashmë qarkullon si legjendë nuk do të lejoj më kurrë Trojën të vdesë. Një cikël i mbyllur është ajo por në një farë mënyre nën këtë koracë mund të jetë thjesht pavdekësia.

28.5.16

TURMAT SI NJË ZË I VETËM

Njerëz popullorë i gjenë gjithkund si cilësi e një bime që i mrekullon të gjithë me aromën e saj. Ata nuk kanë ide por shtjellojnë për mrekulli idetë e të tjerëve për t'i bërë të kuptueshme për publikun. Ata shpërndajnë ndihma për çdo lloj fatkeqësie dhe ngrejnë moralin shoqëror në pikën më të nxehtë të tij. Ti nuk e zbulon dot kurrë cila është moda e tyre e veshjes, sepse ata janë gjithëpërfshirës si shumica e tërësive modave dhe koha për të matur temperaturën e saj i mban në trup si termometër. Ata janë vet kaleidoskopi i saj. Kanë një mençuri si shumica e tërësive proverbave, fjalëve të urta, këshillave mjekësore. Pra ata thjesht mund të shfletohen edhe si një vademekum ku jepen receta për shërimin e gjithë sëmundjeve përmes barnave popullorë. Në të vërtetë ata nuk kanë asnjë lloj adrese sepse ndodhen gjithkund e në të njëjtën kohë. Si altoparlant i zërit të masës ata shndërrohen në kryekuvend të saj. Po për t'i ngjarë sadopak Kazanovës e kanë të pamundur. Asnjë flirt në asnjë lloj krahu, sepse u mungon guximi artistik për të thënë të vërtetën, të cilën pothuaj nuk e njohin. Ata bëjnë një përzierje të fakteve dhe ideve duke shmangur kështu çdo mundësi për debat e cila mund t'i nxirrte menjëherë nga loja. Pra ata në fakt janë një shumë e paverifikueshme, ndërkohë që dyert për ta janë të hapura. Mërzia që vjen prej pranisë së tyre është e ngrohtë, e butë, lotëndjellëse sepse ata qajnë përherë si turmë në çdo lloj

proçesioni duke ndihmuar kështu në vdekjen sa më shpejt të vlerave. Për ta zhveshur prej shpirtit të saj kohën ku jetojnë-ky është misioni i tyre që le të tjerë pezull. Sa më shumë turmat rriten përballë njeriut popullor, bindja qytetare rritet dhe pesha e çdo fjale zvogëlohet ashtu si cilësia që e bën gjuhën ushqim popullor të përditshëm. Mjafton ky shesh i madh dhe fishkëllima e një arbitri në shesh, krejt turmën për ta mbledhur. Pushteti e ka rrethuar popullin e vet. Dhe për shkak të hyrjes në lojë të të gjithëve si në koret e lashtë përcillen funeralet me ide të vdekura. Pushteti nuk ka më nevojë të tregojë dhëmbët. Edhe kur kanë ndonjë pakënaqësi me pushtetin, ata më mirë vriten me njeri-tjetrin se sa të trazojnë pushtetin, i cili në çdo rast burrëron vrasësit dhe nuk i përmend kurrë viktimat.

21.9.12

THIRRJE PËR NDIHMË

Është mirë t'i ekspozojmë dobësitë tona apo t'i fshehim? Për tu mëshiruar prej të tjerëve apo thjesht për t'i sfiduar ata që zotërojnë mungesat tona. Kam vënë re se gjymtimet fizike determinojnë karakterin, sepse çdo gjymtyrë e cunguar nuk bëhet kurrë fatkeqësi e të tjerëve. Ja pse ato duhet të paguajnë një haraç që shpagohet me urrjetje. Po nëse ti zotëron errësirën dhe një tjetër dritën, lind menjëherë nevoja e shkëmbimit ,sepse ashtu si forca jonë me dobësitë e vetë një ditë do t'i duhet të përballlet. Është një ndërvarësi që përpiqet të zgjidh dilemat tona. Të dobtit ndodhen përherë në rreshtin e fundit por pa ata s'do të kishte kuptim as vet rreshti. Ajo që i mungon të gjymtuarit është një fuqi e dikurshme tashmë e vdekur. Te këmbët e prera gjer te gjunjët mëshira përpiqet të mbledh fuqitë e dikurshme. Por kështjella dikur e fuqishme ka nis të rrënohet nga themelet. Te gjunjët tanë tani mblidhet mëshira që konvertohet në lutje. Njera zhbëhet për të vënë në provë mungesën. Çdo gjymtym fizik e kompeson forcën e një gjymtyre tjetër. Këmbët e prera ua kanë dhënë fuqinë e tyre duarve. Do të luten për ju përherë në gjunjë -sikur u thonë këmbëve dikur të fuqishme. Çdo perandori e rrëzuar le pas kujtesën për lavdinë e saj për tu lutur. Rrëzohet forca për tu zgjuar prej saj mëshira. I gjori klloun i varur në tel që tani na bën për të qeshur. Sikur teli të këputet e qeshura e tij si ulërimë varur do të mbetet. Një klloun i varur në tel zgërdhiet

për të nxjerrë me zor prej dhëmbëve të qeshurën. Dhe një publik që tallet me veten sepse vetëm një fill teli mund t'i mbajë tërë këto të britma gazmore.

Mars 2017

NJERIU BRENDË KAFAZIT

Robër luftime apo thjesht robër të ekzistencës? Asnjera prej këtyre dy zgjidhjeve nuk është më e mira sepse njera edhe pse në armiqësi me të nuk e përjashton tjetrën. E para prej përkohshmërisë që jep zgjidhje më të shpejta dhe e dyta që zgjat pambarim të njeriu i mbyllur në kafaz, që lutet për t'i mbirë trupit të tij flatrat. Lëvizje të detyruara brenda një hapësire me kufij të përcaktuar. Të tërhiqesh fort prej një litari të lidhur në duart e tua. Në kërkim të ushqimit. Loja që duket sikur ka mbaruar dhe çdo mundësi që duket e eksploruar. Duke vrapuar ka kohë që nuk rritemi më përveç se zvogëlohemi. Më duhet të hedh një vështrim të tejpërtejshëm mos zbuloj të paktën një njeri të vetëm që nuk ka rënë në kurthin e kësaj robërie. Ai do na kish hapur vërtet një shteg për t'i shpëtuar këtij kurthi por nuk pash as edhe një njeri të vetëm. Qoftë edhe mbretëri që na qëndisin zakonet e sjelljes, të tjerët gjer te pirunët në tryezë dhe kontrolli biologjik i ushqimeve. Pra e tejpërtejshme është kjo shtrirje gjer te hapi i njeriut të fundit që ka kryer rrethimin, duke hyrë vetë në këtë valle ekzistenciale. Së bashku edhe me ëndrrat që injorojnë mundësitë tona fizike dhe e çojnë mendjen nëpër lojëra e akrobacira të rrezikshme. S'kemi nga t'ia mbajmë tjetër përpos se të urtësojmë instiktet. Njëlloj sikur ta kishim humbur dhe fituar njëkohësisht luftën. Po kuptohemi më me

shpejtësi për rrezikun që ka mbërritur. Do të bjerë përherë një kampanë zgjimi por vetëm kur rreziku të ketë mbërritur te porta.

2.10.12

NJË NJERI BRENDA MEJE

Ti njohe një brendësi timen të thellë dhe unë jam duke e parë me turp në pasqyrë. Kur po më tregon se kush jam unë i kësaj vete të panjohur. Një lloj zbulimi me atë të nëntokës. Mos u frikësoni prej asaj që ajo fsheh, por guxoni sepse vetëm kështu u jep kuptim jetëve të tua. Këtë duket sikur po lexoj te pasqyra prej ku po shoh pamje që ti sapo i ke nxjerrë prej thellësive të mia. Le të ndihmojmë njeri-tjetrin më mirë se sa të fryjmë me propagandë kohët tona të lavdishme që është duke pësuar fiasko. Më duhet ky sy zhbirues brenda meje teksa më sheh që unë s'mundem as kam kurajon ta shoh dot. Sepse vetëm kështu mund të studiohet heshtja. Shkërmoqen e bien lëkurët, koracat, lëvozhgat e thyera dhe ja ku kemi në duar këtë fryt krej lakuriq krejt të pafajshëm si një shenjt që ne dikur e patëm rrethuar me auerola. Atë që përveç jush të tjerët do ta përbuzin. Pa më marrë leje ti kishe hyrë dhe unë ndjehem mirë tek ti lëviz nëpër të përbrendshmet e mia. Kemi nga një labirint secili por çelësin e portës së daljes duket se nuk e zotëron askush, enkas që njeriu të ndjehet si i kapur brenda një qerthulli. Me sy më jepje shenja se ku ndodheshe atë çast në brendësinë time. Ndjeheshim njëlloj të pushtuar duke i rrëmbyer armët njeri-tjetrit. Zotër nuk janë vështrimet por shigjetat që po na ngulen. Fjalët lëshojnë një lëng sensitiv përbrenda. Jemi të pushtuar. Por kurrë s'kemi për ta identifikuar portën prej ku në brendësitë tona hymë pa i marrë

askujt leje. Ndoshta ka qënë mërzia e madhe që kish vënë në gjumë kështjellën. Dhe tani marrë guximin të të pyes: Çfarë po bën brenda meje? A ke ngrohtë aty dhe a e gjete veten në atë strehë që unë të kisha përgatitur për dimër? Do ma tregosh këtë vallë një ditë që unë të plotësoj regjistrin me fakte se ç'kishte bërë atje dashuria dhe urrejtja të përziara së bashku? Ndjem shumë i lehtë me këtë njeri brenda meje. Një avion që po e pastrojnë prej rrëmbyesve në qiell. Jam në delir kur ndjej se nëpër këto lëndina ti je duke shëtitur. Po korr me dhëmbë barin e kësaj pranvere dhe unë së jashtmi po ripërtërihem si pylli.

1.11.12

KOSTUMI

E pash atë mëngjes me një veshje të pazakontë. Një kostum gri që e mbante krejt të shtrënguar trupin e tij nga brenda. Kontrast i dukshëm me veshjen e të tjerëve që kishin çliruar qafat prej gravatave dhe si të tillë silleshin, duke i shfaqur hapur prirjet ndërsa ndonjë femër kish lënë zbuluar enkas pjesë të ndaluara të trupit. Kostumi ishte një lloj sfide për të ndrydhur harenë në shpërthim dhe për të na kujtuar rregullin, që prej kostumprerësit gjer te njeriu ynë që tani e ka veshur. Siç funksionon dhe ligji i zbatueshëm në tërë nenet e tij të vegjël dhe i ruajtur po prej ligjit vet, prej nënligjeve e urdhëresave. I zoti i kostumit tani i burgosur brenda tij thoshte përherë fjalë të prera me thekse që shndërroheshin në tinguj plot forcë tërheqëse. Shpesh fjalët e tij mu bë bë se kumbonin prej një kambane të thyer. Por më vonë kur kuptova se ç'përfaqëson një kostum, një ditë nga të asaj fundvere ne u shpërndamë dhe rrëshqitëm prej njeri-tjetrit, si për t'i shpëtuar leximit të një të fshehte e për t'iu dhënë udhë përfytyrimeve. Tani e kuptuam pse kostumi meritonte kaq shumë përkujdesje në hekurosje, në prerje, në lëvizje, për t'i lejuar format të shfaqeshin me tërë hijeshinë e tyre. Dhe së mbrami secilit prej nesh iu përfytyrua vetja duke dalë prej këtij burgu miqësor për t'i dhënë trupit të vet lirinë e munguar. Duke u zhveshur, krahët hapeshin si flatra dhe koha brenda nesh do të fitonte një përmasë tjetër. Rregulli papritur që shthurur dhe fjalët

po njësoj ishin bërë gojëlëshuara, duke humbur tingëllimën e tyre të ashpër por drejtvizore. Ato tani po ktheheshin si të penduara nga udha tek ndjenin shtrëngimin e qafave prej gravatave si shenjë paralajmërimi. Ndoshta tani ne kishim qënë të vërtetë dhe gati për të komanduar trupat tanë, ndërsa po përgatiteshim për të tradhtuar moralin shoqëror në qiell, ndërsa në mbremje një fytyrë tjetër do na shfaqej te pasqyra.

30.10.12

KAPTERI

Serveti më tepër se hero ishte i denjë për romanet e Balzakut. Sa për hamendjet e mia ai ishte një Gobsek i vonuar nga që Balzaku iku shumë herët pa i parë si do ishin gobsekët e tjerë nën shembullin e Gobsekut të tij të famshëm. Seveti ishte plot dinjitet në të drejtën e tij për të administruar atë që i kishte dhënë ligji dhe mund t'ia hiqte vetëm gjyqi. Aq i saktë sa në çdo veprim të tij mund të zbulojë nëse dikush ishte vonuar dhe porta për tu hakmarrë që mbyllur. Në një garnizon të vogël ushtarak ai në të vërtetë ishte një lloj mbreti i padukshëm. Zotëronte për secilin atë pikën e dobët që çarmatoste kryeneçësinë e njeriut. Ai jepte uniforma dhe këpucë, batanije për dimër, mbathje të lidhura me gjalmë. Ai hynte lehtësisht në trupat tanë për të na matur numrin e qafës, të kokës, të belit për tu bërë edhe mendja jonë, të cilën ai përherë e shumëzonte me zero, sipas rezultatit që nxirrte pasi pjesëtonte ose zbriste numrat tanë për të nxjerrë një koeficient të përbashkët të tyre. Ai ishte patriarku që e fshihte trupin dhe kokën nën një veshje prej të mjeri. Te një kapter ushtrie që shpreh krejt natyrën e ligjit. Edhe pse nuk thirrej në shtabin Madhor të garnizonit, ai priste çastin kur secili prej tyre të kalonte në vërën e gjilpërës së tij duke e matur çdonjerin nga të katër anët. Oh çfarë pushteti i tmerrshëm dhe sa janë tërbuar duke ikur prej tij pa mundur të nënshkruanin dot me të një kontratë mirëbesimi. Ai ishte asgjësues sepse zotëronte pikat

tona të dobëta ,të cilat ne ishim të detyruar t'i shfaqnim duke u zhveshur gati lakuriq para tij në kohët e ndërrimit të stinëve. Asnjë lloj uniforme nuk mund të vishnin trupat tanë pa lejen e Servetit. Ai shpërndante gratis këto parajsë të vogla për të zbutur edhe më natyrën agresive të pushtetit. Të gjithë ne i kishim dorëzuar atij nga një kopje të çelësit për të hyrë në trupat tanë kur ai të dëshironte. Te shkalla e fundit e jerarkisë ushtarake rritej gati në mënyrë të pabesueshme fuqia enjë pushteti për të sfiduar atë që mund të shkonte gjer te fuqia e një perëndie..

16.5.18

VETJA TJETËR

Për kë jam i vlefshëm? Është një pyetje që njeriu e nxjerrë thellë prej vetes duke shkatërruar qetësinë dhe çfarëdo lloj gjendjeje tjetër. Edhe pse është duke ndjerë një dhimbje të madhe do t'ia përsëris pa mbarim këtë pyetje vetes. Edhe kur e sheh atë të gëzuar mes një turme hokatare, ai përsëri vazhdon të pyes më me këmbëngulje se ç'pjesë e kësaj shoqërie është dhe, çfarë do të ndodhë paskëtaj këtu në mungesë të tij. Njeriu që e torturon veten qoftë edhe pa arsye është një përballje e njeriut me një realitet armiqësor. Ai po e torturon veten për të nxjerrë prej saj një ekstrakt tjetër në një atmosferë shpërfillëse, ku është duke u zhvilluar ky eksperiment i çuditshëm. Njeriu që do t'i shoh gjërat e veta jo nën thundër të këpucës por në sytë e të tjerëve. Të mat temperaturën e saj në zjarrin e të tjerëve. Ky njeri që më është bërë barrë i ka munguar gjer tani vrasja ime. Ai që edhe pse i kudondodhur më tepër është i harruar në harenë e përgjithshme. Ai që vazhdon të mëtojë përmes vetes për njeriun në përgjithës, i cili përherë do të ndërrojë veshjen në varësi të sjelljes së vet për ta mbajtur atë të fshehur. Ky njeri që fle dhe brenda njeriut të vet të egër të një kohe të largët e të papërcaktuar të pëpunimit të një të ardhmeje po të papërcaktuar dhe kthimit të përhershëm drejt së shkuarës. Ai që ka ëndërruar për të qënë masë matëse për shtratin e të tjerëve e bënë pambarim këtë pyetje , duke na zbuluar sa wat dhe volt

gjer sa ta ndjejë veten si dritë apo si fuqi nxehtësie atë në trup të të tjerëve. Ai që i dalë shumë herë para vetes nga të katër anët duke e pyetur nëse kjo vete e tij, për të ka qënë përherë e mjaftueshme.

5.1.12

NJERËZ...

Të rebelojmë shkrimin për të nxjerrë prej kornizave lumin e mendimit. Lëngje njerëzore që ujsin këtë shkrim brenda vetes. Të jemi aq të lirë sa drurët me pyllin. Do të hapim një tendencë të re për të mos e poulluar token me njerëz të gatshëm, të cilët ua japin me shumë lehtësi pushtetin mirëbërësve të tyre. Ata janë duke rebeluar shkrimin kundër makinave që mendja jonë i prodhon, pa bërë llogari me varret që do t'i duhen për të groposur këtë marrëzi njerëzore. Në shkrim brenda,ku të ketë sa më pak kotësi e duartrokitje për Hyun. Të bëhemi njerëz secili më vete dhe të shihemi vazhdimisht nëpër pasqyra, ku të mos dukemi kopje të përcudnuara të njeri-tjetrit. Le të bëjmë një kontratë të madhe për të shmangur lindjen e atyre që janë të panevojshëm. Le të frymëzohemi si fillim prej asaj ideje dhe ta ndërtojmë atë së pari me fjalë që nuk ia shterin dot lirinë gjuhës. Vetëm kështu përditshmëria jonë mund të jetë një perspektivë e përhershme. Të bëhemi njerëz të pauniformizuar dhe si meritë të kemi së pari dhimbjen, e cila përcjellë një gëzim femënor të brendshëm. Pra të jemi femijë për të mos u rritur gjer në plakje dhe kujtesën të mos e invadojë ushtri e krimbave që janë gati për të ngrënë megjithsejt njeriun. Unë propozoj por më mungojnë argumentet për ta kthyer këtë që po them në bindje. Unë trembem nga vetja duke guxuar dhe ka tepër arsye që ta lemë shkrimin në paqe. Unë shfaqta thjesht një ide por ajo

varroset me shpejtësi brenda vetes. Më mungon qartësia për t'ia dhënë çdonjerit si përgjigje të gatshme. I detë mund të jenë edhe një fazë çmendurie. Merru me përditshmërinë tënde dhe ruaje këtë kujtesë për ta bërë krimin- varr të përbashkët të të gjitha kujtesave.

25.12.12

RITMI I SHUMË KËMBËVE

Nuk kujtoj dot në ç'largësi e pash atë që mu ofrua si shpëtim. Dhe tani më duket se jam pranë një zgjidhjeje. Shqetësimit të mbramë që më kish torturuar tërë natën duke e çuar atë gjer në ëndrrat e mia, që përherë do të jenë shansi i fundit për t'i dhënë zgjidhje çdo lloj ankthi. Po gjykoj me veten për marrëdhënien njerëzore kaq shumë të komplikuar, për ndërtimin dhe prishjen e saj ndoshta edhe brenda një çasti të vetëm. Unë që aq shumë jam përpjekur për të qënë ana më e arsyeshme e balancës dhe, kundërpesha e saj që unë kam krijuar për tu gjendur në një pikë ku shoh më qart se për ku e për çfarë kanë nevojë mungesat e mia. Kjo është ajo që paraqitet si shkak i krijimit të një marrëdhënie për të plotësuar mungesat që shkaktojnë vazhdimisht tërmete brenda qënieve tona. Dhe në mënyrë krejt të pashpjegueshme dhe pothuaj njëherësh krejt tronditëse. Diçka e tillë që ne asnjëherë s'mund t'ia përcaktojmë peshën e rëndesës në marrëdhëniet shoqërore. Por dhe as që do mundemi dot ta përjashtojmë atë si shkak fillestar të një zhvillimi tërësor që sjellë tronditje të fuqishme brenda rendit të gjërave. Përgjatë tërë udhës ku një shoqëri ecën për të mbërritur qëllimet e saj. Ajo marrëdhënie e vogël njerëzore si qelizë e një zhvillimi më të komplikuar marrëdhëniesh të tjera, ndoshta të papërfillshme dhe e braktisur në margjinë, për shkak të ritmit të shpejtë të shumë këmbëve në ecje. Por le t'i

kthehemi kësaj fillese për të qënë bashkë me të përgjatë tërë udhës. Prishja e një miqësie bëhet shkak i ndryshimit të papritur të shijeve tona. Ne kemi humbur një mik por koha në përgjithësi humbet një rast për të mos qënë kaq shumë e dramatizuar. Sepse në çdo lloj humbjeje ne asnjëherë në fatkeqësinë tonë nuk jemi vetëm. Por bashkë me ne edhe shoqëria në përgjithësi diçka ka humbur, gjer sa të ndjehet pesha e saj mbi kolonat solide të kësaj perandorie, të ngrënë përbrenda prej një ushtrie krimbash që në fakt është një frymë rezistence mospranuese dhe rënieje drastike e besimit.

16.12.13

SI MUND TË MBËRRIHET GJER TEK ARSYEJA

Tërë këto kohë nuk kam qënë i qetë për të riorganizuar mendimet e mia, për të disiplinuar veprime të cilët nuk kanë qënë kurdoherë në sinkron me mendimin. Është një shumësi gati e përbindshme që invadon mendjen pa mundur dot të vendos në të rendin e gjërave. Ndoshta kam qënë shumë i lodhur dhe po i sajoja përditshmërisë lojëra të rrezikshme. Një çast u ndjeva filozof dhe e pash jetën time si të ishte e të tjerëve dhe për mëshirë mora vendime të guximshme. Si Çezar u dhashë urdhër trupave për sulm pa e ditur se thika e Brutit atë çast po ngulej pas shpinës sime. Te kjo parregullsi që ne kurrë s'do të mundemi dot të vemë rregull, megjithëse kemi bërë një hap të çfarëdoshëm të shtyrë me përdhunë prej kohës e cila na rrëmben me vete. Sepse neve përherë do na mbart një mendje fluturuese. Këto kanë qënë dhe çështjet që doja të kumtoja në leksionin tim të mbrëmshëm mbi kohën pa u ndalur dot në asnjë çast të veçantë, ku secili edhe si hero nuk kish për t'i pëlqyer kurrë piedestali që ne kishim zgjedhur, për monumenti i tij i cili do të ngrihej aty së shpejti. Apo qoftë edhe peizazhi rreth e rrotull, që nuk e përfaqësonte denjësisht natyrën ku takohen në një pikë deti dhe malet dhe fushat dhe lumi dhe një pllajë e ndriçuar prej dritës së hënës, dhe shkretëtira që gulçon prej etjes këtë mbrëmje gushti. Në mendimet e mia po sulmojnë njëherësh për rivendikime shumë vendime që unë kisha marrë në të

shkuarën, pasojat e të cilave ngrajnë dyshime të tjerë edhe më të përbindshëm. Tërë mendimet na shfaqen në formën e një yllësie pa arritur dot të zbulojnë në to yllin më të ndritshëm.

1.1.14

PËRGJIGJE E PAMUNDUR

E ndjeja se dhe kjo përgjigje nuk i mjaftonte pyetjes. Dhe pyetja bëhej dhe më e vështirë prej mungesës së saj ose vonesave që po shtoheshin për përgjigje të tjera të pyetjes. Sa më shpejt dhe më mirë ta bëjmë këtë punë për të mos e prishur kurrë paktin me të ardhmen. Jemi duke mbyllur dhe dy vrima të vogla gjersa ta nënshkruajmë paktin ku ftohet edhe e ardhmja për të hedhur firmën. Siç kemi qënë të tronditur prej ngjarjeve të fundit në Lindjen e Mesme dhe vërshimit biblik të refugjatëve drejt Evropës. Mungon edhe përgjigja e fundit e një pyetjeje që s'është bërë kurrë me kaq alarm si të qe prishur vet boshti i botës. Po i shërbejnë tavolinat tona me këtë meny të përgjakshme. Unë përpiqem të nxjerrë prej fjalorit filozofik shprehje që nuk gjenden në të asgjëkundi. Por marrëveshja duhet bërë qoftë edhe e përkohshme. L e të veshim të gjithë rroben e folozofit për të dhënë një përgjigje sa më të saktë të asaj që është duke ndodhur. Do na duhet të zhbirojmë akoma në ato shpella që më parë besuam se kishim zbuluar njeriun e egër, që u nis prej fshatit të tij për të ndërtuar më vonë qytetin. Por një e hënë kishte ardhur gabim prej së dielës e nund të shkonte gabim edhe e marta. Unë i pëlqej vallet e sidomos kur ekzaltohet nëpër to turma. Por vdekja tani është e egër edhe më e lartë se foklori ynë që ne jemi duke e nxjerrur prej gërmadhëve për të pasuruar me ide të reja të ardhmen. Dhe mendimi ynë shkon përherë tek

e thëna naive ku shkojnë tërë gjuhët drejt krimin për ta shkatërruar vet gjuhën. Vetëm Kasandra kishte të drejtë por zëri i saj ende nuk është dëgjuar. Mos vallë po e vrasim edhe stërmbesën e Kasandrës me këtë marrëveshje që sapo e nënshkruam dhe me kobure në rrëzë të veshit e detyruam të ardhmen për ta nënshkruar?

8.3.16

SI ISHULL

Ndodhem në mes të një deti armiqësie. E shprehur në dallëgë dhe e pashprehur në valë që hedhin në brigjet e mia mbeturina. Prej njohjes dhe mosnjohjes. Prej një mllefi të grumbulluar që nuk di të shkarkohet dhe sportit të përditshëm të njerëzve që s'dinë si ta kalojnë kohën. Është në të mirë të tyre prania i me si i vetmi shkak që atyre u gjallëron lojën. Sepse ata nuk kanë mision tjetër. Ata lëvizin pothuaj duke u rrotulluar rreth mërzisë së që gjuan me shkelma nga vetja të tjerët. Ishulli është i plotë si vetmi dhe shenjë e mirë për tu qëlluar nga të tjerët. Ai është shenja që tregohet me gisht sa herë rrezikohet varka nga mbyttje. Ishulli shfaqet si shpëtim. Le të zbarkojmë njëherë në të pastaj dimë vet si ta mbjellim urrejtjen. Ishulli goditet nga të katër anët prej dallgëve të mëdha. Ishulli është largësia e tjetrit nga vetja. Të sulmojmë pamundësinë tonë me gjithfarë mënyrash. Ta tallim, ta përbuzim, ta vjellim si dëshirë të porealizueshme përmes dallgëve, t'ia bëjmë ekzistencën të padurueshme. Ju që pikësynim kini një ishull sulmojeni për ta nxjerrë si mllef prej vetes. Dhe kurrë në të s'kini për të mbërritur sepse një ishull mbetet përherë një ide e porealizueshme. Vetëm si pengesë, një ishull është i nevojshëm sepse me të po mbërrin pamundësia juaj për ta banuar. Atë që e përbuzët dhe me gurë e topa e goditët, tani ai u rrëmbeu fuqitë nga brenda dhe ju të mbetur pa qëllim i silleni rrotull, asaj që në mënyrë armiqësore

iku nga ju për tu strehuar në ishull. Brigjet e një ishulli kështu do të jenë përherë më të goditurit dhe më të anatemuarit, sepse një ishull popullohet nga vetmia që ka braktisur vet njeriun.

13.11.15

TRUPI SHQYEN RROBET E VETA

Një grumbulli vogël fëmijshë të një fshati as me 500 banorë çfarë lojërash nuk shpiknin. Mendje në lojë prej lojës shpikte lojëra të tjera , gjer në arratisje nëpër ca maja të larta që fshatin e rrethonin gjer te deti që fëmijve u shfaqej si një peng , që nuk po e përfshinin dot nëpër lojëra. Mund të ishin rreth 100 fëmijë të ndarë sipas grupmoshash me interesa të ndryshëm prej njeri-tjetrit, por prej fundrrugicave gjer te horizonti më i largët do përcilleshin jehonat e çmendurisë së tyre. Edhe sot nuk e shpjegoj dot si kjo mund të ndodhte kaq dendësisht e paprerë në një larmi formash për ta shfaqur tërë këtë si një ansambël. Fëmijë që ndjeheshin ngusht brenda këtij peizazhi dhe që përfytyronin kaq shumë për të nxitur nëpër gjymtyrë shpejtësinë e rritjes. Lojëra nga më të papërkufizueshmet që zgjidhnin shpesh terrenet më të thepisur, për t'iu shtuar edhe më rrezikshmërinë lojërave dhe ndjesinë e fitoreve që u mprehnin inteligjencien. Jemi rrahur prej hithrave duke klithur. Jemi shpuar prej gjëmbave që nxirrnin në majë një lule jashhtëzakonisht të bukur,të cilën nuk do ta gjeje dot në asnjë treg luleshitësish. Vajzat tona të vogla mësonin kulinarinë duke zbatuar një radhë perfekte organizimi sa nga një shtëpi te tjetra. Prej ku mirrej ose çohet përvoja. Ndërkohë që djemtë vogëlushë përballeshin në të tjera luftra. Ata vriteshin me shpata ose zbulonin talentin e tyre nëpër fushëza të vogla , ku me një top

prej lecke i gjuajtur përherë do të përfundonte te kopshti i Paput e Spire. Ai do të shfaqej përherë i rreptë dhe fusha e lojës boshatisej njëherësh. Nuk ka patur më një intesitet kaq të vrullshëm të zhvillimit. Dhe për fat të keq atë s'mund ta shkruaj sepse ajo u shkrua pa u ndalur me shpejtësinë e ca këmbëve të vogla gjersa lojërat krejt të ishin braktisur. Kaq shpejt kish rënë muzgu i një moshe që gjer në përjetësi ne e kishim përfytyruar. Kurrë më aty s'kemi për tu kthyer. Ajo iku shumë shpejt prej shpejtësisë së saj duke zhveshur e grisur rrobat që nuk i vishnin më dot trupat tanë. Dhe tani jemi ajo që atëherë kishim nisur të ishim, me brinjë e këmbë të thyera, me fjalë të pista që e ndotnin gjuhën. Për tu degdisur më larg e për tu takuar gjithnjë e më rrallë, gjersa ky mall për fëmijrinë të bëhej i papërballueshëm.

6.11.15

NJË TRUP BRENDA BURGUT

Jam i veshur, domethënë i përcaktuar si një ka që nuk i ikën dot parmendës së vet. Është fund dimri dhe nën një xhup bëj po ato lëvizje duke ngarendur nga brenda për tu çliruar prej një lloj burgu. Por është e pamundur pa qënë diku më parë brenda, të shfaqesh përjashta, për të qënë te koha i pranishëm. Herë-herë nuk e ndjej këtë lloj ngarkese në trup por komçat dhe zinxhirët mezi i zbërthej atë për ta flakur. Se është duke ardhur pranvera dhe do të bëhem zog i lirë e të fitoj lirinë për të përjetuar ndjesi të tjera. Më të lumturat vijnë prej zbërthimit të komçes së parë që të hyjë në trupin tim flladi i parë i pranverës . Toka që po çahet prej miliona bimëve. Unë ndjej përbrenda insekte që po më iritojnë lëkurën. Veshjen e kam flakur dhe po ta vini re hapi im tani ka një ritëm tjetër. Unë isha lodhur me veshjen time si zogu me pendët e veta. Si pema që kaq e kaq herë ia zhvesh gjethet vjeshta. Te një zhgun unë kam zbuluar një mënxyrë dhe po ta vini re ajo thjesht ka qënë veshja e një lloj besimi të egër, ku do të fshihen përherë të ardhmet e njeriut. Dhe beduinët ndoshta që veshja e tyre s'ka për të zbuluar kurrë mëzinë folklorike të jetës. Dhe këto maska që trimërojnë trupat e trembur. Në çdo prag stine kam dashur ta zhvesh me tërsëlimë çdo lloj veshje dhe t'i tregoj në të vërtetë se si prej burgut të saj tani jam i çliruar. Kjo pallto që e kam veshur si një lloj shëmtie me urdhër të trupit tim që ishte duke ngrirë prej të ftohtit. E

kam veshur prej frikës dhe gjej një ritëm për të ecur në rrjedhat e kohës. Jam i përzier sepse gjërat e thjeshta lakuriq që lexohen aq shpejt të bëhen të mërzitshme. E kemi mbi shpinë mëkatin dhe të gjithë drejt altarit jemi duke shkuar për tu falur. Unë s'u gjej dot vend të lirë duarve ,fshetur thellë mëngëve të ngushta. Më kap një zemërim edhe më i hidhur prej veshjes në trup por tani nuk e flak dot këtë burg dimëror prej vetes.

26.1.14

NË TEKNIKUMIN 'NAKO SPIRU' TIRANË

Shihja përherë një gungë, formën e saj të çuditshme që i jepte atij trupi një ekuilibër përherë të valëzuar. Shihja një dorë të prerë që i afrohej dorës tjetër pa mundur dot ta prekte-përqaqafimin që më vonë do ta realizonte dora tjetër me gishtat e saj kur të ishte çliruar prej detyrimeve të tjerë. Shihja dhe një sy që me pikëllim përpiqej të shikonte syrin tjetër të verbër. Por tmerri vinte prej dy këmbëve të prera që zvarriteshin përherë nëpër koridoret e gjatë të shkollës me ndihmën e dy shkopinjve të vegjël. E shkuara e gjymtuar që ndiqte çalë- çalë të ardhmen e saj. Dhe nuk kishte perëndi që këta çekuilibra t'i bënte të pranueshëm dhe t'i fuste në lojë këto gjymtyrë të munguara për të zbukuruar sadopak atmosferën. Unë flija pranë dramave të mëdha herë sipër herë posht tyre dhe dëgjoja nëpër ëndrra shpërthime të vonuar minash e bombash të mbetura nga lufta. Ky gjymtym njerëzor i grumbulluar këtu me atë çfarë prej trupave të tyre të mëparshëm kishte mbetur. Kjo dramë nuk ka fuqi të shkruhet prandaj po rimerret prej kujtesës si një peng pas 55 vjetësh. Tani që kujtesa e mba për pak kohë portën hapur ata vijjnë një nga një- ushtarë të plagosur të një beteje të humbur. Siç gëlonin atëherë për të rrëmbyer pak prej lumturive tona. Qoftë edhe si spektatorë në stadiumin e vogël të futbollit apo në mbrëmjet tona kur Diogjeni ynë na ftonte me fizarmonikën e tij në vallzim në gjysmëerrësirën e papafingos së madhe, të

kësaj kazerme lufte që thirrej ende me emrin e Ali Rizait. Si akti më absurd i një drame që luhej mbi po ato rrënoja të shkretuara luftrash. Atëherë kur shumë sy të verbër kërkonin gjymtyrët e trupit të tyre të humbura në këtë shesh lufte. Kjo përditshmëri e pazakontë që paraqitej më së shpeshti me dy fytyrat e saj të mbivendosura mbi njera-tjetrën si realiteti mbi surealen e një pamjeje që jo aq lehtë mund të përfytyrohej. Shumë prej miqve të mi bashkonin me ne fuqitë e tyre të mbetura dhe gjenim një ritëm tjetërlloj në këtë bashkëjetesë të mrekullueshme. Ne i ndihmonim ata shpesh për gjëra që ata ishin të pafuqishëm për t'i kryer por ata na shpërblenin përherë me shembullin e tyre për të na treguar se më i tmerrshëm se gjymtimi fizik do të ishte ai i shpirtrave.

11.7.17

REVOLTA E PERSONALITETIT

Ç'është familja, pjesë të së cilës jemi edhe kur ajo na ka brektisur, ose njeriu në revoltë ikën prej saj për të denoncuar dhunën ? Nuk po e ndërtoj dot menjëherë përgjigjen sepse më duhet të përgjoj vet njerëzit e mi më të dashur. Kemi hyrë në një terren paksa konservator dhe në një shenjtëri që nuk duhet prekur. Atje ku lumturia shpesh është e madhe dhe rreziqet për ta shkatërruar atë janë permanent. Por me durim e dashuri të tepërt, herë-herë mund edhe t'ia dalësh. Një lloj individualiteti në këto kushte edhe mund të ruhet si kontribut për të ardhmen e saj, përmes një lloj ambicije dhe sidomos përmes kulturës së një tradite e cila na mëson për të mos e përbuzur individin. Ai përherë duhet të jetë në qendër edhe kur flitet ndërkohë për një tjetër. Respekti nuk e përjashton individin por e mban të lidhur ngusht brenda rrjetit edhe pse pikat e tjera shkojnë të gjitha për tu bashkuar në një pikë të vetme. Po kurthi që na është ngritur në këtë rast duke synuar për të na shndërruar në kafshë të urta e të bindura? Rreziqet janë përherë aty por po them se hipitë si eremitë u kthyen nga shpellat më shpejt se ç'mund të mendohej. Nuk kishte qënë ajo zgjidhja. Revolta e personalitetit ndaj kolektivitetit dhe pushtetit përfundoi atje ku tashmë dihet. Kurthe të ngritur ka kudo në rrugë, në familje por sidomos brenda vetes ku ti ke mbetur peng i një tradhtie apo qoftë edhe dashurie. Atmosfera familjare mund të jetë tepër miqësore dhe

e pafajshme sidomos kur dikush prej pjesëtarëve ka braktisur kolektivitetin dhe rrezikon prishjen e harmonisë familjare. Ti je duke përjetuar ditë të mrekullueshme qëndrese përballë këtij reziiku eminent. Si të thuash askush prej nesh nuk është i imunizuar prej asnjë lloj reziiku. Edhe Hitleri që u fut në bunker prej disfatës, betoni i trashë mbrojtës nuk e shpëtoi dot nga vetvrasja. Pra ti ndërton por nuk e di që kjo që po ndërtohet do të rrëzohet për të të zënë nën vete. Ti ke uri dhe nuk e di se me barin ke përlypur dhe helmin. Unë nuk jam hero dhe për më tepër familja ka nevojë për një gjë të tillë. Familja që në fund të fundit është shuma e tërë ëndrrave tona. Tërë ajo bukuri vetëtitëse që ti më parë e ke ndërtuar nëpër ëndrra, është mëkat të mos bësh edhe një sakrificë të fundit për të sado të vogël. Dhe ku mund të shkosh tjetër? Përtej portës së saj të pret një vorbull thashë e themesh ndërsa në familje edhe këtë nevojë të njeriut e ndanë miqësisht pa krijuar keqkuptime. Pra e tërë kjo që thamë qënka një kompromis që s'ka mënyrë tjetër për t'ia arritur veç duke pranuar përherë këto sakrifica të vogla. Pikërisht ne nuk do të donim të mbyteshim që në lumin e parë që na doli para rrugës, kur rrugën do ta kishim aq të gjatë dhe familja bëhet ajo strehë, ku unë së paku kam parë tërë ëndrrat e mia. Pra në një farë mënyre për t'i ikur përsëri këtij realiteti. Jo pikërisht ashtu sepse ndryshe unë këtu s'do isha ndalur por do të kisha ecur nëpër rrugë të tjera të cilave kurrë s'do t'ua kisha gjetur fundin. Po demonët vallë pse janë më pranë egërsirës së njeriut? Ata ne i kemi krijuar vetë prej mbeturinave tona, tmerre dhe frikëra prej të cilave nuk është e imunizuar as familja. Një ditë dhe familja vdes prej këtij dispozitivi që në fakt nuk ka qënë zgjidhja e përhershme dhe e pëlqyeshme. Por më e mira nga të pamundurat e tjera të paarritshme. Por as familja nuk ka faj për

demonët të cilët ne vet i kemi sjellur me porosinë që të rrinë
urtë për të mos e prishur qetësinë familjare.

25.12.09

UNË DHE UNIVERSI

Ana subjektive jam që vendos të ngrihet në këmbë. Nuk shoh urdhëruesit e mi edhe nëse ata janë diku rreth e rrotull. Unë që ndodhem këtu dhe jo diku tjetër. Bashkë me rrethanat bëhem një dhe i pandashëm. As kjo shtëpi s'do t'i kishte dritaret nga lindja. Prej kohësh mund të kisha vendosur të tërhiqesha prej planeve të mi. Por asnjera prej tyre nuk ndodhi dhe unë jam këtu dhe vetëm këtu. I tërhequr prej Veriut tim së paku kam vendosur të përballlem me realitetin nga kjo pikë për t'i bërë sa më pak të dëmshëm sulmet e tij. Sikur nesër të fillojë një luftë kjo do të thotë se atë unë e kam dashur. Megjithë peshën e rëndë të rrethanave duket se unë e kam zgjedhur shtegun për të mos u përballur drejt për së drejti me forcën demoniake të tyre. Ndoshta kam qënë vet kapiteni dhe jo anija që nuk bëri dot sa mundi për t'i shpëtuar mbytjes. Por meqënëse zoti nuk është shfaqur akoma unë nuk e kam braktisur përfundimisht anijen. Dhe po të isha unë ndoshta s'do të kishim folur për kurrëfarë situatë të tillë me një anije në det që lufton për të mos u mbytur. Prej çdo ane ta shohësh shfaqem unë, unë i pashmangshëm, unë i nevojshëm, unë i përjashtuari, armë që mprihen por që dalin jashtë luftimit pa u përdorur ende. Kjo mendje e pavendosur që ka pritur agimin qoftë edhe një rreze të vogël të bjerë përmes xhamit të dritares që unë të shoh shpresën. Qënia ime e rrethuar së cilës i është ngarkuar pesha e rëndë e Sizifit.

Mund ta mundësh Sizifin si bashkautor të krimit të vet ose thjesht pranim me kushte i një gjendjeje të caktuar për të dalë te një rrethanë tjetër. Nëse u ngjit me gurin mbi shpinë unë them se ai zbriti me dëshirën e vet për të rimarë gurin. Ai ishte kurdoherë i pranishëm me vendimet që zoti merrte për të dhe kjo është origjina e çdo krimi njerëzor, kur edhe viktima nuk mund të jetë kurrë e pafajshme, ashtu si vrasësi të cilit nuk i takon e tërë pjesa e fajit.

1.1.09

DYSHIMI QË NA KTHEN NGA UDHA

Nganjëherë dhe s'di prej ç'shtyse shkoj në kompjuter. E hap dhe kërkoj aty gjëra të mia të hedhura prej kohësh. Do t'i lexoj përsërisht sot si dhe herë të tjera por tani me një ndjesi tjetër. Nuk di saktësisht çfarë është ajo po e para gjë që përjetoj më thellë është keqardhja. Kur i lexoj më rivjen besimi që mund keqardhjen. Ato janë krijimet e mia dhe më duhet tu shërbej gjer në fund. Rëndësi ka të kesh realizuar diçka të kënaqshme dhe konkurrese, pavarësisht faktit se duhet të paguash për gjithçka vet për ta hedhur në një treg ku mungon interesi. Me këtë sy të shpejtë bëj një shëtitje të shkurtër nëpër librat e mi të hedhur në kompjuter. Ata janë pothuajsr gati por para një horizonti që për ta është i mbyllur. Tani që po flas është një lloj fundi i disa përpjekjeve që kam bërë për të nxjerrë krijimtarinë time prej stanjacionit. Por vetëm në kuptimin e publikimit të saj. Në ekranin e kaltër prej ku janë ndezurt tërë dritat dhe ku ime bijë në çelje të tij vendos përsëri figura të bukura dhe impresionuese, më duhet të shoh ç'kam qënë i zoti të realizoj pa përdorur asnjëherë metoda jo të ndershme. Njoh shumë krijues jo dhe aq pa talent por që e shesin edhe më shtrenjtë veten. Më ngjajnë si hiena që u rrëmbejnë dhe meritat e të tjerëve për t'i lënë ata në hije. Këtu nuk e kam fjalën dhe aq për veten se sa për klimën që zotëron në përgjithësi si kudo edhe në fushën e letrave. Shoh antologjitë që botohen prej

antalogjistëve të huaj dhe vendas dhe përherë po ata emra krijuesish. Por unë e di se jo pak prej tyre janë të tejkaluar si vlera artistike. Është vërtet e trishtueshme por ja që ndodhin dhe për asnjë krijues të mirëfilltë udha nuk është e shtruar me dafina. Kam lexuar një pjesë të krijimeve të mia të fundit dhe e mbyll aparatën e pafajshëm duke i fikur më parë dritat. Atje në atë dhomë të errët tashmë është kyçur edhe një pjesë e kujtesës sime. Vazhdon jeta e përditshme me një ritëm tjetër pune, problemet e ndryshëm të familjes, dhimbjet dhe shumë detyrime të tjerë shoqërorë. Thua se ti tani ke braktisur aty një pjesë të vetes tënde ndoshta atë më të bukurën, që mund të krahasohet vetëm me një ëndërr. Por jam i sigurt se një ditë tjetër do ta hap përsëri kompjuterin si një shtëpi por nga një dritare tjetër, me ndjesi të tjera do ta përshkoj çastin e magjishëm të takimit me atë ç'kam shkruar dhe ndoshta këtë herë do të shihem sy më sy me të përmes një qortimi të papërballueshëm.

18.12.08

CIKLI : KOHA
PËR NJË EKUILIBËR TË RI

Zgjothem. Është ora dy, tre ose katër. Dua të fle prapë por më parë duhet lodhur mendja, të arratiset që të kthehet përsëri për të fjetur. Çfarë i ka ndodhur-vras mendjen. Trupi, po ai i lodhuri i parë nuk ka dëshirë tjetër veç për të fjetur. Duke u lindur prej gjumit kthehet në shtratin e tij dhe mendja nis të shëtit nëpër ëndrra. Në zgjim ai del prej një fundi të thellë me ekulibër të prishur prej kërkimit nëpër natë të dritës. I ka parë lakuriq të gjitha dhe pa u turpëruar me veten ka biseduar për anët e pafajshme që në mëngjes sërish duhet t'i hedh një rrobe përsipër. Ora 2 në zgjim është më e vështira njëloj sikur anija të gjendet në mes të detit dhe bregu fare nuk duket. Do që të flejë përsëri për t'iu afruar edhe më tepër bregut. Por nganjëherë është e pamundur dhe do t'i duhet të përplasat me dallgët. Atë copë realiteti që në mbrëmje e kishte braktisur tani e ka edhe më të gjallë para syve. Mbyll sytë por nuk e ndihmon askush, as edhe një ninullë e asnjë lloj tjetër përkujdesjeje. Thërret nënën e vdekur, atin, thërret kujtime të largët e të bukur por e ndjen se ata kanë vuajtjet e tyre të pashërueshme. Duhet të mbërthejë me gozhdë veten ose të bëjë harakiri trupin duke e therur. Të flierë, por si dhe kur ndërsa enigmat shumëfishohen. Jam më tepër se kurrë i gjallë dhe nën ndriçimin e shumë dritave shoh

vetveten. Kohë që i duhet hapur dera para se të çmendet. Një arrati e përgjithshme me gjithçka që të vijë sërish gjumi dhe shpëtimi. Por kur ora është tre pas mesnate dhe aty afër katrës gjërat nuk duken më dhe aq të tmerrshme. Mund edhe të loz me to sepse agu po e shpëstjellë dalëngadalë errësirën. Jam një farë zoti me fuqinë e duhur për të mundur frikën dhe i ofroj territ një kontratë tjetër. T'i ndajmë tërësisht së bashku/njëlloj mashtrimi që i bëj atij/ derisa përfundimisht dita të ketë zbardhur. Kështu që frika dhe guximi shfaqen përmes shumë formave. Tashmë frika ka shpatën ngulur në trup ndërsa tjetri dorën e përgjakur me të cilën sapo kishte kryer krimin.

Dhjetor 2009

NË ERRËSIRË ËSHTË MBJELLË FARA E DRITËS

1.

Këto drita në natë janë sytë e etur të ujqërve. Natyra që nëpër natë shpesh na shfaqet pa lidhjet e saj i ngjan një ngrehine që vazhdimisht është duke u shkërmoqur. Dritat në largësi vetëm sa të japin shenja por pa mundur dot të trgojnë çfarë në të vërtetë është duke ndodhur. Të rrethuar prej errësirës ne kërkojmë shpëtim më tepër te një iluzion, se te përpjekjet tona për të dalë nga kjo gjendje. Dritat janë një lloj lagështie që freskon brinjët e shkretëtirës. Nëse do të kthehesha përsëri tek ai burim drite më parë do kisha braktisur këta përfytyrime të mërzhitshëm, për të sjellë prej andej misterin e errësirave edhe më të thella. Zbulime si rrjedhojë e përvojave të shkuara ku prej thërmijës njohim vet fuqinë e tmerrshme të lëndës. Ajo pikëz drite që shpërthen përditshmëritë tona për t'i shndërruar në përvoja.

2.

Të duket se bashkë me ty vrapojnë të gjitha pemët, vet deti i pafund që të pret për të të mbytur. Përmes këtij shndërrimi të vazhdueshëm ti ia ke dorëzuar veten mijëra përfytyrimeve dhe në fund vet apokalipsit. Nëse njëherë prej kësaj shfaqjeje je çmeritur tani nuk shqitesh më dot prej saj as përmes kësaj klithme ulëritëse. Tmerri që prodhon errësira është njëlloj gjyqi

i tmerrshëm për mëkatet tona që kanë shpikur vet frikën. Ti je duke e parë një fund por përpiqesh t'i largohesh atij po aq djallëzisht para se ai të të jetë shfaqur. Unë jam thjesht një përbërje kimike që po zbërthehem dhe kam për t'i ndjerë më vonë pasojat. Ti që vrapon i lumtur dhe i tregon gjoksin erës nuk e ke njohur ende tmerrin që për ty kjo natë e gjatë e ka ruajtur. Unë vetëm sa e nxjerrë atë prej realitetit duke e veshur shpejt me fantazinë time për të mos u prishur. Çasteve të paktë të lumturisë sonë iu ze pritë Bodleri. Ai marifetçi i poezisë që e tërheq grigjën në terrin e saj si sprovë të realitetit. E tërë kjo dhe mua më është dukur si një lojë por edhe gladiatorët hyjnë në të për të vdekur. Me natën ende nuk luan dot sepse kokët e prera të përbindshit zëvendësojnë përherë njera-tjetrën. Do të kemi qënë përherë me natën por prej frikës do ta përçajmë atë përmes gjumit dhe ëndrrave. Dritat në errësirën e tyre të thellë shfaqen të trembura. Japin shenja por zhduken në çastin që ti do të mësosh të vërtetën prej tyre. Nata është mbyllja e llogarisë me realitetin për të hyrë në 'logjikën' e metafizikës. Qirinjtë e zbehtë të saj mbeten vetëm shenja që misterin do ta ruajnë përherë për vete.

19.9.17

HESHTJA SI LIBËR I PASHKRUAR

Nëse nuk shkruan dot provo ta grisësh fare letrën. Ose hiq vija të rrëmujshme për të ngjallur këtë çast vdekjeje. Është e pamundur ta përshkruash por le të provojmë ta prishim magjinë që të mba lidhur duart e mendjen. Asnjë lloj përvoje nuk është e aftë ta çajë këtë rrethim ku rri fshehur ajo që ka zgjedhur heshtjen. Rrëmbe një vare e thyeje këtë shkëmb të lashtë që më në fund t'i hapet goja. Ose provo ta godasësh atë pikë-pikë si një curilë uji. Ndoshta do të zgjohet. Mjafton ky kumbim i lashtë që gurit t'i ndizen zjarret nga brenda. Mos vallë kjo ndodh ngaqë ti nuk di çfarë të shkruash, ndërkohë që ti po ashtu e di mirë se ajo është aty duke pritur me shekuj. Mos fajëso atë por veten, as kohën. Fajtori i madh dhe i vetëm je vetëm ti që nëpër rrjedha të kohës një gjumë të thellë ishe duke fjetur. Por letra e bardhë të shfaqet si përherë provokuese. Ndoshta është pylli që fle apo shkretëtira që ti nuk merr dot guximin për ta shkelur. Apo nuk ke fare etje, statujë e ftohtë sepse të mungon koha. Dhe e tërë kjo vallë mos përfaqëson vetëm një kafkë të zbrazët? Ti pretendon pushtetin ndaj diçkaje. Dhe do të lozësh kaq e kaq herë me lapsin përmes gishtave për të mos e ngulur asgjëkund. Përjeton një lloj dhimbjeje por ajo është e shpërndarë gjithandej dhe ti nuk di ku ta shkosh gjilpërën. Tani që është trupi në lojë mendja është vënë në kërkim por asnjë lajm prej këtyre mijëra antenave ende nuk ka mbërritur. Duhet bindur më parë trupi

për t'i dhënë mendjes atributet që kërkon një çast i tillë. Sikur tani të nis bora ndoshta gjithçka do të vihet në lëvizje dhe një zog do të ndalet në dritare për të sjellë lajmin më të çuditshëm. Një çelës më në fund i ka dhënë dritë mendjes. Ndoshta dhe vetëm për këtë betejë, ia vlen të shkruash, tani që atë e ke fituar. Në mijëra faqe e miliona fjalë që s'i ngjajnë më njera-tjetrës. Shpërthen një lumë në mendjen e shkrimtarit dhe hapen një e nga një portat e këtij labirinti. Ka qënë kjo vuajtje e madhe, ky ngërç që aq shumë më parë shkrimtarin e kish lodhur. Rusia e tërë 22-milionë kilometrash katrore më në fund hyri në një libër. Por ishin këto vorbulla të tmerrshme në mendjen e shkrimtarit të cilat përherë do të ruajnë misterin e tyre. Një paradhomë e zbukuruar me mobilje ku Tolstoin e pret koha. Krishtër që presin një dorë të padukshme të prish këtë rregull dhe t'i japë alarmin heshtjes. Ka ndodhur në atë kohë pritjeje dhe kush mund të na thotë se ç'mesazh kishte sjellur me vete ai zog në dritare? Dhimbja më në fund ishte identifikuar në një prej gjymtyrëve dhe qe ngulur njëherësh në trupin e saj gjilpëra shpëtimtare. Në qiell u vizatua një vetëtimë që zbuloi papritur një turme të lumtur. Ku vallë është fshehur ana tjetër e papërfillur nga propaganda dhe pse nuk munden dot kamerat prej andej të shohin? Unë thjesht nuk dua të jem kaq shumë i lumtur dhe nuk e pi dot këtë drogë të ëmbël .

26.7.09

NJË ATDHE TJETËR

Këngë dhe pamje pa fund. Madje dhe lumenjë dhe anije nëpër ta të mbytur. Pranverë bjeshke dhe një fyell që përshkon me melodinë e vet krejt luginën. Dhe çfarë e do një lumturi se kjo më të madhe? Ndërsa po shfaqen dy balerina në pista ëndërrimtare duke vallzuar. Kjo është pamja që rëndom shfaqet por shpesh pyes veten : Po unë vallë pse medoemos duhet të jem i lumtur? Dhe pse tërë kjo trysni për të na injektuar këtë ndjenjë kur rrezatimi i saj diellor përthyeret në lëkurën time pa mundur dot të hyjë brenda? Grabitësit e lirisë mbajnë edhe armë të tilla të lehta verbuese që në vështrim të parë duan të ledhatojnë sedrën tënde. A s'është vallë ky atdheu im që unë edhe më shumë duhet ta dua? Sa e vështirë është për secilin kjo përgjigje që i kërkohet të bëhet pjesë e një turme të lumtur. Ku vallë është fshehur ana tjetër e papërfillur nga propaganda dhe pse nuk mundën dot kamerat prej andej të shohin? Unë thjesht nuk dua të jem kaq shumë i lumtur dhe nuk e ushqej veten me këta iluzione se me krahët e tyre kurrë nuk mund të fluturohet. Pse nuk më lenë te këndi im prej ku jam për të parë botën? A nuk duket dhe prej andej atdheu, ndoshta një atdhe tjetër i mbuluar nga ferrat me më pak dritë dhe me më tepër mjegull? Gjërat mund të shndërrohen shumë shpejt në serioze sepse një popull i tërë kaq i lumtur mund t'i bëjë atentat historisë së vet dhe ndërgjegja kolektive deformohet. Ajo i përtyp të vërtetat

përgjysmë ose çerek dhe pas zbehjes së efektit do të gjendet në një zgrip të rrezikshëm. Ja pse them se kjo propagandë është dinake, iluzioniste në mos edhe qëllimkeqe për të vënë në gjumë ndërgjegjet dhe prodhon turma të gatshme për krime kolektive nesër. Domethënë lumturia e çastit përgatit një tragjedi të së nesërmes. Dhe kjo padyshim ka ndodhur sa herë në treg opiumi popullor jepet falas ose me çmime krejt të përballueshëm dhe joshës.

8.2.10

JETA SI NJË LUMË

Jam këtu për të kundruar botën dhe vë re ndryshimin që sjellë kjo lëvizje e pandërprerë. Unë tani jam një qendër që drejton këtë lëvizje në rrugë përmes vështrimit tim, i cili është duke grumbulluar fakte pa numër. Unë nuk i kërkoj askujt të sillet ashtu siç unë dëshiroj por e le rrjedhën e tyre të shprehet. Rastësi të panumërta bashkohen me njera-tjetrën përmes shumë lidhjeve të padukshme. Njeriu në udhë me lirinë e vet relative vonon dhe nxiton për të kapur vet kohën. Kaledioskopi im shënon fakte të rinj dhe i tërë ky lumë tani rrjedh brenda meje, prej ku nis përpunimi i lëndës dhe ku e tërë kjo lëvizje tanimë nuk është thjesht objekt për tu shndërruar në subjekt të saj. Qoftë edhe brenda një lëvizjeje të vetme mund të dallosh qart prirjen e kohës, natyrën e shumëfishtë njerëzore të kushtëzuara prej rrethanëve dhe përpjekjet e saj për tu çliruar prej tyre. Ka një kohezion të çuditshëm mes mundësisë dhe pamundësisë. Ai që tani çlirohet prej tyre përgatit kurthin në të cilin një tjetër sapo ka ngecur pa kuptuar në realitetin e rrethanave. Unë në fokus jam bërë portë e hapur ku rrjedhë vet lumi pa patur më fuqi atë për ta ndalur. Edhe unë vetë këtë çast po ndryshohem dhe bëhem po ajo varësi e tmerrshme e pushtetit absolut të lëvizjes. Unë jam pritje e prurjeve dhe po aq arsye e forcës siç ato vijnë e përplasen tek unë.

Po sikur unë të isha jasht kohës si do të më gjykonit ju mua? Dhe si vallë do t'i afroheshit këtij universi për të dëshmuar se kini qënë edhe ju bashkëkohësi i tij? Sa e pamundur është për tu shpjeguar vet koha qoftë edhe ëndrra që tani po e sheh një njeri i vetëm, i cili mund të jetë vet koha e përjetuar. Këto që po them tani ndoshta shprehin fillimin i cili nuk ka pranë botë të tjera krahasuese, prej atyre që i marrin menjëherë çmimet, pa parë që Zoti ynë më parë ka përgjuar dhe përjetësinë dhe për këdo e ka bërë atë të pamundur. Këtë desha të them në esencë të asaj që i mungon përvoja e mëparshme dhe unë lodhem atë për ta krijuar, për të bindur më parë veten se kurrë nuk ka qënë i pamundur. Po vet koha vallë ç'ka qënë nëse e kemi thirrur përherë në ndihmë për të na vërtetuar ditën e lindjes sonë-këtë letërnjoftim që aq shpejt prej këtij zhgënjimi ka për tu zhdukur? Nëse vërtet kemi ekzistuar do të na duhet të prishim shumë module të ekzistencës sonë për ta nisur atë prej një fillimi tjetër. Dhe kurrë sikur të mos kemi ekzistuar, ashtu siç do të ndodh në të vërtet, nëse jemi shfaqur ndonjëherë me vrap nga frika se mos na kapte rob ekzistenca dhe, shpejt nëpër vrap prej saj jemi zhdukur.

9.12.08-25.11.08

PASQYRË TURBULLUESE

Në reflektim pamja duket e bukur e mbrojtur siç është te pasqyra, si manekin që era ia valëzon veshjen e saj. I vendosur brenda një kuadrati peizazhi duket sikur është mbyllur aty për tu shlodhur. Unë zgjat dorën ta prek por ai bëhet eterik, provokues. E shohim por s'na sheh. Gjë e mbyllur por e ushqyer prej dritës. Ndoshta është ky diell prilli që nuk tretet dot në një peizazh të vetëm dhe thërret për ndihmë pasqyrat. Natyra e dehur e shumëfishuar- jetë e pasqyruar në vdekje, vdekje e pasqyruar në jetë. Shoh te xhami i dritares. Më duket sikur s'jam unë ai që sheh tani në dritare. Në të vërtetë s'mund të jem unë përderisa pamja nuk është ajo por thjesht një tufë rrezesh drite që e transportojnë atë pa pushim drejt e në qelq. Ai tjetri prej inatit është duke i mbledhur, por atë vazhdimisht me shpejtësinë e dritës së tyre stampohen në xham.

23.4.10

GJITHÇKA NIS MË PARË...

Shenja e parë që i futi tërë hamendjet në një rrjedhë tjetër. Dhe ndodhi pikërisht atëherë kur nuk e kishim pritur. Por çfarë në të vërtetë ajo ishte? Me ç'emër ta quaje dhe për më tepër mos ishte thjesht një kurth ku ti do endeshe me ditë e net të tëra pa mundur dot të shpëtoje prej saj? Ajo çka kish ndodhur në largësi tani duhej përballur nga afër. Si një lloj detyrimi për ta çuar më tej këtë marrëdhënie që tani dy vijat e saj i kish prerë në një pikë të rrezikshme. Tepër të rrezikshme do të thosha. Prej frikës së një hapi të gabuar që mund të prishte gjithçka por edhe mungesa e veprimit që mund të këpuste këtë urë të sapohedhur. Njeriun e gjen belaja. Do dhe nuk do të jetë i ngatërruar në një histori së cilës asnjëherë nuk i dihet fundi.

Dhe ja që ndodhi pikërisht atë mëngjes kur dy rastësi u përplasën dhe ne ishim përshëndetur. Po pse vallë dhe ç'prej shtyse ne po ia çonim këtë mesazh njeri-tjetrit? Ishte një afrim i rrezikshëm i shoqëruar me një mister i cili kurrë nuk do të shpjegohej. Kjo kish nisur diku në një lloj largësie kur ne të dy ishim pika të errëta që asnjëra s'kish guxuar t'i afrohej tjetrës. Ndërsa tani patëm rastin së paku të verifikonim atë që atëherë kishte ndodhur. Ajo u ndërpre pikërisht kur sapo kishte lindur. Por duke fjetur brenda kujtesës të secilit që me sa duket ende nuk kishte vdekur. Atëherë një mbrëmje vere kur gjërat janë më të sinqerta

dhe krejt të rastësishme dhe kur jep pa qënë i detyruar të marrësh. Duket sikur ka kaluar një shekull gjumi i asaj kohe të gjatë. Ndoshta secili prej nesh e dinte që fati i asaj që kishte ndodhur ishte ky gjumë që mund të kishte qënë edhe vdekje. Çdo kishte qënë ai qiell pa yje dhe pa asnjë lloj shenje tjetër? Më parë ndoshta duhet të përfytyroja Ferrin por te bota ku jetojmë ne lemë hapur një dritare vëmendjeje. Dhe kujtesa vërshoi në çast nën një dritë të re qei ishte shfaqur secilit. Nën një vështrim ku mori flakë gjithçka ne e kuptuam se ky krim harrese kish qënë fare i panevojshëm. Nesër kur të zgjohesh-sikur thoshin sytë e saj, -një mrekulli para teje do jetë shfaqur. Dy-tri sekonda marrin papritur vlerën e një jete të tërë.

10.6.09

JETA NË NJË ËNDËRR

Ato mbrëmje kishin diçka fantastike. Fjala diçka duket sikur e zvogëlon kujtimin por shpërndan hirin e saj nëpër një botë të padukshme. Po them që ishin përrallore por edhe kjo nuk e ezauron dot të tërën sepse ne pinim përherë verë të shtrenjtë që mbaronte shpejt për të na shtuar një etje tjetër të tmerrshme. Aq sa më në fund këto vizita u shndërruan në të vërtet në një përrallë dhe gjindjen tonë po e zinte gjumi. Po tonoj një atmosferë atje ku ajo ende është duke nxjerrë avull. Ajo bishëz e vogël kënaqësie që atë çast të tërëve kish nisur të na kafshonte. O zot sa pak perëndi prej asaj kohe ka mbetur. Unë jam i vetmi kujtonjës i saj dhe trishtohem prej faktit se nuk munda kurrë atë gjë ta bëja të përjetshme. Jepu sa të duash frymë fantazive të tua dhe ato të mjera në një legen gjaku do të vdesin. Trishtohu sa të mundesh sepse një ditë jeta të nxjerrë prej ëndërrimeve me krahët e saj të hekurt. Por verë kaq aristokratike kurrë më s'do të kem pirë dhe valëzat e një dehjeje të ëmbël duket se nuk e kanë mbërritur ende bregun e kënaqësisë së tyre, për deri sa unë prej kësaj kohe të largët i artikuloj duke u përpjekur që të ketë në to sa më shumë gjuhë perëndie. Zoti im që më sheh dhe më përgjon tani kur çasti për tu shprehur të vërtetën ka mbërritur. Sikur ne që mblihdheshim në atë dhomë të vogël gati një herë nëjavë dhe përjashta për të na bërë roje do rrinte përherë një grua. Le të mbetemi të tërë anonimë sepse kujtesa postmortum

tani po bredh në një kovalishencë qiellore. Le të hedh dritë dhe ylli im i mbramë sipër këtyre fjalëve që i kam thënë vetëm në besë të Zotit. Njeriu ka nevojë të zhytet në këtë trishtim të ëmbël për tu harruar ashtu siç e mbërthen gjumi një natë nën një kurorë peme e mbuluar me dritën e hënës. Për të ardhur gjer te çasti kur shpërthejnë në kujtesë këta shatërvane të vegjël uji. Sepse njeriu ka nevojë të harrojë një çast ndërsa kujtesa e tij është duke u mbushur prej këtyre rrëkezave, që rrjedhin me gurgullimë prej maleve në ditët e para të një pranvere, që tani sa vjen e bëhet edhe më e largët. Si çasti i këputjes së një ylli që na ve në kërkim të yjeve të tjerë në qiell.

6.11.08

VRAPI I ÇMENDUR I MAKINAVE

Po sikur përvojat të ngecin diku për shkak se rripi i tyre i transmissioinit është këputur?A s'kemi perandori dhe popuj të tërë të zhdukur. A s'jemi tani duke ecur pa Bibliotekën e famshme të Babilonisë -enigmë që më kurrë s'ka për tu zbuluar?Shumë gjëra nuk janë më midis nesh madje as në përfytyrimet tona. Veç gjer këtu kemi ardhur me shpresë se çdo gjë në këtë botë është e rastësishme. Ne që ndodhemi sot këtu në kohën e përpunimit të përvojave të rëndësishme. Kujtesa punon maksimalishtpër tu zëvendësuar me trurin elektronik të makinave. Është e çuditshme por e shkuara e përvojave tona as që zihet më në gojë dhe ato po kthehen mbrapsht për të zbuluar nyjet ku janë këputur. Në monitor shoh trupin tim dhe zbuloj nyje, pjesë të munguara, shoh ndërprerje më të gjata kohësh që unë s'kisha arritur dot për t'i kapur. Po ku vallë është ndërprerë koha ndërsa nga epokat një në tre prej tyre për fare ka heshtur.Ndërprerjet e përvojave më vonë do shikohen si domosdoshmëri sepse vetëm përmes tyre ne provojmë se gjendemi këtu për të mos u arratisur nëpër kohë të tjera. Sa e sa herë kisha menduar se unë mund të isha një njeri tjetër me të njëjtën nënë por me baba tjetër, por edhe me rrethana krejt të tjera të cilat nuk e di se ku do të më kishin përplasur. Përmes këtyre ndërprerjeve ne nuk njohëm shumë shpejtësi që kishin ndjekur hapin e parë.Edhe pse rrota më vonë pati një

perfeksionim i cili na ndihmon për të zbuluar shpejtësinë në km/në orë për kohën e rrezeve të mëdha. Te përvoja e ndërprerë e para ngriu një dorë e cila u ushtrua me mijëra vjet për të përpunuar gurin. Aty e shënuar në faqen e një shkëmbi do të na tregonte dhe fundin e epokës së Gurit. Kështu do të ketë ndodhur derisa vazhdon të ndodhë edhe sot ndërsa makinat pa u ndalur shndërrojnë në karakterat e njera-tjetrën. Po në tregun e antikuarëve dhe vjetërsirave mund të të kapin të qarat, për sendet e tu të veshur që tani kanë dalë në shitje si e shkuar e një epoke në perëndimin e saj. Ne vet jemi diçka e ndërprerë me harresa të mëdha në mes, me kohëra që nuk i jetuam dot-gjumë letargjik ku na kish përkundur historia pa mundur dot të na tregonte se në fakt çka ishte duke ndodhur. Sot ka popuj të përgjumur të mbërthyer fort pas traditës e cila u është kthyer në një lloj skallavërie. Por çdo gjë varet nga përjetimi dhe meqënëse ndërprejet historike këtu janë të mëdha, ato nuk janë në gjendje të shihen në pasqyra. Të parët në pasqyrë është këshilla që na japin përvojat tona. Traditat e ngurtësuar janë ndërpreje të mëdha kohësh, stanjacion përvojash, fëmijë që plaken të mbetur fëmijë të përjetshëm. Male si kufij të pakalueshëm, mbretër të vjetër të kthyer në zota prej aty ku lind e perëndon dielli. Në Ballkan ka patur ndërpreje të tilla të mëdha me plot çrregullime. Te parmenda rendte një makinë moderne, shembulli i së cilës përparonte me shpejtësi. Ndërprerja mund të jetë mbi dy mijë-vjeçare ndërsa hapat për të kapur perspektivat tepër të ngadalta, kështu që të shkuarat do të ishin përherë mbretër të së sotmes. Një makinë- hije e një karroce përherë pas është duke e ndjekur. Këshilla e një përvoje si freri nëpër dhëmbë të një të çmenduri që e frenon për te një marrëzi tjetër edhe më e llahtarshme.

12.4.10

NË TOKËN KU RRIKET VETËM E VËRTETA

Po i drejtohem prej këtu një pike të vdekur, të pakthyeshme, aty ku shkojnë përherë ëndrrat për të na kthyer sërish këtu prej nga ishim nisur. Të vjen për të qeshur nganjëherë me këtë vrap që vdes te fundi. Një marathonomak-hero ekzistencial i një metafore. Mos vallë jemi në kërkim të asaj që kemi humbur? Pse gjithë ky vrap kur shpella do të jetë si gjithnjë fare pranë. Tingulli metalik i hapave na sjellë në kujtesë rrjedhën e gjakut që kullonte prej këmbëve. Një trajektore e vetme që lidh dy pika të cilat nuk i shmangen dot njera-tjetrës: lindja dhe vdekja. Në fillim ishte padija që na nisi për udhë dhe na mësoi të ecim duke na thyer këmbët. Kanë qënë kohë të arta ato prej të cilave ne ruajmë shumë kujtime në albumet tanë të familjes. Sot në një lloj starti e shohim veten nëpër ato fotografi dhe tipare që ndryshojnë vazhdimimisht prej njeri-tjetrit. Por në çdonjerën prej tyre ka një kohë të ngurtësuar, statuja vendosur si gurë kilometrikë për tu orientuar në pafundësi e cila mendonim se na priste përpara. Një e tillë ndjenjë më kishte pushtuar në kohën kur Gagarini kreu fluturimin e parë kozmik dhe njerëzimi u mbushë njëherësh me ëndrra. Po shkonim drejt një bote tjetër nëpër lartësi ta paimagjinueshme, ku jetën siç e mendonim atëherë nuk e ndjek dot më pas vdekja. Vdekja do të mbetej në tokën ku kishte lindur. Më vonë pas udhëtimeve të tjerë kozmikë, zbritje në Hënë e udhëtimin drejt Marsit na tregoi se shkretëtira

dhe jo jeta në qiej ishte e pafundme. Njeriu po kthehej në tokën e vet për të vdekur me një pishtar që ua linte në dorë brezave të tjerë, të cilët dhe ata njëlloj si ne do të ushqeheshin meëndrra. Në kohën e fëmijërisë sime u fotografuam të tërë para një perspektive të panjohur dhe së- shkruan Updike/Ajpdaku/ veshja e saj do të na përcaktonte. Mos vallë kjo që kishte ndodhur ka rritur largësitë nga një periudhë te tjetra dhe ne të tërë kemi jetuar me iluzionin, se sa larg mund të vraponim me atë që quhet shpejtësi dinamike. Do të thotë që mund të kemi fluturuar më tepër se sa kemi ecur. Kjo është diçka që ndoshta nuk e kishim dashur. Ishim rritur tepër sa për tërë kohët e pritjes, kohë që më vonë do të ngadalësonte ritmin në ecje për t'i dhënë më tepër peshë mendimit. Dukej sikur s'ishim vet ne por thjesht pjesë e të një shkuare që na ndiqte pas plot keqardhje. Prej fluturimit të Gagarinit do të ktheheshim shpejt në tokë për tu marrë me punët e tokës, me planet e vegjël dhe si fëmijë që ishim do na i mbante më mirë në zap ëndrrat.

14.4.10

RETË...

Një mënyrë për të parë një re në qiell. Re të bardha me pak rrezatim në të kaltër. Një re e vetme e ndjekur prej bijëzave më të vogla. Si një ushtri e shpartalluar që po kthehet e humbur prej luftës. Vozitn në qiell dhe duke ikur lënë pas ca re të zeza si gërmadhat e luftës. Nëse ka dhe pak kohë do ta ndjek këtë Vaterlo në qiell. Qielli duket sikur pasqyron gjithnjë nga lart atë që po ndodh këtu posht. Indiferenca s'ka më asnjë arsye për tu ushqyer dhe ti u vihesh mbrapa reve, një rreziku që sa vjen e bëhet më kërcënues . Tani je i lidhur me to përmes një mijë fijeve. Retë e tjera që vijnë pas janë zemërata njerëzore hakmarrëse. Kjo nuk është thjesht lojë e fantazisë sime por një rezultat i frikshëm, pasojat e të cilit do të jenë të pashmangshme. Film pa zë që pak më vonë do të shkrep me bubullima. Reja e parë e madhe tani ka ikur shumë larg, përtej vështrimit tim dhe unë gjendem këtu në ballkon i kapur prej një frike, që në fillim ishte thjesht kureshtje njerëzore e fiksuar në qiell. Sikur unë të kisha qënë në gjumë kush e di çfarë drejtin tjetër mund të kishte ndodhur. Një realitet i shtrënguar në morsën e një ëndrre. Më duhet të përballem kështu i zgjuar me natyrën e cila është duke lëvizur orën matëse të kohës sime. E vërteta që shfaqet përmes reve të kthehet dhe katastrofat do të ndodhin në tokë qoftë edhe për shkak të mungesës së vëmendjes. Natyra na dërgon lajme edhe të këqija nëpërmjet

një reje të vogël të bardhë dhe, ne duhet të dimë të lexojmë në të çfarë është shkruar. Natyra u bë zbulim i mendjes sime. Po edhe më e pakuptimtë do të ishte në këtë rast indiferenca ime. Ndërron vetëm mënyra ime e të parit. Lajmi është duke i rënë kambanave. Duhet të vrapojmë më tepër se reja për ta kapur atë për fyti dhe të ngrejmë me shpejtësi diga, për t'ia zbutur reve zemërimin që mbart edhe ca të vërteta të tjera, si zbulime të mendjes sime. Na duhet një marrëveshje me natyrën për të paguar në kohë haraçin për atë që asaj i kemi rrëmbyer.

27.10.14

PËRFYTYRIMI SI UDHË

Për të ikur nga ky realitet i mërzitshëm s'më mbetet gjë tjetër përveç përfytyrimit, sepse një ëndërr nuk mund ta shohësh kur të duash. Dhe çfarë përfytyron në këtë arratisje të mendjes është mrekullia që në garë me fantazinë ka ndërtuar gjithçka me lëndën e e mungesave tona. Edhe kjo mund të jetë një lloj zgjidhjeje për të shëruar vetminë tënde. Për ku vallë po shkoj kaq larg pa e kontrolluar veten se çfarë prej realitetit të saj kam humbur? Unë përfytyroj një vend ideal që më sjellë prehje-një miqësi të pazakontë të humbur dikur dhe të rikthyer si dëshirë për ta rigjetur. Nën pushtetin e ca maleve të lartë nëpër një shteg të njohur që më çon ngadalë drejt një oazi për t'i shpëtuar makthit të shkretëtirës. Gjersa në një qafë ia kanë behur dritëzat e një agimi shumë të njohur. Ti ke nxituar pikërisht për te kjo qafë për të arritur atje në kohë dhe për t'i bërë një pritje madhështore kësaj shfaqjeje, që mund të interpretohet si eklips në intervalet e një kohe të gjatë. Pra ti je në udhën e përfytyrimit tënd dhe nuk i ke zbritur ende këtij kali të hazdisur të mendjes. Atje ku po shfaqet ajo-magjia e lindjes. Ca shigjeta të padukshme do të zbulojnë tani vendin ku ndodhesh. Je në Qafën e Korës-posht është një shteg i hollë gjarpërues që të çon në Siodel ku rrjedhë një burim uji. Malin këtu e kanë çarë këmbët e njeriut dhe patkonjtë e kuajve. Një aromë rigoni përhapet nga të dyja anët e luginës. Ti tani je bërë një Volter i çuditshëm në çastin

kur ke zbritur në fushën Ceretave. Nis të dallosh të verdhën e luleve rrugës dhe nxiton edhe pak për ta rrokur këtë pamje në një gjendje të tillë dehjeje, pak para se dielli të jetë shfaqur që përtej maleve dhe Qafës së Skërficës. Këtu përfytyrimi shuhet dhe nuk mund të vazhdojë më tutje sepse ndërkohë ka rënë kambana e vogël e orës së përditshmërisë tënde. Jam shkukur prej kësaj mrekullie duke lënë atje peng veten. Në një kthim disasekondash për t'i shtrënguar mirë morsat në mendje që e braktis në çast lojën e saj që mezi pret t'i jepet përsëri me kaq ngazëllim një mrekullie tjetër.

17.10.14

PARA SE TË BËHET DRITË

Nuk e di ç'ishte në të vërtet ajo që po kërkoja tërë ditën. Dritë që më shuhej sapo e merrja në dorë në formë lënde. Aq sa herë kam këmbëngulur po aq herë kam dështuar. Kam mbetur njeriu i përtëjmë i lumit që po ikën. Kam bërë një mijë përpjekje duke i dalë nga të tëra anët por dështimi që përherë i njëjlojtë: në duar vetëm hiri i asaj që ishte djegur. Tym është në fillim para se të bëhet dritë dhe errësirë është pas hirit. Unë kam mobilizuar krejt qënien dhe kam zbuluar brenda vetes martirin por martirët nuk përfytyrohen të gjallë përveçse të vdekur. Më ka ardhur shumë keq për kohën e cila nuk ka qënë përherë e imja. Në të shumtën e rasteve unë atë ua kisha rrëmbyer të tjerëve. Por nuk mu dorëzua askush dhe ndjehem keq sa shoh këtë njeri që kish ëndërruar lartësitë dhe e pa veten edhe më posht prej epokës ku kishte nisur të ngjitej. Nëse vendos të tregoj ndonjë histori të tillë lexuesit do të më përqeshin, i pari lexues do vendos në vend të saj një histori edhe më të dhimbshme. Unë vetëm sa u kam sjell atyre kujtesën dhe si autor i këtyre fjalëve do të flakem si një histori e padëshirueshme që u ngacmon të tjerëve plagët. Atëherë mbetem krejt i lirë në këtë poemë pa subjekt, të hyj e të dalë prej saj. Unë në të vërtet vuaj si çdo njeri tjetër por ata e kalojnë nëpër gjymtyrë të tyre këtë dhimbje që vjen prej zonave të thella të trurit. Kam dashur në të vërtet të thoshja atë që nuk kam mundur. Kjo ka qënë një luftë e përbindshme gjer sa e kam

parë veten të shqyer. Kam luftuar duke i grisur pamjet që asnjëherë nuk më shfaqeshin përmes gjakut të trupit tim të martirizuar. Unë nuk i kam zbuluar dot viktimat dhe ato hakmerren duke më torturuar dhe në vend të ujit etjen e shuaj duke pirë gjakun e tyre. T'i besosh alkimisë që përziën ndjesitë me lëndën për të rikrijuar në një mënyrë tjetër botën. Por unë për fat kam mbetur në luftë. E vetmja fitore e arritur me një mijë të vrarët e mi. U shtrova atyre këtë shtrat të përgjakur. Jam gati për të marshuar nesër. Në agim me harresën si pasuri që e lejon kujtesën time të rilindet prej hirit. Po e le hapur dritaren të fryjë tërë natën era. Era e kohëve të largëta; të një fëmije që kacaviret nëpër mur të ngjitet te hekurat e dritares. Po kërkoj zëra të tjerë për të mbjellë me ta shkretëtirën.

23.4.10

TRE MANAT

Gjë e çuditshme. Një fat i paracaktuar. Tre mana në verandën përpara ëmbëltores në Menidhi më bën të mendoj për mungesën e një miku, për atë hapësirë të zbrazët në të cilën asgjë nuk po shkruhet. Në lëkurën e njerit prej manave po ushqehet një prej degëve të manit tjetër. Si të thuash i është ndërkallur goja te stomaku, zëri te mendimi. Ngjan vërtet si libër i shkruar natën, si njerëz që kishin parë krevatin e zbrazur dhe pastaj si somnambul në errësirë kërkonin njeri-tjetrin. Ashtu i kishin gjetur të kokolepsur mes mbulesave dhe duke u përpjekur për ta nxjerrë prej tyre vetë në atë rretë kishin ngecur. Përqaftimi i degës së parë e kish zgjuar nga gjumi të fjeturin e fundit. Tre ushtarë që i kish zënë gjumin natën në llogore. Tërë natën ndoshta kishte fryrë erë dhe kishte bërë shumë ftohtë. Kisha zbuluar papritur lumin që brenda meje tërë natën kishte rrjedhur. Tri qenie mbetur gjallë prej apokalipsit. Natyra iu bë gardh erës përballë rrezikut të shfarosjes. Dhe manat duket sikur thonë: Jemi këtu për të mbrojtur jetën. Jam i sigurt se sikur njeri prej manave të shkulej tani nga toka, njëherësh me të do të vdisnin edhe dy të tjerët. Ja pse e kam të vështirë të përdor fjalë tjetër në vend të fjalës vdekje. Vyshkja ose tharja në këtë rast do të çmitizonte këtë mrekulli të natyrës, përqaftimin e tri qenieve që një ditë do të ndahen nga kjo botë brenda një çasti të vetëm.

Shtator 2009

EKSPRES PUBLISHING

Mos e kini parë vallë një burrë me një çantë në ngjyrë blu të hapur varur në qafë? Çanta është e stampuar:Expres publishing. Njeriu kalon përditë te kjo rrugë në të njëjtën orë. Është ora që unë tani po e pres. Ai është njeri që nuk i ndryshon parimet edhe pse mund të thuash se bota e instikteve të tij nuk është mjaft e zhvilluar. Ai nuk ngjan pothuaj me askënd. Dhe nëse e pe diku në rrugë duke ecur i thuaj që unë këtu jam duke e pritur. Këtu këmbenim pothuaj çdo ditë në të njëjtën orë mesazhin e përpikërisë. Tani jemi para faktit se ora e kohës është prishur. Ajo ka qënë përherë motivuese dhe unë tani ndjej keqardhje të thellë për prishjen e kësaj rregullshmërie. Ai ka qënë përherë i dobishëm për kohën sepse i rri varur në qafë si penduli i saj. I thuaj se unë ndjej keqardhje të thellë për prishjen e njëanshme të kontratës që ai kish bërë me kohën. Një lloj si koha të ishte e përjetshme. Po e pe atë njeri tregoi për mua që vuaj në pritje. Ai që humbi tani nëpër natë sikur ka marrë mbi supë tërë vetmitë e botës. Ai njeri shpinëkrrusur që duhej të ndodhej tani kudo për tu ushqyer me frymën e çdo mungese. Atë që e ka kapur inati me kohën dhe ka vendosur t'i ikij asaj, por unë kam çuar lajm për të gjithë për ta kthyer prej rrugës. Ky njeri që ka si shenjë vetëm një çantë të stampuar me expres publishing ka anuluar si një aerodrom i shkretë tërë fluturimet. Ai që duhet të qe tërë lumturia e botës u bë vetmia e papërballueshme e saj dhe s'ka

për ta kapur asnjë shigjetë zemërimi. Ky ujk i vetmuar ka urinë e tërë të pangopurve. Ai është kambanë në qafën e secilit por që lajmin e hidhur e mba për vete.

17.10.17

RRETHIMI I GJELBËR

Një nga ato pamjet e rralla që ndryshon papritur rrjedhën e përjetimeve tona. Edhe kjo duhet të ketë qënë pjesë e misterit që na rrethon. Ndësa isha duke shëtitur në parkun e madh të Perisosë, një pyll me pisha e ullinj, u ndjeva i tëri i përfshirë prej flakëve. Një perëndim i pazakontë dielli këtë mbasdite shkurti. Rrezet e diellit që depërtonin nëpër hapësirat e degëve të pemëve më kryqëzonin në çdo hap. Natyra ishte duke bekuar njeriun. Njeriu shumëfishohej për tu bërë i përjetshëm. Drita e përflakur e diellit më ndiqte prej çdo kurore peme dhe unë u gjenda i tëri i përfshirë në një përjetim marramendës. Ngado shigjeta të përflakura më sulmonin si një i përndjekur që janë duke i dalë flatrat për të ikur në një tjetër qiell. Pas shumë ditëve me shi e të ftohtë natyra u shfaq si një zot që po dëgjonte lutjet e njeriut. E nxjerrë prej një gjendjeje të zakonshme ajo si të thuash po karikon bateritë për energji të reja. Ja ku po rrjedhë tani në perëndim gjaku i diellit dhe pas pak do të ulet ky sipar madhështor që njeriu të mbetet i mbyllur brenda një misteri. Vetëm se na duhet të zgjedhim këndet prej ku natyra me bujarinë e saj na bënë këto dhurata të paçmueshme. Të gjelbrit e kanë kuptuar më mirë këtë mesazh ndërsa të tjerët kryejnë sistematikisht sulme ndaj natyrës. Prej andej ku lind e perëndon do të jetë përherë një diell përvëlues, pa kurorat e pemëve që përpunojnë dritën diellore duke rritur biodiversitetin

29.2.19

ZOGU QË LIND E VDES NË QIELL

Kësaj shqiponje i majfton forca në vetvete. Për të kryer fluturimin e saj nga një breg i oqeanit në tjetrin. Zhytjen në thellësi të ujërave për të siguruar ushqimin i cili qëllitet i papërtypur. Vetëm në saj të një organizmi të tillë kjo gjë bëhet e mundur. Forcë që e ka bërë trupin e këtij shpendi një astronute të shkëlqyer. Kjo fuqi bëhet edhe më e madhe prej rrahjes së ajrit në të njëjtën kohë me të një tufe, e cila fluturon përherë bashkë si një dërgatë që përshkon oqeanin dhe qiellin. Kjo forcë e mahnitshme që ende nuk i është përshtatur konstruktit të asnjë makine. Ritëm dhe lëvizje fluturuese dhe pastaj mbi ujëra ecje me të dyja këmbët. Kurrë s'kemi për të zbuluar gabime të kjo përkryeshmëri që e fsheh për mrekulli dhe vdekjen. Ne që e shohim prej dritares zbulojmë diçka që përherë na tejkalon edhe neve që me avionët e rëndë jemi duke përshkuar udhët në qiell. Aty ku ne nuk jemi të pranishëm dhe duke parë prej dritares së avionit na ze gjumi. Ndërsa ky shpend vigan i kryen vet të gjitha, ai di edhe të klith prej një gëzimi të çmendur. Makinë e vogël prej mishi por me një fuqi të llahtarshme që i sfidon përherë të gjithë rreziqet. Kjo fuqi e pazbërthyeshme edhe prej fantazisë sime të gjorë, që do shpik në të ardhmen makina të tjera fluturuese, nuk arrin dot t'i ndal vdekjet e herëpashershme përmes aksidenteve qiellorë. Ky zog madhështor është duke sfiduar gjithçka dhe fuqia nën krahë i jep një guxim spektakolar,

aq sa është duke lozur mbi oqeanet dhe pafundësisë në qiell. Koha që iku dhe koha që po vjen duke na bërë sfidë ndërsa me avionin e linjës po udhëtojmë përmes qiejve. Koha që la pas makina të përdorura në varreza hekurishtesh, por e ardhmja do ta ketë të vështirë të kopjojë gjer në imtësi këtë zog që po na përshëndet prej dritares së avionit, si për të na kujtuar se ka dhe zogj të tillë që lindin e vdesin në qiell.

Tetor 2012

TË SHKUARA TË LARGËTA

E shkuara jonë ka humbur. Kjo ndodhi dikur dhe tani përpëlitemi nëpër rrënoja për të zbuluar qoftë edhe ndonjë relike të gjuhës sonë të vjetër. Ajo që u zhduk përtej jehonës së saj të largët na sjellë herë pas here vetëm ndonjë fragment të shkëputur-klithma të zërave të lashtë kur të ardhmen e tyre e kishin thirrur. Një e përditshme mizore qëpo e gllabëron pandërprerë të shkuarën. Ku është Manastiri i lashtë, ku janë Ledhet, ku është një karakoll, një ninullë duke u kënduar mbi djep, një regjistër kishe si institucion i kujtesës? Dhe një kalë i vetëm ku është. Një fustanellë shumëpalëshe burrash dhe opingat me xhufka. Nuk u bë as ceremonia mortore e tyre kur përfundimisht na kishin braktisur. Në vend të tyre prej tokës mbiu ky bar i egër. Urtësi që fle ende nën peshën e një marrëzie kolektive. Zoti im sa shumë kemi humbur. Nëpër rrënjët e kalbura kërkojmë ndonjë syth të na tregojë prej nga e për ku shkonte kuja. Pasqyrë që i mungon së sotmes për tu parë tek e shkuara. Jo predhat e artilerisë, as nata apokaliptike e Pashkës së Madhe kur një fshat i tërë u terrorizua, por ndërgjegja jonë fle akoma. E tërë toka rreth e rrotull duket sikur rri pezull. Në hartë mungon dhe udha që bëri Kostë Aleks. Kjo e përditshme krimin e ka brenda vetes. Ajo do të udhëtojë me këtë mungesë mbi shpinë pa ditur se ku do ta çojë të ardhmen. E sotmja nuk ka marrë aq mjaftueshëm dritë prej së shkuarës, për ta çuar këtë të shkuar drejt një të

ardhmeje sa më të largët. Është ajo rregullsi ikumenike ku tre kohët konvergojnë te njera-tjetra. Pasojat prej kësaj parregullsie sjellin drama të rënda për popuj të ndryshëm, që as arkeologjia, as historia nuk e mat më dot kohën e daljes së tyre prej shpellës. Vetëm vjetërsia në moshë e gjuhës është meritë dhe jo operacionet që kryhen herë pas here, për të zbuluar kohët kur zërat ishin ndarë prej klithmave të tyre.

21.4.18

FIJE TË HOLLA TË PADUKSHME

1.

Më duhej një çast për ta vendosur atë që po kundroja si pjesë të një universi. Çasti duhet të ketë qënë magjik përndryshe as unë s'do të kisha qënë ai që po kumtoja një dukuri kaq të zakonshme të përfshirë në vorbullat e gjithësisë. Jam në një kënd ku tani nuk ndodhet askush ose marrë prej dukurive sinjale që nuk u kanë mbërritur ende të tjerëve. Dhe prej çastit që po bëhet kohë e pambarueshme unë i zgjeroj kufijtë për të zhbërë ndarjen mes të shkuarës dhe së ardhmes. Çdo gjë që shoh, prej perceptimit tim hyn në lidhje me të tëra kohët. Ky precedent që më jepet nuk është ndonjë lloj dhurate por trysni te mendja ime për të shpjeguar botën. Asaj që nuk i ka mjaftuar kurrë asnjë shpjegim për shkak të relativitetit të saj të padiskutueshëm. Te ky çast i përndezur prej magjisë së dritës e afron atë më shpejt te burimet e saj dhe unë zbuloj lidhje që më shumëfishojnë përfytyrimet. Te çdo objekt ose presioni atmosferik që shndërrohet në shumën e tërë ndjesive tona, unë sërish gjej një pikë tjetër për të shpjeguar anë të tjera të panjohura. Te një relike e saj ose te çdo gjë tjetër që e ka mbuluar pluhuri unë ve fshesën për të nxjerrë në pah kujtesën. Çasti më ka dhënë lumturinë e një zbulimi sepse ndodh shpesh që te njeriu i gjallë bota përreth tij të përfytyrohet e vdekur.

2.

Natyrë, TV, internet, mjedisi brenda shtëpisë, zogjtë, pëllumba, mëllenja, trumcakë, biseda ime me ta, çfarë hyn e del nga brenda-jasht, nga jasht-brenda. Sendet që prek duke u dhënë frymën time. Një mori ndjesishë. Largim në çast prej njerës për t'iu afruar një tjetre. Një botë e tërë në lëvizje. Unë, zëri im që mungon dhe frika prej prishjes së rregullit. Unë dhe rrethimi. Dhe nëse s'do të isha i rrethuar nuk do të zbuloja dot as vetminë time. Brenda saj kërkoj një mënyrë për të dal jasht. Dhe gjithçka e rënë në këtë rrjetë të pafajshme merimange. Është vet kujtesa e mpleksur te koha. Me një fill në mendje tërhiqen miliona fije të tjera. Prej një kambane sado të vogël vjen kumbimi i të tëra kohëve. Pa këtë rrethim ne kurrë s'do të ndjeheshim të vetëm. Unë strukem aty për të parë nga larg së thelli. Për të zbuluar shkaqet prej nga vjen e keqja. Edhe pse diafragmën e tërmetit e shohim nga sipër orën e saktë të shpërthimit ai e ruan për vete. Pjesë të kësaj shumësie jemi të tërë dhe sa zbërthehet njera nisin rrokullimën të gjitha. Ekuilibër i brishtë që prej fjalëve të druajtura i qasen plot delikatesë një shprehjeje. Në këtë pafajësi ju do të bëheni të përjetshëm, krijesa të vogla që vetëm një shkrepëtimë e flaktë inteligjencie i ve në dukje.

3

Nuk di se sa këto mund të përbëjnë të tërën, ku prej një amforë mund të zbulohen mënyra të sofistikuara për të fshehur emrin posht shkrimit. Shumë gjendje të ndryshme mund të përfundojnë në një dhimbje të vetme. Shumë njerëz në shesh apo në udhë bëhen papritur rrjedha e një lumi të vetëm. Është një lumë që pret tërë përrenjtë përgjatë rrugës. Kur ne e nxjerrim heroin nga turma me të jemi duke identifikuar vet turmën. Nëpër

pjesët nuk duket më as peri as gjilpëra që këtë kostum e ka qepur. Çfarë mesazhi na jep vallë Da Vinçi tek vizaton pjesë të trupit tonë dhe përmes tyre gjysma tjetër duket se e tejkalon vet kohën. Pjesa bëhet kështu vet e tëra ndërsa e tëra është duke dorëzuar një nga një pjesët e saj në një shprehje të vetme. Edhe këtë që unë tani po e shpreh është leja e marrë prej kohës pasi ajo nuk ka mënyrë tjetër për tu shfaqur ndryshe. Bashkimi i pjesëve është arti i pasthirmës për të shkuar te fjala. Unë ndez një motor për të shkuar e tërë kjo energji në një fuqi tjetër edhe më të madhe. Lumi u bë drita jonë por vetëm një çast i kapur në kurth lumi na dorëzohet për ta përpirë më në fund errësira në detin e saj të pafund. Është hapur diku një shteg i ngushtë për të shkuar tek udha e madhe. Njëlloj si rrëkerat, fjalët që mund të përfytyrohen si një gurgull tingujsh që përcaktojnë vet natyrën e gjuhës

11.3.16

NËN KURORËN E PEMËS

Më vonë gjithçka bëhet e dukshme dhe nis të marrë jetë një përfytyrim apo ëndërr. Natën kur kurora mbyllet si ombrellë dhe njerëzit nën të toka i mba fshehur. Aty ishte një sfond pa thellësi ku lëviznin hijet që nuk i shfaqnin krejtësisht trupat e tyre. Lëviznin njëkohësisht hijet dhe njerëzit për të ndarë atë pak hapësirë nën kurorë që do të shërbente si çati natën. Përgjatë ditës ata shtrëngohen edhe më tepër për t'i shpëtuar diellit të shkretëtirës. Njerëzit në mëngjes zgjoheshin kur kurora hapet dhe ata dilnin njëherësh nga toka si rrënjë të pemës për të thithur dritën e agimit. Më vonë njerëzit do kuptonin se ajo nuk ishte thjesht një kurorë por një vidh që hapet si erashkë ndaj peizazhit. Këta njerëz i kish bërë bashkë koha si shenjë se jeta është ende e gjallë te shkretëtira. Vidhi ishte si të thuash vet zemra e shkretëtirës. Nën kurorë fryn një fllad i lehtë, një dashuri fjalësh që hapen ngrohtësisht ndaj njera-tjetrës. Dhe që këtu nisin përpjekjet e ardhme për të shpëtuar tokën dhe njeriun. Kur njerëzit nën të zbuluan se kurora ishte një vidh, vunë veshin për të dëgjuar gurgullimën e ujërave të nëndheshëm. Një stacion planetar i ngulur këtu për të sjellë jetën nëpër thërmiat e rërës së vdekur. Frymëzimi i tyre shkoi përtej këtij parashikimi. Ata menduan se mund të ngjallnin edhe një shkurre të tharë prej etjes. Në ata sytha që po shuanin etjen me ujët e burimit, kurora dukej sikur përherë rrotullohej për të

marrë aq dritë sa i duhej hijes së saj. Dhe në atë pozicion ajo kishte dhënë edhe frymën e fundit. Të ngjuarit po thithnin tani një frymë tjetër dhe hija zgjerohej ndërsa ata rrotulloheshin bashkë me hijen. Ata pas kësaj nuk do të ishin beduinët e shkretëtirës dhe si eksploratorë do të kërkonin burime të tjera jete. Mjaftonte kjo strehë dhe lagështia që vinte prej rrënjëve të vidhit, për të eksperimentuar se jeta gjallonte jo më nëpër epruveta të vogla , por në formën e vegimeve ku prej saj ata zbuluan sa thellë akoma mund të ishin shtrirë rrënjët e vidhit. Kur një vidh kish mundur shkretëtirën, njerëzit nën të menduan se dalëngadalë jeta do tu zbulohej përmes sekreteve të tjerë dhe ata të ngazëllyer si fëmijëpo festonin fitoren e parë mbi shkretëtirën.

26.4.18

PËRTEJ DRITARES ËSHTË KOHË TJETËR

Doja të bëja diçka tjetër. Të shprishja sa më shpejt të qe e mundur për ta bërë atë të mëparshme. Edhe pse toka nën këmbët e mia lëviz unë bëhem pengu i çuditshëm i saj. Nuk e kuptoj dot këtë statu quo. Është dora e ngrirë te dritarja që pak më parë u përpoq për ta hapur. Është dilema që më mba paksa të shkëputur nga toka. Ai që përpiqet të ikij por i mungon perspektiva. Sado i shkurtër të jetë ky çast mund të jetë baraz edhe me një mijëvjeçar Mesjete. E di që duhet të marë një vendim por jam duke pritur lajm prej perspektivës. Të nisem drejt saj për të mos mbërritur kurrë, apo të pres makinën tjetër më të shpejtë të mendjes sime që bën krejt fir kohën e saj. Shoh orën dhe kohën që më ka mbetur. Më duhet të vishem sa më shpejt për tu zhveshur. Piloti, palombari, bardi, eunuku-çfarëdo që mund të jetë ky- sa më shpejt për të ikur. Për tu ndarë nga kjo e tashme që na mba të mbërthyer. Dilema që e mban të varur perspektivën time. Përtej dritares është kohë tjetër. Ajo që po ndërron ngjyrën e pemëve për shkak të pranverës dhe të një morie lajmesh që na nxjerrin në udhë për të kërkuar ekuilibër të ri. Ekosistemi ka marë një të çarë tjetër të vogël. Prej bankave të mëdha po vërshon një kredit i ri disamilionësh për të mbyllur të çarën e madhe te kjo e çarë e vogël. Sapo jemi përplasur me diçka që na shkakton dhimbje. Është im atë në fotografinë e vetme së cilës i kaloj dhjetëra herë përpara, por këtë çast nuk e di pse ia ngula

aq gjat vështirmin. Ndoshta për të marrë prej tij leje nga kjo e tashme për të ikur. Prek çdo orendi dhe dëgjoj të tjerë tinguj. Jam në pragun e një arratisjeje prej përditshmërisë. Do ta ruaj kujtimin e këtij çasti flatrahapur te qielli i dritares, ndërsa këmbët po veshin këpucët në udhët e po asaj të djeshmeje për tu nisur.

3.3.16

NJË VIZITË TË SHKUARËS SIME

T'i japësh lumit ritmin e këtij përroi të zhurmshëm dhe pastaj të dorëzosh tek ai identitetin. Por asnjë pllakë përkujtimore për këtë sakrificë. Unë që kaq lehtë e kam dorëzuar veten të përsfaqem në detin e madh ku gjërat bëhen të padurueshme. Një vazhdimësi shprehjesh-skillevër të gjuhës, fjalë të dënuara të ecin të lidhura me zinxhirë nëpër kuptimet e njera-tjetrës. Atje ku vijnë për tu dorëzuar të gjithë duke humbur origjinën e rrënjëve të lashta indoevropiane. Askush tani s'mund të na thotë se kush që i pari fatthënësi- shqiptuesi i parë që me dëshirë i pranoi këto pranga dhe na fali këto fjalë të të tjerëve. Në këtë album familjar ku ti kurrë s'ke për ta njohur të afërmin tënd më të largët. Përmes shumë e shumë ndërhyrjeve ti gjendesh aty në rolin e një eksploratori , duke vënë përballë ngjajshmëritë dhe nëse fjalët e shkruara në anë, do të afrojnë edhe më tepër tek burimet ku shuhet jehonat e tërë kohëve. Po të kishe qënë ai përroi dikur i zhurmshëm ku kjo luginë e thellë i ka urtësuar gjithë përbindshat e fjalëve. Një biografi përherë e papërfunduar ku vazhdimisht janë duke ardhur vullnete të tjerë për ta përkryer gjuhën. Atë që unë tani sapo e kam shkruar dua t'i kryej asaj dhe një shërbim tjetër. Dialektet një nga një po vdesin, njëlloj si heronjë të lashtë mitesh dhe legjendash. Nëpër nyje të fjalëve janë këto pemë që mbajnë të shtrirë peizazhin rreth e rrotull, duke zbutur ashpërsinë e përrënjeve që dikur vërshonin prej maleve. Gjuha e ruan ende atë shenjë por tani e qytetëruar ka hapur muzetë ku ne me nostalgji vizitojmë të shkuarat tona.

5.1.12

KRIZË

Vetëm pesë gërma të një fjale por që shpëthen krejt gjuhën. Një demon që po na sillet rrotull. Paqartësia është ajo që përcakton vet natyrën e saj. Ka shumë dhëmbë kafshues dhe shumë kthetra. Vet jeta është nën diktatin e saj. Njerëz me pishtarë në duar që kërkojnë ta ndriçojnë atë nga brenda për të zbuluar shkaqet. Fle në shtrat me çdo njeri dhe duket se nis zagushia prej një të ftohti të padurueshëm. Është një fuqi e errët ku janë përfshirë të gjithë. Ajo pas nesh i ka mbyllur tërë portat dhe kazani zien. E ndoqëm itinerarin gjer sa u ndodhëm befas brenda qerthullit të saj. Kërkon të na hajë të gjithëve një e nga një gjersa ajo të shfaqet në formën e një skeleti prej ku do të mbillen shumë varre me të vdekur Guximtarët i kanë fshehur nën krahë flatrat. Të urtët nuk gjejnë përvojë tjetër me të për tu këshilluar. Ajo ka kapur fijen më nevrargjike të jetës dhe po na sjellë të tërëve rrotull. Ajo ka një madhështi të zyrtë siç mund të jetë madhështia e së keqes. Flamur që ka për simbole shpata dhe gjak. Që pas lajmit të parë që çoi për mbërritjen e saj, hokatarët më vonë e kuptuan se dhe e qeshura është e rrezikuar të shuhet. Ajo është kapur te secili për tu bërë fuqi e të gjithëve. Ajo ende s'ka emër se po lindet për herë të parë prej masturbimit të shoqërisë që e ushqeu me mendjelehtësinë e një shoqërie

që s'i trembet burgut dhe turpit të historisë. Është një lloj çmendine ku të urtët përpiqen të urtësojnë të marrët që mbajnë në duar fitilat e ndezur, të gatshëm për të hedhur me të në erë dhe veten. Kriza është një gjendje e skajshme ku të dy polet janë syrgjynosur në margjinë për të shmangur çdo lloj kontakti me njeri-tjetrin. Prej frikës së krijimit të fushës magnetike, ku me afrimin e dy palëve njeri mund të krijojë epërsi mbi tjetrin, kontakt i cili mund të kishte zgjidhur fare lehtë krizën. Tensioni i përhershëm është faktori më i dobishëm për ta mbajtur gjallë atë. Kriza është përherë shenjë se diçka është duke u majsur dhe brenda qetësisë si një kazan me ujë që nis të pluskojë për të na treguar se uji është duke u prishur. Të dy palët bëjnë kujdes sidomos në çastin e mbushjes së gotës mos ajo derdhet dhe atëherë kriza do shpallë grevën e etjes dhe përherë të dy do i sulmojnë burimet e ujit por me kushtin që u ve kuçedra. Pajtohemi për të shuar me radhë etjen sepse kurrë s'ka patur radhë për të vdekur.

12.6.19

PA MARRËVESHJE

Shkruaj për një betejë që s'ka për të përfunduar kurrë mes njeriut dhe tokës së tij. Pothuaj çdo gjë është pezull pëderisa pas vjen prehistoria për të na treguar si e qysh kishte ndodhur. Koha e mëpastajme që kthehet në gjykatës të së shkuarës. Toka që iu dha njeriut si shpërblim dhe njeriu që iu dha tokës për ta bërë të njohur relativitetin e saj. Por në këtë pak vend të këtij universi të pafund tani makutëria njerëzore po bëhet përherë e më agresive gjer sa arrin të prish ekuilibrat dhe forca e gravitetit po pëson devijime të paparashikueshme. Aq sa ajo s'do të ketë më fuqi për ta mbajtur tokën denjësisht si planet që ka për mision të zbulojë jo vetëm veten por të na ofrojë të dhëna se sa larg ajo ndodhet prej çdo ylli apo planeti tjetër. Njerëzimi rrezikohet të mos ketë më tokë të mjaftueshme që ushqen bijtë e vet edhe pse është duke sjellë sinjale shpresëdhënës prej yllësive më të largëta. Po ndryshojnë peshat në njësinë e lëndës dhe në miliarda njerëz mund të lindin miliona dëshira njerëzore për tu përfaqësuar si zëdhënës të saj. Gjë që është krejt e pamundur dhe tepër e rrezikshme për fatet e së ardhmes sonë të përbashkët. Është diçka që ndodh përherë por ne jemi shumë të zënë me këtë përditshmëri, për të parë rrezikun që po na dërgon gjithnjë e më shumë sinjale paralajmëruese. Miti u mbollë në tokë prej këtyre njerëzve si paralajmërim në mos qoftë ky një kob për të parë se sa afër mund të jetë fundi. Toka e

populluar në mënyrë të pavullnetshme është bërë tepër e rëndë për tu rezistuar peshave të tjera dhe forca e saj tërheqëse vazhdimisht po dobësohet. Toka po popullohet pa perzevantivë me farën që bombardon pareshtur mitrën dhe, duket se është gati për të sjellë vet pranverën e vdekjes së saj. S'do mundemi më të administrojmë dëshirën për tu lindur ose të lindemi me përzgjedhje, për të kontrolluar shumicën e paadministrueshme. Ai që vjen jasht çdo vullneti nuk është i mirëseardhur, sepse ai do ta gërryey tokën duke ia shterur fuqitë e dëshirën për mbijetesë. Kjo po ndodh tani çdo orë të çdo dite, aq sa nesër do të jetë tepër vonë për të shmangur apokalipsin.

18.11.11

NË PRITJE

Në pritje po shfletoja një revistë mode. Një diçka për tu harruar. Vitaliteti i harresës – thash me vete. Kjo magji e mrekullueshme. Harron edhe pse prej ç’shkaku këtu ndodhesh dhe nuk di se a do të të kthehet më kujtesa. Një qetësi e verbër spërkatur me aroma të çuditshme që nuk kuptoja dot se nga vinin. Vajza e shërbimit para një kompjuteri s’bënte asgjë tjetër veç lidhej me pjesë të ndryshme të botës dhe mu duk se ajo s’do të ishte kurrë në gjendje të krijonte një botë më vete. E huaj njëlloj si unë në këtë pritje. Si kjo revistë mode që jam duke e shfletuar prej gati një ore. Papritur një lloj flladi hapi një dritare të vogël në kujtesë dhe mu bë vetja Elisabet Bishop 1/ duke pritur mbarimin e vizitës mjekësore të tezes së saj. Bishop po shfletonte National Geographic dhe shëtiste nëpër botë të panjohura duke vlarë pritjen . Ishte kohë e fëmijërisë së saj. Njeriu vret edhe miza për të vlarë mërzinë duke u kalamendur dhe kur në tabelë ose në ekran janë zhdukur tërë shifrat monstruoza që më parë të udhëhiqnin si përmes një labirinti. Unë qeshem me vajzat e bukura të Revistës dhe ato si unë po kalojnë një kohë të mrekullueshme. Për të harruar në një farë mënyre vetveten. Veshin e zhveshin të mbathurat, korsetë, bikinët. Tani në këtë sallon janë bërë shumë njerëz, unë, vajza në receptor, vajzat e Revistës së modës dhe Elisabet Bishop që po vjen nga kujtesa ime, udhëtarja e largët-poetja e ardhshme e Amerikës që po

përshton tërë kohët me poezitë e saj të mrekullueshme, që i dhuroi ajo pritje e padurshme nën erën therëse të kloroformit. Harresa jonë ndihmëtare që na dhuroi një liri që më kurrë s'kemi për ta patur. Më pas do bien zile e do dëgjohen urdhra që çdo gjë qiellore e kthen në tokën e saj për të vazhduar ndërtimin e një bote që po rrëzohet. Çohu- më thotë mjeku që ndërkohë ka hapur derën. Njeriu më i panevojshëm tani iu shtua këtij vargu për të zhvendosur fantazmat që prej kohësh të largëta na ishin sjellur rrotull.

1/ Poete e njohur amerikane e shek XX

7.4.10

JEHONË ZËRASH TË LARGËT

Ç'është kjo vijë e lakuar të cilën unë e përshkoj përherë përmes isos së këngës së Neço Mukës, Vajzë e Valëve? Është diçka shumë e qënësishme që të nxjerrë zbuluar të tërin përballë një fuqie magjepëse si një identitet që s'ka nevojë të vërtetohet prej ADN-së së tij. Një iso që përshkon tërë vijën bregdetare prej Llogorasë gjer në Nivicë-Bubar ose e thënë ndryshe gjer në pafundësi. Pa lënë asnjë lloj pikë tjetër referimi . Një masiv gjigand shkëmbinjsh, me pak tokë dhe një deti të pafund që na bënë të ndjehemi pjesë e e këtij përjetimi, që shpirtëzon këtë peizazh të egër i cili zbutet vetëm atje posht kur i jepet pafundësi së në një mënyrë tjetër. Duket sikur njeriu kthehet prej së shkuarës për të shlyer një borxh por kjo përherë është më tepër se kaq, gjer në pashpegueshmëri. Janë lidhje rrënjësh të thella dhe lehtësisht të identifikueshme të njeriut me vendin, ku hapi së pari sytë për të parë prej çfarë rrethohej tjetër dhe gjendej i kërcënuar prej të panjohurave të shumta.

Ka shumë male rreth e rrotull, të rëndë e solidë, sfidues që i hapen detit për t'iu bashkuar njeriut si për të vënë në provë vitalitetin dhe fatin e tij. Prej këtij vjen kjo ngjizje që pranon të marrë për mbiemër emrin e maleve të saj. Udhë gjarpëruese e Bregur të Detit i ngjanë më tepër një klithme ose kuqeje për ta intimizuar këtë marrëdhënie të njeriut me natyrën. Këtu është

gatuar ky njeri i lashtë i ngulur në tokë prej rrënjësh të thella. Kënga profetike Vajza e Valëve ngrihet si një monument i rrallë përmes shtjellave të ajrit e dallgëve. Sikur njeriu i Bregut të jetë prani skeletesh të dinozaurëve të kohëve të Nendertalit. Për të ruajtur të pastër përherë këta imazhe ato i shfaqen detit prej shumë ballkoneve të këtij vargamali. Për këtë kult të Natyrës u gjet një njeri i rrallë si Neço Muka që përmes këtij monumenti tragjik i bëri sfidë vet historiae. Ky peizazh që kurrë nuk u kthye në pasuri materiale i përshkoi këta njerëz eshtëfortë përmes tatuazheve diellorë e erërave të sërta që i ngrinin dallëgët gjer te pragjet e shtëpive. Ky peizazh mahnitës si shfaqje e mitit modern ku zotat të trembura i gjenë ende të fshshura nëpër shkëmbinj e shpella. Duke marrë Krorëzën si një pikë referimi me të cilën më lidhin shumë kujtime të fëmijërisë, zbulova dy plazhe të vegjël të pazhvirgjëruar ende. Ky gji i vogël që një jetë të tërë ka pritur të zbarkojë prej frikës së qytetërimit këtu një Kruzo tjetër. Këto lartësi përballë thellësive të frikshme të detit-një kontrast që të ngazëllen mendjen dhe që shndërrohet në një përбетim që ka peshën e rëndë të ekzistencës . Sa të jesh gjallë kurrë atë s'ke për ta braktisur. Fuqi magnetike me prevalenca të larta shpirtërore. Krorëza në një ditë gushti të Shën Mërisë së Krorëzës ku grupe të tërë njerëzish shkonin për tu falur. Pastaj në çaste hareje e gëzimi laheshin në det dhe unë e kujtoj veten si u jepej duarve të këtyre burrave duke klithur prej gëzimit i mbështjellë prej stërkalave . Një lidhje që nuk do të zhbëhej më kurrë. Deti më kishte lagur, Shën Mëria e Krorëzës më kishte bekuar. Dhe unë do të nisesha udhës së mbarësisë sime.

Një vendi që në kushtet e ekonomisë së tregut po i rritet vlera tregon se i duhet të përballlet me një korrupsion edhe më të rafinuar për të nxjerrë jashtë lojë vendasit dhe tërë këto bukuri

do të mbeteshin gati të shpërftyruara. Bregu i Deiti ndodhet në shënjestër të të gjithëve. Duke e parë peizazhin prej një cepi të tij tani e shoh me syrin e një fëmije që vraponte për të qënë kurdoherë i pranishëm në një ceremoni të perëndimit të diellit. Më ka dhënë shumë ndjesi dhe i dha liri fantazisë sime gjer nëpakufi. Kjo bukuri e rrezikuar të shpërftyrohet më lutet që lutja ime të bëhet zë i urtësisë. Jepini kësaj vlere të pallogaritshme çmimin që ajo meriton.

Nuk di papritmas si më erdhi ndër mend një fjalë që i bën nder gjuhës shqipe: fjala Jet-o, ku bie ë =ja dhe dhe përftohet fjala jeto. Këtë e ka vënë në dukje së pari besoj shkrimtari i njohur me origjinë nga Vunoi, Anasatas Kondo. Jehona që shoqëron këtë fjalë merrë një ngarkesë të jashtëzakonshme. Si pershembull duke iu drejtuar atij me të cilin flet i thua: Jeto. Por duke e zhveshur nga ky kuptim i madhërishëm kjo fjalë kthehet në një rudiment dhe bëhet e vështirë për të kapur ngarkesën emocionale të saj. Jet-o ka brenda një thirrje që vjen prej brendësive të thella dhe që e shqiptojnë vetëm nënat, jo burrat as femrat në përgjithësi dhe vetëm kur ato bëhen gjyshe për të ruajtur eskuzivitetin e kësaj fjale. Ëshë ajo moshë ku dashuria njerëzore merrë përmasa universale. U ndala te ky zgrip në çastin që po përpiqesha për të kapur identitetin tim dhe mu ndërmendën shamizezat qi iu bashkëngjiten fjalës korba. Atje ku përgjithësisht jetohet në errësirë ose në gjysmën e sa j, ku drita nis të venitet. Shamia e bardhë pret shaminë e zezë. Ajo është gati e blerë qyshkur sepse çdo fatkeqësi pret ngushëllimin e saj. Vetëm ngjyra e zezë e fsheh dhimbjen duke u bërë frymë e fatkeqësisë dhe atë mundet ta përballojë me dinjitet vetëm një grua e veshur me të zeza. Ky është një lloj dënimi ose vetsakrifikimi përballë fatkeqësive. Njerëz të fortë si në romanin e Llaksensit Njerëz të Pamvarur që nisin të ngurtësohen si

skelete, por me një shpirt që ujitet nga brenda prej lotëve. Ato ishin nënat tona që ikën pa u ankuar kurrë për privacionet me barrët e rënda mbi shpinë që çelnin shtigje këtyre maleve për të sjellur mërquinjë.

Letrarët e Bregut vijnë çdo verë në festën e letërsisë për të promovuar me ndrojtje krijimet e tyre. Është e vështirë të thuash se kemi bërë letërsi të madhe po larg çdo paragjykimi mblidhemi këtu për të shlyer një borxh që secili prej nesh ka për vendlindjen. Një lloj shirrja e të parëve të Mark Tueni. Por një filiz do kohën e vet për tu rritur si një përpjekje për t'ia arritur një ditë qëllimit të saj. Unë vij këtu thjesht për tu matur të ky peizazh, për të zbuluar sa e vogël është vogëlsia ime. Për të mos kaluar gjer në mburrje ne kemi një përparësi prej mënyrës si si u ngjizëm dhe së pari lëshuam një britmë për t'ia dhënë së pari detit dhe pastaj një hapësirë pa kufi. Vijmë këtu edhe me një borxh të madh që do të mbetet përherë i pashlyer. Bregu i Detit që tani quhet me emrin e tij të vërtetë e të dikurshëm Himarë, vjen prej një historie të trazuar për të mbrojtur identitetin e vet. Por ai është një dhe i vetëm pavarësisht rrjedhave të trazuar të historisë. Është një shami e bardhë mbi flokët e nënave tona që më vonë do të bëhet e zezë për ta përballuar me stoiçizëm çdo lloj fatkeqësie.

28.6.19

PESHA E ÇDO PËRDITSHMËRIE

Është e trishtueshme të kthehesh tani pas në një nga stacionet ku ke ndaluar fare pak, gati sa për të marrë frymën që ta kish rrëmbyer ngjitja në atë mal të thepisur. Edhe pse është e tëra e shkuar prej këtij shkaku të epërm ajo nuk duhet refuzuar. Por tani e kam të qart ku ndodhem: në një pllajë të vogël prej ku zbresin disa kodra dhe shquaj së largu një grumbull njerëzish që çdo natë kalojnë këtu kohën e paktë për tu ngritur nesër më herët se çdo herë tjetër. Një garnizon i vogël ushtarësh gati në një gjendje më absurde se regjimenti i komandantit Doga që është duke pritur në kufi të shkretëtirës . Pritet urdhri nga komanda qendrore për tu ndarë në një farë pike me të shkuarën , në mënyrë që e ardhmja të mos vazhdojë të jetë përjetësisht ëndërr. Duket sikur te ai shesh i vogël nuk ka ndodhur asgjë kur në një kohë atje janë duke ndodhur të gjitha. Lumturia dhe mërzia e skajshme. Heshtja e urdhrave dhe dëgjimi i vetes. Në barakat prej druri ka një grup njerëzish të ndodhur këtu rastësisht prej një shkaku të pandërgjegjshëm të fillimit të një lufte. Te kjo barakë e vogël nuk kishte ndodhur asgjë e jashtëzakonshme, por relievi dhe njerëzit të venë në rresht qoftë edhe për shkak të një gabimi njerëzor, tani këtu ishin bashkë si në një lutje të madhe përballë së panjohurës dhe natyrës. Unë e kam në mendje barakën e vogël prej druri si një shenjë për të ruajtur kujtimin e një prej episodeve më të parëndësishëm të jetës

sime. Por i varur prej saj kaq shumë sa për tu ribërë tani pjesë e kujtesës sime duke dalë si Llazari prej varrit të saj të harresës. Kujtoj shirat e atij dimri që lagnin pareshtur tokën. Lodhjen tonë të shumëfishtë për të ngjitur një nga një kodrat e vogla për te hoteli i barakave ku gjindja njerëzore po shkonte vetëm për të fjetur. Për të shuar aty efektin e tmerreve të realitetit.

8.12.13

PREJ NJË MAJE TË THEPISUR

Shkruaj për të mos humbur sensin e të shprehurit. Një lloj torture që vjen prej këtij kapërcimi fatal. Sikur dora ime të heshtëte mbi letër unë do të humbisja qëllimin kryesor të një jete. Pra thënë thjesht: unë shkruaj për të mundur frikën. Të tjerë përdorin mënyra të tjera por edhe ata si unë njëlloj për të mundur frikën. Dështimi ynë është kaq afër dhe e trembin majat me të thepisurat e tyre. Dhe unë vazhdimisht shkruaj nën flakën e një qiriri që po shuhet në tryezën e Tolstoit. Jam i dënuar i galerës për të gërmuar nëpër të pashprehurat e gjuhës, aty ku shumë kërkues në atë luftë heroike me të pamundurën kanë vdekur. A do ta zbulojmë dot të vërtetën edhe më thellë ku ajo ndodhet?? Apo mos vallë trembemi sepse përpara nesh atë mund ta kenë zbuluar të tjerët? Për këtë dëshmojnë statujat. Unë s'kam për të thënë gjë tjetër. Dhe do jem i mallkuar po të bëhem përsëritës siç ngulmon një papagall në një degë peme për të përsëritur ç' thotë në një tingull të vetëm krejt pylli. Prej dëshirës për ta thënë të tërën njëherësh, ti nuk e kupton dot me ç'gjuhë atë e kanë shprehur më parë të tjerët. Ky zbulim te vetja shënon një pikë të madhe kthese. Një çast pas tronditjes së madhe ti je bërë pjesë e natyrshme e realitetit të gjërave. Të duket se sapo je zgjuar prej një ëndrre. Të kishin ndërtuar keq iluzionet. Dhe ti ndodhesh tani aty ku kërkohet harmonia dhe bindja dhe sapo ke nisur të mësohesh me ligjësitë dhe je bërë

dëgjues i rregullt i seancave të spiritizmit. Ti megjithatë mund tu tregosh atyre përvojat e tua të hidhura. Se çfarë ndodhte atje në majë ku përplasen më shpesh e më me furi erërat. Ti tani je kthyer në shembull, në një prej shembujve më të nevojshëm të moralit që përcakton rregullsinë e përditshmërive tona.

19.11.15

TRIPTIK

1.

Të shndërrosh një gjendje në favorin tënd kur thirrjeve të tua nuk iu përgjigjet askush. Dhe me çfarë ta mbushësh tërë këtë zbrazëtirë kur toka nën këmbë e qielli mbi krye nuk japin shenja të asnjë lloj ndryshimi. Duhet të kapërcesh çastin dhe të provosh për tu vendosur në një raport të ri me natyrën dhe sendet rreth e rrotull. Nga që nuk e zbulon dot menjëherë këtë mundësi, pothuaj e tërë jeta jote ka marrë kuptimin e kësaj përpjekjeje prej së cilës njëherë e një kohë njeriu zbuloi te vetja Sizifin. E pse duhet ngjitur deri në majë kur ndjehemi mirë këtu posht? Por njeriu nuk i urtëson dot egërsirat brenda vetes që përherë janë duke e kafshuar nëpër pjesë të ndryshme të trupit. Nga që nuk jetojmë dot përherë në një gjendje të vetme, si natyrë që ndërron paprerë stinët edhe kur ajo është e përmbytur prej shkretëtirës. Shkretëtira që zgjohet natën prej një pike vese për t'i kujtuar gjelbërimin e dikurshëm. Vetëm e vetëm sepse ne thjesht nuk mund të jemi vazdimisht ata që ishim. Jemi kjo makineri gjymtyrësh që u shpik prej idesë së lëvizjes me shpejtësi të pakontrolluara, për fluturime dhe arratisje prej moralit të luftës që shkatërron lumturitë tona. Vjen një ditë që edhe prej saj trupi e mendja jonë është e lodhur. Më në fund është fatkeqësi e madhe të jemi përherë ata që kemi qënë pa nxjerrur brirët mbi krye.

2.

Një pjesë e rëndësishme e jetës sonë janë përfytyrimet, fantazia dhe ëndrrat. Këta kuaj fluturues të dëshirave tona, mishi dhe gjaku ynë. Udhëtim fantastik përmes të cilit jemi ndjerë të lumtur kur lumturinë tonë e kemi nxjerrë prej këtij burgu mizor. Por prej përfytyrimeve- ky udhëtim i shkurtër dhe i beftë- gjithçka kthehet shpejt sepse asgjëkundi s'ka për të shtretër ajrorë për të fjetur. Gjejeni një çast në kohë për tu ulur në pëqi të saj dhe udha ka për t'iu shkuar mbarë sado për tepër larg të jini nisur. Për të shpërthyer poezia e njeriut. Nënshtrësia të thella që zbutin realitetin e egër dhe që na ndihmojnë për të njohur veten. Kur ndjeni një trokitje në thellësi , hapjani derën asaj dhe kini për tu ndjerë ndryshe. Zbërthehuni për tu çliruar prej prangave e përditshmërive për tu mbyllur përsëri në burgun e asaj skallavërie të lumtur. Zbuloni te vetja kohën e vlimit të dëshirave dhe kini për të parë se do jetoni përvoja të mrekullueshme. Nuk do të shkruani poezi por kini për tu ndjerë ajo vetë dhe do të shtangeni para të papriturave që para jush janë duke u ndodhur.

3.

Unë jam njeriu i të gjitha gjendjeve, përmes të cilave ai është i përcaktuar dhe i dorëzohet me dëshirë kthetrave gjakatare. Këtë slitë që dikush e tërheq për të nxjerrë një të mbytur prej pellgut të ëndrrave. Ky njeri i shumë përvojave ka bërë gjithçka për të gdhendur te porta e shtëpisë së vet një emër. E ka flakur veten në vahun më të thellë të lumit dhe e ka nxjerrë prej andej me një mijë sakrificë. Kemi qënë më të nxehtë dhe kemi vrapuar drejt detit duke hequr një nga një rrobet e trupit. Prej andej e nxorra përvojën e lashtë për t'i shpëtuar dhe dimrave të tjerë që edhe më të egër do të vinin. Kryq e tërthor është çarë trupi

im prej aksidenteve ku ka rënë e është ngritur. Shenja që flasin për një fushë beteje të humbur. Trupi im i ka përballur duke u pirë gjakun plagëve pas çdo goditjeje dhe gjersa jam gjallë vij pikërisht për të dëshmuar atë që e le pas si gjurmë, për t'iu lehtësuaredhe juve udhën. Si të thuash unë e kam përshkuar vet lindjen dhe vdekjen për tu bërë vetë verbi i kohës. Autopsia ime do tu tregojë se sa e lashtë dhe e lartë kishte qënë piramida mbi mua. Unë jam vet koha e cila pa dëshirën time kurrë s'kishte për të ekzistuar.

17 tetor 2013-29 nëntor 2013

DEMONI I FRIKËS

Si ta barazpeshoja aktin e madh me rrethanat e tij të mjera. Sipër një bunkeri për herë të parë i vetëm unë dhe bota një natë të tërë për të mundur frikën, frikën e madhe që për herë të parë më duhet ta nxirra prej vetes. Një operacion tepër i vështirë i kryer pa anestezi dhe pa ndihmës që të më vishte në duar dorashkat mbrojtëse. Një natë pa yje dhe hënë dhe larg çdo qendre të banuar. Frika – ky armik i madh i njeriut më në fund u shfaq si demoni më i zi dhe doli jashtë burgut të tij ku unë e kisha kyçur. Sa e sa herë atë natë u ndodha në prag të humbjes dhe po mendoja ta brektisja pozicionin tim luftarak dhe të futesha në bunker për të fjetur përkrah shokëve të mi të shërbimit. Por në çastin e fundit siç qe e mbërthyer ajo natë me plot çaste të tillë, kisha shtrënguar fort automatikun me gishtin në këmbëz gati për ta shkrepur. Ndërkohë që isha bërë tërë sy e veshë për ta depërtuar sa më thellë errësirën. Tani gjumi ishte arratisur krejt dhe kur për një çast mu duk se kisha fituar nisa të lëviz mbi bunker me një ndjenjë triumfi. Por nuk e di ç'ndodhi më vonë dhe frika u zgjua dhe nisi të më shfaqej në fillim në formën e një zhurme të largët-një fëshfërimë, një hije brenda hijes së madhe a kush e di dreqin çfarë tjetër mund të ishte. Më afrohej edhe më por për shkak të errësirës së madhe vetëm mund ta përfytyroja si diçka fantazmagorike. Tani niste lufta e vërtet ku instikti i vetmbrojtjes u vu vërtet në një provë ekzistenciale.

Automatiku në duar mu bë më i lehtë ndërsa gishtin e lëvizta për të tërhequr këmbëzën në shenjë dorëzimi. Nuk mund të bëje me askënd asnjë lloj kompromisi. S'kishe as kujt t'i kërkoje një pakt për t'i dorëzuar të gjallë veten në duar të një përbindshi të panjohur. Sepse në fakt nuk kishte asnjë lloj përbindshi të vetëm por vetëm një gjë e papërcaktuar. Ndërsa po besoja vërtet se ai ndodhej fare pranë meje mu duk se bëri dhe një manovër të fundit për të mu afruar nga anët. U ktheva me rrëmbim nga kjo anë dhe për çudi si në një çast mrekullie shqova një rreze drite të largët por edhe shumë të zbehtë. Ishte hëna e cila sapo ngjitej prej kodrave të larta të Ponçarës. Demoni papritur që zhdukur. Mora frymë thellë dhe ndenja një copë herë të mirë përballë hënës e cila dalëngadalë po më zbulonte krejt horizontin. E pash veten të rrethuar nga drita dhe nuk ndjeja më as ftohtë. Isha i përfshirë i tëri prej një mrekullie. Papritur mu bë gjithçka e dashur dhe e bukur. Rethanat nuk mu dukën më aq të zymta dhe vija re si depërtonte drita e hënës përmes degëve të mollëve në plantacionin e madh që shtrihej gjer poshtë kodrës. Mund të tregoja tani edhe një përrallë për demonin që ishte duke vrapuar si një Drakulë nëpër errësirë për të mos e kapur drita. Mu shfaq dhe Alevica, maja më e lartë e maleve përballë, pikërisht aty ku horizonti mbyllej për ta bërë edhe më miqësor kufirinshitetëror, si murin rrethues të shtëpisë sime të lindjes.

Gusht 2009

STALINI OSE ÇDO PUSHTET TJETËR

Më kujtohet se duke pritur tim kushëri në qendër të sheshit të Kombinatit Stalin, Stalinin kurrë nuk e kisha parë drejt për së drejti përveç hijes së tij nën të cilën në rrija në pritje. Mu kujtua tani ky emër i madh që atëherë ishte bërë ndajshim i mijëra tekstilistëve. Kaq lart sipër nesh qëndrojnë perandorët , aq sa neve na mjafton dhe hija e tyre për të fshehur një gjendje që përherë luan me të vërtetën. Atë çaste unë s'kisha asgjë me Stalinin-perandor por rasti e solli ta kujtoja atë në kohën e një pritjeje që përsëritej pa u ndalur si vet epokat të cilave njerëzit u përshtaten. Stalini ishte i tëri mbi mua ndërsa kapotën e tij ushtarake më dukej se po ia zhvishte krejt era. Se ka një peshë të rëndë e të padukshme që na përkufizon dhe na përcakton përdorimin e fuqive tona, të cilat do të jenë përherë të nënshtruara ndaj një diktati. Stalini i madh i pazhbërë ende nuk rrezatonte tek unë kurrëfarë intimiteti. Ishim kaq larg sa dhe afër duke qënë brenda një pushteti të cilit i mjaftonte lëvizja e gishtit në këmbëz për të na asgjësuar megjithsejt. Tani si për çudi, në pritje të kushëritim tim te porta e madhe, përhumbur në një turme njerëzish nuk kam të bëj fare me Stalinin. Ndodhem këtu krejt rastësisht si në një stacion që ka marrë emrin e asaj ç'prej këtu la një furtunë duke ikur. Jam i ulur pikërisht në piedestalin e monumentit të tij dhe nuk më ngacmon as ligji as ndërgjegjja. Kemi një lloj marrëdhënie por të pakushtëzuar. Pas

pak pasi u çmalla me tim kushëri mora autobuzin e linjës që mba njëloj emrin e Stalinit. Është po ky emër me të cilin përshkoj krejt qytezën e vogël gjer në periferi të saj. Dhe ndjem i çliruar prej peshës së monumentit. Po i kthej shpinën atij për t'i bërë sfidë një pushteti që tani s'ka asnjë të drejt mbi mua. E tulatur është ndërgjegja ime që fshihet e trembur mes zhurmave dhe thirrjeve që ngejnë peshë pushtetin e diktatorëve. A i që për mua s'kish qënë i tillë por edhe asgjë tjetër, tani i vrojtuar nga larg si pjesë e historisë, nuk ndodhet më aty dhe në një farë mënyre ai është bërë edhe mungesa ime.

27.2.14

2014

E vetmja ndjesi e veçantë e këtij Viti të Ri është numri 14 të cilën e vendos posht shënimeve të mia. Më duket një shifër e çuditshme gati si e papërcaktuar. Një vit të tërë do të shënoj atë kudo për të bindur veten se koha vërtet ka ecur. Ka vetëm pak ditë dhe kjo shifër ngatërrohet nëpër të shkuarën. Kthehen pas muajt dhe vitet aq sa bindem përherë e më tepër për natyrën konvencioanale të numrave. Është një lloj përpjekjeje për disiplinimin e kohës. Me këtë ndjesi shumë gjëra më bëhen të pashpjegueshme sa nis të përvijoj planet e mi. Ka nisur kështu një vit të cilit i duhet të vendoset sa më shpejt në kohë. E di se kam për të përjetuar ngjarje të çuditshme, me dëshirën që ka secili për të lënë një gjurmë të thellë dhe të pashlyeshme. Kalendari që i jepet secilit për të zënë vend në këtë start. Sapo ka nisur dita e katërt e vitit dhe unë me pak vonesë po organizoj kohën për të këtë pritje. Kemi hyrë në një pallat prej xhami ku s'mund të fshihemi prej askujt. Është dikush që na vrojton për të mbajtur shënim faktet e secilit të shkruaj historinë. Thjesht prej numrit 14, me një ritëm tjetër në hap unë po ushtroj ecjen që po bëhet pjesë e një marshimi të madh. Por harroj dhe i trokas përsëri numrit 13 dhe dëgjoj vetëm ec e jakun e gardianëve që arkivojnë vet kohën. Do të paguaj për ta vizituar edhe një herë të shkuarën time më të afërt. Nxito mos humbasësh kohën- duket sikur më qorton dikush pas meje. Shpërqëndrim i madh i

secilit që u lodh së tepërmi me përgatitjet e fundvitit. Mbyllja e bilanceve dhe ngjitja e këtij proces-verbali me përshtymë në kujtesat tona. Sa të bëhemi ushtri krejt e rregullt dhe të klasifikojmë llojet e vrasjeve me bomba njerëzore. Bilanci i vitit të shkuar ka qënë më i keqi i mundur. Fleta e fundit që më e përgjakura dhe unë s'po e pastroj dot ende gjakun prej duarve të mia. Janë po ato kanceleri që nuk e përpiluan dot në kohën e duhur Planin e Madh të Shpëtimit. Përmes shpërthimit të bombave njerëzore njerëzit do vallëzojnë nëpër këtë ritëm të përgjakur. 14-a duket se do t'i ngjajë shumë 13-ës që është e shkuara më e afërt e saj, sepse burgjet u hapën e prej kujtesave tona dolën në udhë krime të padënuar. Të vrarët mbetën pa varre. Qetësia në dukje që zotëroj te vetja kërcënohet prej zhurmës që bëjnë frerët e këputur të bishave në udhë. Po ua dorëzoj këtë proces-verbal si dëshmi të rëndë të një tragjedie që vazhdon të ndodhë. Ti që ke dalë shëtitje, në udhë qetësinë e ke të gënjeshtërt dhe zakoni i keq është ai i të shtypurit me këmbë të gjurmëve të tua të mëparshme. S'ka ndryshuar fare as stili për të treguar se koha do ketë një fytyrë tjetër. Ti që të duket se po ecën me po atë ritëm, në fakt je duke bërë një përpjekje për të nxjerrë prej vetes viktimat dhe vrasësit. Por kjo e ardhme nuk ishte e largët gjer te Viti i Ri 2014 i cili sapo ka mbërritur.

4.1.14

LUFTA E FTOHTË

Me ato çka përjetova ata 18 muaj në Bozhigrad unë mund të kisha shkruar fare lehtë një roman. Çaste pa numër të atyre muajve që mund të t'i jepnin jetës së çdo njeriu një rrjedhë krejt tjetër. Njeriu i thirrur nën armë dhe i veshur nga koka te këmbët me hekur. Por meqënëse këtë vepër të lavdishme e kish shkruar para shumë vitesh Dino Buzati nuk di në se ka mbetur gjë tjetër pa shkruar. Heroi i Buzatit është komandanti i kështjellës kurse unë isha ushtari i thjeshtë i një kompanie këmbësorësh artimitraliere. E kisha përshkuar si një re e bardhë pa shi atë natë vere, kur gjënimet e Luftës së Ftohtë shurdhonin krejt botën e cila zbrapset prej saj sa herë vinte gishtin në këmbëz. Një ushtar i gjysmës së dytë të shekullit XX në kulmin e Luftës së Ftohtë, në kohën që bitëllsat po çmendnin tërë botën me muzikën e tyre, si për të nxjerrë të tërë të çmendurit me përdhunë nga rreshti. Ajo luftë për të cilën ishim nisur urgjentisht një mbrëmje qershori të viti 1967 nuk u bë kurrë. Kjo ka qënë përherë ajo që më ka tmerruar por që edhe më trembte sa herë isha ulur të shkruaja romanin tim. Një roman të tillë me luftën në pritje Buzati na i kish servitur si koncept filozofiko-letrar të një pritjeje gjer në absurd, sepse ishin balancat që na ruajnë prej së keqes edhe pse atë një jetë të tërë e kemi përfytyruar. Përvoja ime ushtarake përbëhej prej ca vogëlsirave që shkrimtarit të madh italian i kishin shpëtuar. Ja pse tani më duket se jam

duke plotësuar romanin e famshëm me përvoja të reja. Tani që dëgjoj urdhrin e ndërgjegjes sime po tregoj për mitralozin e famshëm Zharellos , austriak, armë shfarosëse e Luftës së Parë Botërore. Nuk di si mbërriti gjer në supet e mi por ishte një diçka e rëndë dhe pa kurrëfarë intimiteti. Sepse nuk i vrau armiqtë e mi dhe ne mbetëm gjallë si dëshmi se jehonat e paqes u lodhën duke pritur luftën. Bëhu njësh me ëndrrën që pëlçet bomba mbi të cilat ti po fle duke bërë roje në breg të lumit Devoll në një natë të akullt dimri. Donatorët ishin pak më larg dhe më bëhej se ata në të vërtetë i ruante frika ime. Ti ishe duke ushtruar këtë mjeshtëri për të shkuar nesër në luftra të fronteve edhe më të vështirë, për të përfituar pas vdekjes një pension prej Al Kaedës. Ti në Bozhigrad ke qënë një lloj luftëtari që vjen prej betejave të humbura, të cilat kurrë nuk u zhvilluan dhe për fat kujtesa po të sjellë ato mizëri çastesh, kur retë përplaseshin vazhdimisht dhe prej qiejve kullonte gjaku. Luftën që edhe pse nuk u zhvillua ti e mbart ende në një çantë të rëndë ushtari pajisur me të gjitha mjetet; lopata, kundërgaz, helmetë, një matrikull të vogël për të identifikuar eshtrat e tua mes mijëra e mijëra të vrarëve. Ti kishe qënë pjesëmarrës në një luftë për të vrarë frikën, ky epilog i trishtuar që romanit të Buzatit përherë ka për t'i munguar.

23.4.14

Tani po dëgjoj këtë zë magjik shpendi që është duke më zhvendosur nëpër botëra të tjera. Muzika e pyllit më kishte ftuar të harroja zhurmën e madhe që në veshët e mi po hapte guva të thella. Nuk mund të them se unë e kisha ftuar muzikën apo ajo kishte çarë nëpër koridoret e gjetheve e degëve të mijëra pemëve gjer te veshi im për të mbërritur. Pylli me mua nuk ishte fare dashamirës dhe u shfaq ky zë i hollë bilbili për të

përqëndruar vëmendjen time. Herë tjetër muzikën e kisha kërkuar për shkak të shumë mungesave si një strehë që as vetë nuk e përfytyroja dot se çfarë mund të ishte. Hapat e mi të hedhur befas nën këmbë më kishin dhuruar një tingull i cili kishte zgjuar mijëra të tjerë dhe unë u ndjeva i përfshirë prej një dehjeje të ëmbël. Me një lloj grepi kish kapur fluturën më të largët të pyllit. Më vonë muzika ve të marsit nën një hënë që ndriçonte krejt rrjedhën e lumit Kalasë dhe shpërndahej nëpër fushë si dritë e shpirtrave njerëzorë unë mendoja se ne ndodheshim këtu si harresë e një çasti fantazmagorik që la të plagosur prenë e vet për tu shëruar nën dritën e hënës. Unë që po divorcoheshmëve kish ardhur tek unë me gjithçka mua më parë më kish munguar. Tani po e përdorja natyrën si lojë për tu argëtuar. Ndjehej si motori i saj që po ndizte në vrap energjitë e mia të fjetura. Përvojë e çuditshme. Uturima e pyjeve përmes fëshfërimave të gjetheve sillte ulërma të largëta ujqërish që ngadalë po shuheshin. Ende uturimat e zhurmës sillnin frikë brenda marshit të muzikës që ishte duke u lindur. Tani vërtet po e ndjeja se muzika kish mbërritur për të më pushtuar të tërin dhe unë po i bëja ftesa të tjera natyrës për të hyrë në shpirtin tim për të më lartësuar.

2.2.14

NJË FILM I PASHFAQUR ENDE

Marrëdhënie që u ndërpre shumë herët për shkak të vdekjes së parakohshme të tim atë. Siç e kam shkruar edhe më parë isha duke kërkuar një oaz për t'i shpëtuar shkretëtirës që pas po më ndiqte. Për të shuar ata zjarre që digjinin e ndriçonin nga brenda skutat e errta të kujtesës sime. Kjo është një përpjekje për të mos e shpallur aq shpejt betejën të humbur. Kujton qoftë edhe një prej këshillave të tij dhe ndjen se dikush si ëngjëll pas është duke të ndjekur. Im atë- ky shenjt i kohëve të pakthyeshme që ndërton përvojën përmes një pune plot sakrificë dhe një shpërblimi pa as kurrëfarë lavdie. Po të flas për atë udhë të shkurtër që përshkova me tim atë aty gjë burimin e gjithçkës që ndodhi e më vonë do të ndodhte. Po flas për raportet e njeriut me të shkuarën dhe të ardhmen. Ajo që nuk e ndërtojme dot më përveçse tua çojmë si përvoja jetëve tona të ardhme. Kur lëronim tokën netve të marsit nën një hënë që ndriçonte krejt rrjedhën e lumit Kalasë dhe shpërndahej nëpër fushë si dritë shpirtrash njerëzore, unë mendoja se ne të dy këtu ishim thjesht pjellë e një fantazie. Unë po divorcohesha me fëmijërinë time, ai po njgiste atë mal të egër si Sizifi. Po marrëdhënia jonë ishte diçka që ngjizej shpejt për shkak të shumë rrethanave, që ndërthureshin prej një rrënje të përbashkët. Unë hidhja farë, ti e mbështillje atë me ngrohtësinë tënde. Ishim bashkë në një udhë e cila për tim atë do të përfundonte së shpejti kurse për

mua... unë as që e kisha idenë se çfarë surpriza më kish ruajtur e ardhmja. Dua të shpjegoj një marrëdhënie cila në fakt është përjetim plot pezmi dhe e pakthyeshme, nëse nuk pranon një sakrificë të pamundur për të shkuar gjer atje për të ngritur skenën. Duke rimbjellur pemët e prera, duke rihapur kanalet për të dëgjuar natën këngën e ca qënieve të mistershme, që pothuaj është e pamundur të përfytyrohen. Një ekip filmik prej Hollivudit i armatosur mirë me teknikat më moderne, për të përcjellur këtë përjetësi që gatuhet prej përditshmërive, ku ka më shumë lojë shpirtrash të dënuara për tu shfaqur . Nëpër ekrane ku shihen e ndjehen lëvizje të nëndheshme nën themelet e përdnë natyrë ku përcillen vetëm jehonat e lëngatës njerëzore. Atje në fushën bri një lumi ku unë përjetova çastin e tërë magjive isha si i dërguari i një zoti për të sjellëprej andej frymën e njeriut e për t'ia dhënë tokës së vet në një mënyrë gati të mistershme.

10.3.14

NË PARK NJË PASDITE PRANVERE

Në park ka një problem i cili bëhet edhe më i papërballueshëm: gjetja e kohës së humbur. Më mirë se këtu, vend ideal kur ke lënë pas vetes shumë paqartësi. Kërkimi i qetësisë në fakt mund të konsiderohet një vetëmashtrim pasi kërkimi kthehet në një superpunë më tepër psikike, ndërkohë që njeriu punën fizike e ka braktisur përkohësisht. Në park ka shumë flutura dhe pemë që fëshfërijnë prej një filladi të lehtë të një pasditeje pranvere. Shoh njerëz që e përshkojnë parkun nga kreu në fund. Tani zemra e tyre nuk është më në qetësi, trup i zhveshur prej detyrimit fizik për të gjetur kohën me këmbë dhe mendja që është duke bërë llogari të tjera. Hetohet në pafundësi sepse vetëm atje koha e humbur mund të jetë fshehur, e rrëmbyera kohë ose e vrara padrejtësisht. Koha e humbur është atje ku ne synojmë për ta gjetur por ata që e kanë humbur kanë një detyrë pothuaj të pamundur. Vetëm shëtitja në park është mundësia e vetme ku gjendet e fshehur një e shkuar, e cila nuk e lejon më të tashmen të përparojë pa i kthyer më parë borxhin. Këtu në park kryhen shumë eksperimente me formula të tipit Kohë + Hapësirë = X. Sepse mungon një e dhënë më e rëndësishme. Vet koha duhet të ishte X ndërsa formula e shtruar na e jep atë si të dhënë të nënkuptuar. Mos vallë koha në njerin krah të ekuacionit është provokuesja ose vet faktori e cila ikën duke i lënë njeriut në kujtesë enigmën të pazgjidhur. Po të nisem nga vetja unë

kam shumë kohë të humbur dhe fare pak kam mundur të zbuloj nëpër nënshtresat e mia. Sepse koha e humbur pas kësaj bëhet edhe më e pafundme. Duhet gërmuar akoma më thellë. Këtë bëjnë dhe njerëzit në park përgjatë kësaj dite pushimi. Të gjithë i janë sulur të shkuarës së tyre. Thërmija të vjetra mbetur nëpër dhëmbë e të bërë një me mishin, plagë të tjera edhe më të vjetra që kërkojnë me ngulm shpëtim ku që më parë njeriu i duhet të shkojë te burimi. Por pylli është bërë mjaft i dendur. Ne nuk po gjejmë dot identitetin e atij njeriu të vizatuar krejt amatorisht tek një shkëmb që të zbulojmë përmes tij autorin e këtij vizatimi. Borxh i mbetur prej mijëra vjetësh. Koha është thinjur dhe këmbët kanë zvogëluar ritmin e ecjes. Janë kapërcyer epoka të tëra me këmbë fare pa i shkelur. Tani si dënim njerëzit në park i mëshoinë më tepër hapit sepse nuk iu lejohen më gabimet në përlllogaritje. O sot o kurrë ata duhet të dalin prej parkut me këtë kohë të gjetur për dore, kush e di se ku nëpër hyrje të ndonjë shpelle. Shoh si e rrethojnë një copë vend duke e vizatuar me një shkop për të ngulur atje sondën për një shpim të ri edhe më të thellë. Iu bëhet sikur dëgjojnë një klithmë prej nëndheut. Prej asaj foshnje që është duke u shfaqur së pari u panë ca duar të vogla dhe të holla që po zgjaten prej rrënojave. Është gjallë, gjallë-do të bërtiste i pari që zbuloi më në fund kujtesën. Ajo paskish qënë koha e humbur-ky fëmijë i parritur që kish pritur me shekuj të tërë i habitur me indiferencën njerëzore që prej mijëra vjetësh, s'kishte investuar asgjë për të zbuluar të shkuarën. Hija e së sotmes mbi të ishte shumë e madhe dhe e errët. Sidoqoftë ky fëmijë i nxjerrë nga rrënojat tani pas dy mijë e ca vjetësh po bëhet bashkëkohës. Ka pamjen tonë dhe erdhi te ne në një ditë paqeje. Nuk ishte dhuratë por kthim i të humburve në tokën e premtuar.

20.4.10

TOPI FLUTURUES

Ti po ikën më me vrap para nesh dhe ne s'mundemi të të tëkapim. Të vrapojmë, kjo është ajo që veç kishim ëndërruar. Më shpejt se këmbët fluturon ky top duke ikur nga ne dhe i kapur prej erës. Mos vallë është fryma ime atje tej gjer te fluturimi i topit duke vdekur? A e kap më dot trupi i balerinës fluturimin e gjymtyrëve të saj? Vetëm në qoftë fantazia ose një lloj tjetër imagjinate që na i ka prerë duart dhe na ka mpakur vrapin. Një top i fluturuar prej këmbëve tona është një dëshirë që na pret aty larg dhe ne jemi duke dëgjuar thirrje që na ngrajnë peshë trupin dhe shpirtin. Unë e ve re topin tek fluturon në ajër ose rrëshqet me shpejtësi në tokë, ndoshta duke përshkuar një figurë që nis të përthyer më në fund në imagjinatën time. Kjo flurudhë që nuk është as këndore as rrethore, as drejtëz-asgjë prej asaj që u përcaktua dikur si një marrëveshje për të matur largësitë tona, por që nuk arriti të përfshijë në të ëndrrat. Për më tepër ky top i rrombullakët kthehet vet në një subjekt që prodhon një shpejtësi tjetër. Ai fluturon ose vrapon si i çmendur vetëm e vetëm që unë gjuajtësi të mos kem mundësi për ta kapur. E ndjej se energjia e çliruar prej meje tani nuk është më e imja. Ajo është duke tërhequr pas vetes me mijëra shikime, kamera, roje të lojës që vrapojnë për t'iu ndodhur sa më pranë topit. Një garë e çmendur do të thoshja ndërsa unë më i huaji i asaj që një pjesë të vetes i kishte falur. Duke qënë tani rob i këtij

përfytyrimi shoh zotin që na gjuan me rrufe sepse jeta duhet t'i ngjajë përherë një spektakli. Ja pse jemi të tërë në lëvizje duke u rrotulluar prej një ingranazhi që nuk mund të punojë kurrë në boshllëk. Të flakur në këtë surdinë ne nuk e dimë se ku do të ndalemi. Një zot që ka fytyrën e një menaxheri, që rregullon jetët tona . Le të mos e shohim veten atë çast si jemi duke lozur dhe përshkuar kohën. Topi tani diku ka pushuar në rrjetë ose në këmbë të një tjetri. Dhe fusha dhe stadiumi përreth mbushet me thirrje, botë të shpëtua dhe të vdekura. Vetëm unë prej një distace të papërcaktuar nuk arrij dot të shoh veten. Topin nuk arrij më dot ta tërheq pas vetes dhe as që ia ndryshoj dot më drejtimin. Por heshtja e madhe e stadiumit më thotë se topi tani është duke u prehur në rrjetën time

25.4.10

E ARDHMJA E FSHEHUR

Ajo që dua të them është kaq shumë e papërcaktuar dhe e pleksur mes shumë rrethanave që përherë do ta lenë të ardhmen në mjegull. Shtegu në pyll që je duke hapur me bërryla dhe ajo mundësi e vogël që të jepë në këtë hapje drita. Ti nuk e di çka më tej por vetëm te kjo përpjekje udha është duke u shtruar. Por a s'është ajo ndonjëfarë ideje dhe çfarë në të vërtetë e përcakton udhën? Je lodhur shumë dhe deti po ngre përherë e më tepër dallgë duke ta bërë më të vështirë mbërritjen te bregu. Ti nuk je duke kërkuar asgjë më tepër nga vetja përveçse atë që tani e ke edhe më të nevojshme. Deti dhe pylli përherë mbeten të egër dhe ti po lufton pa e ditur se je duke ndjellur vetë qytetërimin. Po çfarë lloj qytetërimi do të jetë, tani për tani ti nuk ke asnjëfarë ideje. Edhe kur perspektiva është mjaft e ndriçuar prej dritave të reklamave të saj, ti plotësisht asnjëherë s'ke për ta ditur. Sepse ka një mijë e një pengesa të tjera të cilat e veshin me mister njera-tjetrën. Dhe kjo përpjekje ndoshta është kuptimi i vërtetë i udhës. Nëpër shkurre e ferra të kësaj xhungle ku ti do të ngresh shtëpinë tënde të ardhme. Dhe s'ka qënë kurrë më e vështirë se sot hapja e udhës ku duken edhe më qart gabimet e së shkuarës. Sepse ti ke zbuluar aty edhe rreziqet e së ardhmes. Nëpër këto autostrada ku si kafshë të egra të një pylli përplasin brirët me njera-tjetrën miliona makina. A mundesh dot ti t'i parandalosh dot tërë vrasjet e udhës? A mund

të ngresh dot kaq shumë spitale në udhë për të rikuperuar të aksidentuarit e udhëve? Xhunga bëhet e pashmangshme dhe do të përshkohet gjithnjë përmes rreziqeve që lindin njeri-tjetrit.

11.12.14

SHPIRT I BRAKTISUR

Pyetja që shtrohet është: a mund të jesh një poet i dobishëm për popullin. Nëse shpirti reflekton diçka prej kësaj ajo është e vështirë të zbulohet, sepse shpirti ndodhet shumë thellë. Ai i ka endur pamjet që na shfaqen sipër. Në trishtimin e tij ndoshta ka më shumë botë se te flamurët. Dhe tani që po shkruaj këto fjalë ju mund të konstatooni lehtë nëse gjer lart është ngjitur një rrëkezë prej lumit të nëndheshëm. Nuk ka as thirrje për festë. Por ndërsa flasim për poezinë nuk jemi të sigurt sa ajë është e dobishme për njeriun. Gjendemi të tërhequr në zgrip dhe kemi zgjedhur një kënd tjetër për të vështruar botën. Prej andej ku nuk e shohin dot të tjerët. Ne u japim atyre këtë tejkyrëse por ka rrezik që prej asaj ata të verbohen. Na janë djegur letrat në duar. Edhe pse e kemi hallin te njeriu shpesh nuk dimë atij si t'i afrohem. Sepse nuk jemi të vetmit ose më thjesht të tërë janë turrur ndaj njeri-tjetrit. Ka më pak hapësirë ndoshta, por ajo bëhet e paarritshme prej të tjerëve. Ne jemi aty dhe na duhet të tërheqim vëmendjen. Armët e vjetra tani janë pa efekt. Duhet shigjetëza të holla e të padukshme që kur ngulen në trup shkaktajnë shumë dhimbje, thjesht sepse kanë prekur një plagë në thellësi, prej së cilës ndoshta vijnë tërë prishjet e ekuilibrave njerëzore. Pra ne ndodhemi këtu dhe jo diku tjetër, drejtim i cili në çdo rast do ishte i gabuar. Prej këtu kemi mundësi të shohim vorbullat njerëzore dhe atë çfarë ndodh brenda tyre. Aty ku

mungojnë pasqyrat ne do na duhet të zhytemi edhe më thellë për të sjellë pasqyrime prej këtyre thellësive. S'kemi të bëjmë me sipërfaqet të cilat përgjithësisht montohen kur çahen nga tërmetet ose cunamët. Sepse tani gjendemi edhe më thellë-palombarë pa veshje shpëtimi. Dhe nuk dihet nëse do të ngjitemi prapë sipër përveçse të dërgojmë mesazhet që janë më të vlefshëm se vet paraqitja jonë publike. Nuk jemi ne fajtorë se fajtorë nuk ka asgjekundi. Është vet vorbulla që ngjit sipër të përbrendshmet pikërisht në çastin që ne atë e kemi vënë në dukje, dmth kemi zbuluar vet ekzistencën e saj. Ajo është aty edhe kur ne s'jemi. Ajo flet edhe kur ne kemi heshtur. Ja pse si të nevojshëm poetët shfaqen të fundit pasi Troja krejt të jetë djegur. Janë bërë analiza të shumta dhe njëlloj bota mbetet varur në një fill që përherë do të jetë gati për tu këputur. Poezia duhet të thotë dhe ajo një fjalë të fundit sidomos kur nevoja për inteligjencie është në zgrip, kur pendesa shoqërore nuk ka më në dorë asnjë lloj arme për të asgjësuar veten. Vetëm atëherë thirret poezia e cila përherë ka qënë duke folur por askush nuk është kujtuar t'i marrë seriozisht marrëzitë e saj. Bashkë me këto fjalë u tha më në fund gjithçka, u zbulua vet thelbi i cili është përherë i përdhunuar prej veshjeve të shumta, që të kemi dukjen e tij, e cila në shumë raste është dora që ka kryer vet krimin.

20.6.10

ÇFARË DOJA TË ISHA

Sigurisht që unë do të doja të isha në radhë të parë një poet nëse kjo do të ishte e mundur, falë përpjekjeve të mia që kanë patur një shtysë gati ekzistenciale. Për t'iu ardhur në ndihmë doja tu sillja juve timbrin e zërit tim që e përvijon singëriteti, për të qënë vetja në çastin që do të shfaqet. Vetëm atij mund t'i besoni, zërit që shpërndan në ajër një tingull si trokitje që zbulon se cila derë prej tij do të hapet. Një Don Zhuan kështu ka trokitur në një mijë zemra dhe u besua se këtë lloj njeriu të gjithë e kishim fshehur brenda vetes. Tani qëpo nis të shkruaj ja m duke hapur tërë letrat e mia. Do të desha së pari të isha ai njeriu që u bë rob i një pasioni të çmendur dhe nuk u tremb prej tij, as kur atë e ekzaminuan për ta shoqëruar më pas në Shtëpinë e të Çmendurve. Sepse bota as që mund të jetë ndryshe nga ajo që është e begatë për shkak të kësaj shumëformshmërie. E ulët dhe e lartë, pedestal dhe statujë guri dhe baltë, fllad pranveror dhe ajër i prishur. Unë doja pikërisht të isha diçka që në të vërtetë isha, qoftë edhe ky zog që mbi këtë gjethë këtë çast është ulur. Sepse asgjë më shumë edhe s'mund të jemi për shkak të ofertave të shumta që u bëhen kërkesave të papërfillura. Nuk zgjidhet asgjë përmes vetvrasjeve kamikaze, sepse turma prapë nuk do të shpërbëhet. Ah sikur të isha me të vërtetë ai që kam dashur të isha, për të zënë vendin më të ulët në Senat e që më në fund do të kërkonte për mëshirë votën time.

15.11.09

BOSHI

Atë që e kisha duhet ta prekja. Prej kësaj zbrazëtie pafund diçka duhet të krijoja. Më jep fuqi së brendshmi për kërkim. I mungon dhe busulla njeriut që ka mbetur në mes të kohëve. E rrotullon atë por duket se dhe Veriu i saj ka humbur. Por pa këtë zbrazëti s'do të kishim asnjë lloj ngasje për të ecur më tutje. Plotëria e madhe besoj se është shkaku i boshësisë- shpejtësia me të cilën ne e konsumojmë një gjë të munguar prej kohësh. Ah sikur të kisha mundësi të vëzhgoja nga brenda ç'ngjyrë kish ai qiell pa yje dhe pa asnjë lloj shenje tjetër. Më parë ndoshta duhej të përfytyroja Ferrin por bota ku jetoj tani është krejt ekzistenciale. Unë vazhdoj të marrë frymë edhe pse shpirtërisht mund të jem i vdekur. Lëviz duar e këmbë por ato presin një urdhër. E kuptoj nervozitetin e gjymtyrëve të mia por jam i pafuqishëm për të organizuar energjitë e tyre drejt një qëllimi. Është e hënë gjer në mesnatë dhe do më duhet të shfletoj në kalendar të martën. Kjo mund të jetë thjesht një urdhër formal për të nisur të matim kohën së prapthi. E përfytyroj zbrazëtinë por nuk jam i bindur nëse ajo është e kapshme në konkretësinë e saj. Zona të rafshta pa diell, shkretëtira të pafundme. Po ndërsa po shkruaj kuptoj se ndërkohë jam vënë në kërkim e po bëj një luftë të tmerrshme, vras miliona e miliona qeliza për të shpëtuar te ky

pyll i dendur qoftë edhe një pemë të vetme. Tërheqja ime nga lufta është baraz me mosekzistencën. Një zbrazëti është si një oqean pa brigje gjë që e bënë pa kuptim dhe idenë e ndërtimit të një anijeje. Ndoshta prej këtej u nis Ajnshtajni e drejt universit. Prej mungesës së madhe ai ndërtoi një makinë tepër të komplikuar dhe mjaft inteligjente. Një shkretëtirë e madhe na ve në kërkim qoftë edhe të një rrëzeze të vogël uji. Lufta me Boshin fillon duke ia thyer guaskën e madhe që e ka ngujuar atë brenda vetes. Do na duhet të shqyejmë një nga brinjët tona. Ëndrrat nuk janë më aty dhe ne s'kemi me kë të këshillohemi. Unë e përjetoj boshin si një lloj vdekjeje. Dhe ndoshta kjo frikë të jep fuqi për të bërë dhe përpjekjen e fundit. Më në fund guaska u thye dhe boshi brenda nesh nisi të ushqehet. Duart dhe këmbët fillojnë të më binden, një zog fluturon sipër meje për të më treguar shenja që nisin të shfaqen. Tani jam krejt në shërbim të ekzistencës, marrë fuqinë e saj dhe nis të ndërtoj një shtëpi të bukur. Ka nisur vallzimi i këmbëve dhe duart në vegjë po endin fantazitë e mia. Po ndjehem i lumtur por një bosh tjetër e di që tani po ushqehet prej meje. Unë bëj gjithçka për të që dhe ai të ushqehet me lumturinë time.

3.5.10

FRYMA

Ajo që lëshojmë tani me frymën ndoshta është e tëra gjithçka që thamë ose tani duam të themi, ose që e ëndërruam atë siç do të ishte. Fryma është gjithçka dhe fjalë dhe është ku të tërë si nën këtë kurorë peme jemi ulur. Atë që këtë çast po e frymëmarrim ndoshta e përcjellim njëherësh si dashuri dhe urrejtje. Dhe asaj po i trembem, asaj që po më ze fytyrën pastaj si këngë më fërshëllen dhe trupi im në vrap është duke ecur. Ja pse kjo qënka e gjitha enigma dhe misteri që kaq shumë na ka lodhur për ta zbuluar, ndërsa po kërkon të një udhë, nëpër tërë qënien tonë ku lumi mund të kishte ngecur. Ajo që nis të një majë e vogël thoi dhe e ndjenë fija e flokut- ushtri e pafundme qelizash që ndërthuren në mënyrë kaq të mistershme. Ja si po zgjohen duke marrë frymë thellë për të qënë prapë në jetë pas vdekjes dhe nëpër ëndrra kaq shumë herë i trembur. Ajo që vjen e tëra njëherësh duke shpallur nisjen e një beteje: të vrasësve dhe viktimave. Fryma që bëhet fjalë përgjatë rrugës dhe shpik gramatikën e saj e cila përherë do na shfaqet si shpëtimtare.

16.11.09

MË TEPËR LARG SE AFËR

Sipas tërë llogarive fundi nuk del më shumë larg se afër. Dëgjohen dhe zhurmat e tyre dhe porta e tendosur për të pritur trokitjet. Edhe pse i shumëzohet me diçka tjetër ato plot kryeneçësi e nxjerrin në ekran shumë më me një diferencë aproksimative që s'le më dyshime të tjera. Një sistem i tërë që përpunon të dhënat që në çdo rënie të lapsit bëjnë kryengritje dhe japin alarmin se unë ndodhem shumë afër tyre. Është shumë e vështirë për të qënë afër tani kur je kaq tepër larg dëshirës. Sistemi është duke u perfeksionuar vazhdimisht sepse dhe dyshimi e ve këtë makinë në lëvizje me gjithëfarësoj duke mos u bindur për rezultatin që në pasqyrë është duke u shfaqur. Është tepër i madh dhe prej tabelës po filloj zbritjen për të përfutur një shumë sa unë të harroj të ardhmen dhe kjo e sotme të jetë duke më ngazëllyer ende.

18.11.19

Ç'LE PAS NJË ËNDËRR DUKE IKUR

Salla e madhe e mbushur me njerëz por asnjë fytyrë nuk pash. Vërtet isha duke parë një ëndërr por kjo s'më pengon të zbuloj se në të vërtet çfarë kishte dashur të më thoshte ëndërra. Vetëm ideja ngulmonte se ata që shihja duhet të ishin njerëz. Këtë ndjesi ma përforcoi pamja bosh e dy-tri radhëve të fundit. Boshi dukej më qart se plotësia sepse atë nuk e kërcënonte askush. Dukej se njerëzit në sallë më kishin interesuar thjesht si nocion, një lloj ekzistence që plotësohej pa u konkretizuar nëpër fytyra. Vetëm një shumësi individësh të paidentifikuar. Çifti, komshinjtë e shtëpisë sime të lindjes po më tregonin pamjen e sallës si për të më thënë: Bëmë aq sa mundëm. Ishte kjo një darkë të cilën ata e kishin organizuar edhe pse te ajo sallë ku njerëzit si ekzistencë ishin ndarë prej idesë së tyre, aq më tepër që një darke të tillë i mungonte krejtësisht atmosfera. Ndoqëm së bashku të tre një vijë uji për të gjetur burimin me qëllim që të ndërprisnim rrjedhat. Pas pak do të niste darka ndërsa mua do më duhej të largohesha në një drejtim tjetër. Vetëm sa u thashë: Tu rrojnë fëmijët dhe ia kalofshi mirë, dhe u ndava prej tyre. Por as udha ime nuk ishte më e qartë se atmosfera e asaj darke që do të niste pas pak, në sallën e ftohtë me njerëz që ishin atje dhe që s'ishin. Udha ime një tjetër lloj detyrimi për të zbuluar më larg shkaqet që nuk do t'i gjeja dot nëse ata në të vërtet ekzistonin. Njeriu që drejtonte motorin me të cilin ne po

udhëtonim ndjente një lloj bezdie, e cila po më mbushte me një zbrazëti tjetër më të frikshme se ajo e darkës që kisha lënë pas. Ku po më çonte vallë kundër dëshirës sime po aq sa dhe kundër dëshirës sëvet? Këtë nuk do ta mësoja dot kurrë sepse pak më tej udha që ndërprerë dhe unë në një zgjim të beftë njëkohësisht po dilja edhe prej ëndrrës. Mënyra si e vështroj unë ngjarjen në ëndërr më krijon mundësinë për të gjetur një lloj çelësi për shpjegimin e saj. Dalja prej një gjendjeje e cila po i dorëzohet një tjetre force pa dëshirë-ndoshta ky ka qënë presioni që ka shpërthyer prej trurit për të më çliruar prej një makthi që kish kohë që ziente brenda meje. Zakonisht të dielën në mbrëmje kur pret të vijë e hëna njeriui përjeton ndryshimin, cilësinë e re e cila po përgatit terrenin e saj për të zbutur të paprtiurat e së nesërmes.

Tetor 2008

KTHIM I DETYRUAR

Jo ajo që duket në lexim dhe që tregon vetëm rrugën ku ajo është duke ecur. Por si të kthehesh për të tradhtuar atë që të ka marrë me vete. Misteri është shpresa që pas malesh të tjerë rri fshehur. Unë lexoj por në të vërtetë zhytem dhe ngre sistemin tim për të pushtuar atë që ende nuk duket. I ruhem dhe ndonjë kurthi por tani eci bashkë me përvojën që është duke u krijuar rrugës. Çdo libër përcakton dhe llojin e lexuesit por është shumë e vështirë të zbulosh se sa e gjatë do të jetë kjo histori miqësie. Asnjë libër nuk hapet me qëllim për të gjetur në të të sotmen. Dhe besoj as për të ardhmen. Një libër lexohet për tu kthyer në të shkuarën sepse dhe librat e Zhyl Vernit që parashikojnë përmes zbulimeve fantastike të ardhmen tashmë janë bërë gjë e kryer. Më parë në mendjen e shkrimtarit pastaj në atë besim e siguri që të jep fantazia. Tendenca për kthim në një libër mund të jetë thjesht kërkimi i një iluzioni të humbur dhe në shoqërinë e të kthyerve krijohet një lloj migrimi brenda njeriut. Një diçka që pritet të ndodhë si e shkuar vjen për të ngacmuar të sotmen e cila duket përherë sikur ka ardhur herët. Me këtë rast mua s'do më interesonte thjesht një ngjarje apo qoftë edhe një shkrimtar i veçantë, por për më tepër ajo që ka përcaktuar letërsinë si të tillë. Rikthimi i së shkuarës sonë prej frikës se mos ajo ka mbetur e pavarrosur . Dritë e së shkuarës ndriçon këndet tona më të thella dhe për më tepër se e ardhmja kjo e shkuar shndërrohet

në obsesion të njeriut. Një qiri i ndezur në fakt është lutje për të sjellur kujtesën e cila si produkt përbëhet e tëra prej së shkuarës. Ja pse udhëtimi i një lexuesi në një libër është kthimi i detyruar të cilit, i kanë paraprirë bisedat e zakonshme mes njerëzve ose thashë e themet që në mungesë të saj tani po shpikin një çfarëdo të shkuare.

5.10.09

HESHTJA

Më e lavdërueshmja gjë është heshtja. Një koncentrat gati i pazbërthyeshëm. Po si vallë të zbulosh në vrullet e tij të dikurshëm dhe borxhin që ai duhet të paguaj tani përmes heshtjes? O zot me ç'lloj përkryrje janë tretur në të gjitha. Mbreti s'ka thënë më fjalë dhe armët përtej kufijve të mbretërisë së tij janë ulur. Ti njeri i tokës dhe i qiellit, i dënuar me lumturi dhe vdekje ndale makutërinë tënde te kjo barazpeshë e veshur me mister, me zërin e zhytur në aluvionet e veta, që pret të dalë përsipër pasi vorbullat të ketë heshtur. E ç'rëndësi kanë të tëra këto kur thelbi në të djallëzisht rri i fshehur. Por heshtja që më vështron me ata sy të thellë mund të jetë dinake njëlloj, por tepër e dashur, njëherësh dhimbja jote dhe imja, tretja në të e tërë lëngjeve të njeriut prej të cilëve përbëhemi. Dhe ç'ta kujtoj tërë këtë njerëzim që si një përrallë e bukur kaloi. Kohët me dritën e syve tanë nesër të tjerët do t'i shohin. Ti që je tretur brenda meje dhe unë që tani te një tjetër jam duke u tretur. Ia dhash të parit në rrugë vrullet e mia dhe i rash kambanës që të tjerët të dëgjonin në të heshtjen. Një lëng me një ngjyrë tjetër të papërcaktueshme, ku me aq mundim ulërimat u tretën të fundit dhe mëria e Akil Këmbëshpejtit dhe pothuaj, njeriu/njerëzimi / në këtë epruvetë i zhytur brenda i tëri për tu tretur. Ju dëgjoni një muzikë në heshtje, tonet e ulët të së cilës po e shuajnë si gëlqere tërë forcën e pathyeshme të gurit. Nata si

pistë prej nga të gjithë do të nisemi silencioze , e hajthme në një errësi të ngjyrë të verdhëlleme si sytë e Borgesit që vështronte ende një botë që prej tij ishte duke ikur. Heshtja misterioze e gjithçkaje të lodhur prej temperaturave të luftës. Mëkatarë bindjuni urdhrit dhe heshtni. Nuk kini rrugë tjetër. Njëlloj jini të skanuar. Unë tani po bëhem gati për heshtjen time të përjetshme.

1.1.09

FRIKA PREJ SË SHKUARËS

Tradita për inerci vazhdon të ushqejë të sotmen. Sidomos te pikat e dobëta që nuk janë të përgatitur për të ardhmen. Vazhdon një keqkuptim i madh rreth çështjes se sa tradita duhet të jetë e pranishme në të sotmen. Duke pohuar se ajo është rrënja jonë ne nuk prejardhemi thjesht si degë prej saj. Ka një diskutim të pafund edhe rreth një tavoline ku ne ushqehemi me menynë e traditës, ndërsa kështjellat janë kthyer në muzeume ku frika prej së shkuarës bëhet edhe më e pranishme. Tradita është pjesa jonë por jo krejt për ne që kemi ardhur këtu prej një dëshire të së ardhmes. Unë shkruaj ende në alfabetin latin por nuk pengohem prej kësaj tradite të lashtë për ta shprehur në mënyra të tjera të sotmen. Sklleverit si fatkeqësi na thonë se inteligjenca deri atëherë ka qënë në anën e zotërve të tyre. Tradita e skllavërisë ndoshta është më e keqja. Ne e kopjojmë atë pa i dëbuar më parë prej saj rregullat, Për të përqafuar atë dritë që çdo lloj tradite i le trashëgim së ardhmes së vet si një dritare të hapur. Me traditën do grindemi por jo gjer në vdekje, sepse shpirtat tanë do të bëhen pre e asaj që do të bëhet strehë për të për të gjetur ngushëllim ata që pa të ardhme do të kenë mbetur.

9.3.16

RËNKIME QË VIJNË PREJ SË SHKUARËS

Takimi me të shkuarën nuk është thjesht një çështje estetike për deri sa ne përherë do tu drejtohem burimeve të saj të zbulojmë potenciale të pashfrytëzuara ende. Mund të përfytyrojmë kështu Sokratin dhe krejt trashëgimninë filozofke të së shkuarës-bastione ndaj të cilëve do të ndërmarrim përherë operacione shpëtimi të vetes. Jo thjesht gërmimet arkeologjike ose transkriptimi i papiruseve për Trojën. Besoj se asnjë ngjarjeje tjetër botërore nuk i jemi kthyer sa asaj sikur në të të ishte fshehur e tërë enigma njerëzore. Duke kaluar pranë saj jo thjesht për kortezi e përfytyrojmë Trojën si kështjellën më të madhe të qytetërimit. Mos vallë sipas kësaj logjike i kemi hyrë në hak të shkuarës por edhe më shumë së ardhmes? Porta e enigmave sapo është hapur dhe ç'kemi parë gjer tani brenda është vetëm lajmërim për një udhëtim të pafund. Por të paktën gjer më tani kemi siguruar majanë për të mbujtur me të shkuarën. Hollivudi u bë sipërmarrja më e madhe kinematografike duke shfrytëzuar mitet dhe legjendat e saj. Ujin duam ta pimë atje ku është më i freskët dhe më i kulluar dhe herë-herë dëshirojmë ta zhdukim fare historinë nga mesi. Një lojtar kthehet shumë pas për të marrë fuqi të gjuaj më fort topin. Po pse e sotmja do të ketë përherë nevojë të thërras të në skenë të shkuarën? Duam t'ia mbyllim asaj portën por erëra të largëta fishkëllejnë dhe xhindet dalin paksa jasht për të parë motin. E shkuara gjendet dhe na

jepet jo e tëra njëherësh duke fshehur shtresat më të thella të mineraleve. Që breznitë të mos mbeten pa të ardhme e shkuara kujdeset të kushtëzojë pretendimet tona. Të investosh inteligjencien në atë hapërsirë që si trashëgimni na ka lënë pas mendimi. Dihet në të çfarë është e mbyllur por ne na duhet të rritim rendimentin në çdo njësi të prodhimit. Në fushën e mendimit kjo vlen për të na nxitur t'i rimarrim këto vlera e për t'ia sjellë kohës sonë në po atë shteg ku një autor kish lënë hapur perspektivën. Ajo që nuk u lexua dot në kohën e saj ishte dëgjuar më vonë si rënkim i së shkuarës. Ajo që nuk do të vdiste kurrë sepse ceremonisë mortore të saj i kishte munguar fjala e lamtumirës. Kish munguar fjala si e ardhme e cila në këtë ceremoni nuk ndodhej e ftuar. Me këtë mision niset çdo autor i së sotmes për të eksploruar të shkuarën. Do t'i drejtohem i përherë asaj për të zbritur te burimet e ujit sepse nuk dimë prej ç'ane po na vijnë shkretëtirat. Duket sikur e shkuara drejton të ardhmen tonë dhe se ajo po e tërheq pas këtë fill që kurrë s'ka për tu këputur. Ja ku jemi kthyer përsëri te autori i sotëm i cili hap fletën e historisë duke e parë të paplotësuar përherë të sotmen. Prej kësaj rruge në agimin e çdo dite do të shohim se ç'drejtim po marrin retë në qiell.

8.10.12

VULA DHE FIRMA E KOHËS

A jemi ne të ndërgjegjshëm se veprimi ynë në çdo rast përmban logjikën dhe arsyen? Dhe pse ai do të sulmohet më vonë për ta nxjerrë gati me përdhunë nga shinat? Në të vërtetë përgjatë këtij procesi diçka edhe më e thellë është duke ndodhur, përderisa lindi nevoja e gjykatave dhe më parë ajo e Këshillit të të Urtëve për ta gjykuar atë që nuk lindi prej fajit por, prej një stadi kur mendimet ishin të lirë për tu ballafaquar me njeri-tjetrin. Në çastin kur e kemi thënë, ne kemi shprehur një gjendje jo vetëm të vetes por të pleksur me shumë rrethana në mos me të tëra njëherësh. Ne jemi shfaqur por përgjegjësia përherë i mbetet kohës për të na gjykuar. Do të përqëndrohemi te çasti prej nga nisin udhë epokat dhe ç'është shënuar në të gërma A, është po produkt i çastit. Nëse unë tani po flas duke gjykuar, në radhë të parë e kam bërë atë lëndë shqyrtimi aq sa herë më ka dalë gjumi natën, nëse nesër në mëngjes do të thoshja vetëm të vërtetën. E megjithatë unë e thash atë pas një lufte të gjatë kur të mundurit ishin larguar vullnetarisht nga lufta. Atë që thash e përcaktoi vula dhe firma ime, sepse u tha me vullnet të lirë dhe jo nën presion. Kështu që përgjegjësia e këtij çasti nuk bie vetëm mbi mua por edhe mbi vet kohën. Koha kur e kam thënë ka qënë një rreze drite që po përpiqej të ndriçonte errësirën. Dhe mund të ketë qënë çfarëdo çasti tjetër që pati për këshillë logjikën dhe arsyen. Ajo që u tha tregoi të vërtetën se mes nesh po lindte një

demon i rrezikshëm. E prapë dhe prapë ajo është e vërteta. Ajo u tha për një mijë e një arsye dhe logjika e çimentoit sepse ekzistojnë mënyra të pafundme, për të artikuluar të vërtetën. Ja pse ne ua kemi dhënë këtë pushtet gjykatave të cilat nuk tundohen prej të qarave dhe lutjeve.

14.5.18

PAFUNDËSIA NDODHET PËRTEJ NJË BREGU

Vetëm ideja e vdekjes çliron energjitë e jetës. Mendoni një çast sikur ajo të na braktiste çfarë tjetër do t'i përcaktonte rrjedhat tona. Do na humbiste motivi i shpejtësisë dhe përfytyrimi i një udhe pa lodhjen e gjunjve. Kjo anë e njeriut që përkon me misterin na mba më pranë realitetit të gjërave. Me mendjen te një fund ne përherë synojmë pafundësinë. Pa këtë sfond ne nuk mund t'i sjellim dot pamjet që sheh syri që është duke skicuar të ardhmen. Ne jemi të tillë sepse që në lindje jemi të përcaktuar prej vdekjes. Ky sfond që ndriçohet prej idesë së përjetësisë as që do të ishte i tillë nëse burimi i jetës nuk do të gjejë çfarëdo hapësire tjetër për tu derdhur. Është pafundësia si e tillë që ndodhet përtej një bregu që në këtë rast përfytyrohet si vdekja. Synimi ynë bëhet më i qartë tek përpiqet të zbulojë misterin i cili nuk është fare i zakonshëm, por i mbrojtur mirë për të mos i lejuar kërkuesit t'i afrohen duke i joshur përherë drejt një Eldoradoje. Nga bota e ëndrrave tona vijnë përherë mesazhe të çuditshëm. Nëpër terr të subkoshencës është duke u zhvilluar drama e vërtetë e njeriut, i cili edhe pse pa dëshirë gjendet i ndarë më dysh në këtë rrëshqitje të pandalshme drejt abisit. Pjesa më e dhimbshme e shtruar në tavolinën e kirurgut. Aty na seviret e vërteta për të ndihmuar realitetet tona për të qënë më konfidencialë me vdekjen. Kurrë s'kemi për t'i ikur këtij lloj detyrimi dhe as utopia më e zjarhtë-frelëshuar e kupton

se hapësirat një nga një janë duke u mbyllur. Por ky shërbim që vdekja i sjellë jetës më së shpeshti shoqërohet me urrejtje e dhimbje. Një ndjenjë hakmarrjeje e paskrupullt e ve në shënjestër të gabuar jetën prej vdekjes. Ajo kthehet kështu në një lloj tiranie të egër dhe ne e mbyllim atë thjesht në një varr të mbuluar me lule. Sa e sa shumë kemi për të thënë për këtë mizëri pandehmash që e begatojnë mendjen tonë duke pasuruar fantazinë e nxitur inteligjencien. Gjer te ky prag që përpiqemi për të gjetur mënyra si ta kapërcejmë pa e prekur. Për te ky prag duket se fle gjumë e ardhmja. Ajo që vet është në dorë të një vdekjeje tjetër. Kjo temë e madhe përtej çdo përfytyrimi me të cilin ne duam ta prekim. Dhe le ta përfytyrojmë njeriun në udhë duke e mbartur atë përherë me guxim e kurajo si një fatalitet prej të cilit ikimë duke qeshur.

25.1.12

HISTORI QË BRAKTISET UDHËS

Përgjatë udhës për shkak të pengesave nisa të vija në dyshim dhe veten. Isha kthyer nga udha pikërisht për të mos i marrë tërë këta pandehma si shoqëruese të udhës. Ndoshta ti që flakëron këtë shigjetë duhet ta dish edhe dhimbjen që ajo përcjellë kur të ngulet te mishi. Dhe s'është mirë të kesh shumë dilema sidomos, rrugës i trembur se do të sulmohesh pa mbërritur ende te fundi. Po nëse forca e argumentit është e pashterueshme ajo do ketë fatin të bëhet edhe ushqim filozofik, edhe çast përsiatjeje, edhe këngë. Por duhej të vinim te ky çast me të qeshurën në buzë për të ndrequr humorin. Nëse vërtet kemi një fuqi të tillë për të ndërmarrë këtë hap le t'ia fillojmë. Pas kaq shumë opinionesh e shumë më tepër pengesash duket se e trazojnë edhe më tepër neutralitetin e opinionit publik. Aq më tepër kur zbulohet në të fare lehtë skllavëria e mendimit, kur dukej se do ta ngrinte më lart kurbën papritur ajo zbret posht plot dëshpërim duke tronditur kështu dhe arsyen. Ka shumë njerëz që na paraqiten me targun e mësuesit në popull. Një delir çmendurak që paguhet për t'i thënë të vërtetat përgjysmë. Në të vërtetë ne duhet të operojmë mbi shoqërinë por me mjetet që na jep ajo vet, sepse është pikërisht sëmundja e saj që dikton edhe kurën e shërimit të saj. Nuk do t'i lejoj vetes të bie në grackë të një problemi apo teme të caktuar, aq më keq të ysht përditshmërinë të ushqehet me këtë ushqim të

dëmshëm e helmues. Ndoshta duhet punuar me ide që përkthehen në projekte se si të bëhesh serioz nën efektin e humorit të të tjerëve. Ka njëqind opinione në ditë që publikohen por edhe me këta 100 motorë shoqëria s'ka lëvizur as edhe një milimetër përpara. I përfshinë tërë thashë e themet plot gallata shoqërore që i gëlltitin fjalët fare pa i qeruar. Po ta ngresh vështrimin pak më lart do të shohësh një qiell edhe më të pafund dhe do të të duhet ndoshta të ndërtosh një perspektivë tjetër, sepse largësia nga ti gjer te pafundësia është rritur në proporcione marramendse. Shoqëria jonë është një përzierje që vështirë se mund të shërohet prej një ilaçi të vetëm. Le të filozofojmë edhe pak më tepër sepse jemi në stadin kur ndoshta edhe mekanizmi rregullues tek ne nuk ka lindur akoma. Dhe si të thuash i djegim më kot etapat dhe çdo lloj investimi shkon dëm ashtu siç ndodhi në vitin e mbrapsht 1997. As kjo që them unë nuk është shpëtimi por thjesht një përpjekje për t'iu afruar problemit, aty ku e lanë intelektualët e shquar të viteve'30, të cilët që atëherë nisën një operacion të vështirë mbi shoqërinë shqiptare, por rrjedhat e historisë e çuan këtë shoqëri në drejtim diametrisht të kundërt.

12.4.10

BOTA E PARË PREJ NJË DRITAREJE TJETËR

MAGJIA E SHKRIMIT

Herë-herë një lirizëm i skajshëm e përshkon atë që ti do të thuash dhe të duket se prej një pompe të fuqishme uji derdhet në gojën tënde prej burimit më të thellë si në kohërat e shkretëtirës. Ah sikur tërë këto të mos kishin qënë vetëm çaste dhe koha të të priste sa të rishkruaje Iliadën më të re të Njerëzimit. Ti o njeri i kërcënuar përherë prej një fundi që vjen prej asaj thellësie je duke dëgjuar këtë thirrje dhe del natën nën dritën e hënës për të korrur gjembat. Por nën duart e tua rrëzohen edhe viktima pa numër. E keqja e përçafuar me të mirën shtrënguar si kocka me mishin. Një muzikë funebre e shoqëruar me një alegreto për të qeshur në pikën ku ndahen fatet e botës sonë dhe po gjëmon brenda teje kjo lirikë e shfrenuar. Dorës që po shkruajmë ia rrëmbejnë tingujt dhe thikat ngulur në zemër ato duan që t'i shohin. Por sa e pamundur që është dhe kjo prandaj dora jote vijon të shkruaj, shkruan e shkruan tërë kohës ndërsa bombat rreth teje përcasin duke qeshur. Një valë e nxehtë gjaku nga thoi i këmbës gjer te fija e flokut ka ngritur në një alarm krejt trupin. Ti o bishë që veten tënde je duke e shqyer për të mposhtur të pamunduraturat, shpëtimin e ka gjetur te kjo mënyrë shprehjeje që pas pak do të lutet: Merreni këtë bishëz të vogël të sapolindur dhe mblidhni pjesët e trupit tim para se të vijnë shkabat ta shqejnë.

14.10.08

“KOMBËSIA” E LETËRSISË

E kuptoj një letërsi pa kombësi sepse mes meje dhe asaj vendoset një barrierë e cila më pengon leximin dhe më detyron të vendosem në kushte që kurrë më parë nuk i pata përjetuar. Që prej këtij çasti lexuesi rrezikon që me çdo lloj letërsie të bëhet i huaj. Por atëherë ç’duhet të jetë një letërsi, prej ç’zëri dhe prej ç’duhme ajo ka shpërthyer? Më duhet të them se pyetja ime nuk është aq e lehtë dhe për t’i dhënë përgjigje më duhet më parë të zgjedh sfondin ku ta vendos atë. Çdo lloj letërsie e mirë më ka dhënë një përgjigje shteruesedhe unë i kam qënë asaj përherë mirënjohës për tu ndjerë si në shtëpinë time. Këtë ndjesi për herë të parë më duket se kam përfutur prej romanit të Blasko Ibanjezit përkthyer mjeshtërisht prej Imzot Theofan Stilian Nolit. Spanjën e Ibanjezitatëherë më kujtohet e kisha vendosur nëpër shtëpitë e ulta të fshatit tim Shën Vasil. Emrat spanjollë të librit, Noli i kish shqipëruar kaq bukur me kolonjarçen e tij të një tradite më të hershme, sa mu bë se ky libër ishte shkruar prej një shkrimtari shqiptar. Siç besoj do jenë ndjerë lexues të vendeve të tjerë njëlloj të tillë. Duke e zhvshur prej kombësisë së rastit ata -lexuesit letërsinë e kishin përfutur si të përbotshme. Çdo letërsi e mirë pra e zhbën presionin e kombësisë në favor të universalitetit, por për këtë nevojitet një këshill ndërmjetësish siç janë përveç autorit edhe përkthyesi. Por edhe botuesit-eksploratorë edhe kultura e një vendi e

përgatitur në atë nivel për ta thithur e bërë pjesë të kulturës së saj, duke e mirëseardhur çdo autorqë me shigjetën e fjalës së tij ka prekur mendjen e krejt njerëzimit. Letërsia besoj se edhe në këtë drejtim nuk ka pse të bëjë përjashtim njësor si shkencat e progresi teknologjik, që u kap aq shpejt prej mentalitetit japonez e atij kinez. Njeriu i çdo kombësie apo race e kontinenti tjetër, për afrohet me sivilizimin e vet kudo gjatë përmes disa receptorëve që e përcaktojnë qënien njerëzore si të tillë. Kjo i bënë edhe ilaçet e shpikur kurë për çdo lloj sëmundje siç sjellë po atë humor për këdo aktori i madh Ben Hill.

12.10.08

NË SHTËPINË E ARTIT

Idetë në arkitekturë më vonë ngurtësohen në atë çka u realizua përmes tyre. Ajo duke u shkrirë në përditshmëri bëhet gjithnjë e më pak art. Duket sikur funksioni i artit mbaron dhe pjesa sakrifkohet pa bujë për të tërën. Arti që atë e lindi e çoi më tej atelien e vet për të përfunduar projektin e ngritjes së një qyteti. Dhe qytetarët tani pa e kuptuar jetojnë në shtëpitë e artit si një mision i kryer. U përpoqa ta nxjerrë prej përditshmërisë sime këtë vlerë, sa herë ngjit e zbres shkallët dhe sa herë hap e nbyll dritaret. Një tjetër mbi e nën vete që më trokasim sa herë për nevojat e tyre si për të më zbuluar defektet e vet artit. Arkitektura është përgjithësisht e ftohtë dhe vetëm kur i japim flakë zjarrit ajo shpërthen papritur. Jetë e formësuar prej artit. Unë eci udhëve të ideuara prej artit i përkufizuar po prej tij, për tu kthyer më vonë dhe papritur zbuloj në çfarë tjetër arti mund të shndërrohet. Ai është duke më orientuar drejt së ardhmes dhe vet ekzistencat tona është duke i nxjerrë prej përditshmërive. Më pas gjithë këtë ngrehinë të artit do të duhet ta thyejmë si copa të një ajsbergu të madh. Kështu arti u sakrifikua duke e bërë edhe më mjerane ekzistencën. Sado lart që ne mbi të ngrejmë flamurët e të shkuarave tona të lavdishme. Statujat kanë ngrirë. Historia jonë u bë kështu kohë akullnajash. Arti na futi në shtëpinë e tij duke na ftuar ta orendonim nga brenda e pas ndarjes së interiereve që ai kish ideuar. Ky kishte qënë kushti

që na u imponua që në blerje. Me qëllim që arti të fillojë të na jepej në një mënyrë tjetër. Ishte thjesht një marrëveshje që nesër mund të priset në mirëkuptim sepse do vijne blerës të tjerë që do gjejnë këtu pika të tjera takimi me artin. Kështu arti pa kuptuar ndryshon jetët tona duke na strehuar në ngrehinat e tij, për të na bërë më shoqërorë e për të na venë në një marrëdhënie të re me të bukurën. Arkitektura na ndryn brenda vetes duke e quajtur të përfunduar misionin e saj.

2.11.17

NË DITËVDEKJEN E SHIMBORSKËS

Kështu nis një lajm në çasstin kur ti ke zbuluar një mungesë tjetër te vetja. Kudo që ajo ta ishte fshehur, nëpër çaste kërkimi ku kthetrat e tua ishin duke gërmuar atë për ta gjetur. Ajo zbulohet papritur nëpër faqet e gazetave si lajmi më i freskët dhe, të jep pak kohë sa ti të bëhesh gati për një rivlerësim të së tashmes , me atë në duar për të rikonstruktuar peizazhin ku gjendet e shënuar një pikë prej së cilës buron një dritë e re dhe e panjohur. Dyshimet që më së pari shfaqeshin në mjegull u shpërndanë për tu bërë së bashku të gjitha. Një i humbur u shfaq midis nesh për të gjykuar sjelljet tona në kohën e mungesës së saj. Mbrëmë natën kishte vdekur Shimborska, poetja e madhe polake, fituese e çmimit Nobel, në moshën 82-vjeçare. Ky ishte lajmi prej të cilit unë zbulova peshën e rëndë të një humbjeje. Pa të tani mu bë edhe më i qartë horizonti sepse vetëm tani ajo është në një mënyrë më të plotë e pranishme. Do të nis sërish të lexoj poezitë e saj duke e nxjerrë si libër të parë prej bibliotekës sime. Poetja që e kisha njohur përmes poezisë gati 20 vjet më parë për të mu kthyer në një zbulim pasi zëri i saj tashmë kishte heshtur. Për ta vendosur poeten në kalendarin e të shenjtëve. Atje ku ngjiten në fron ata që fitojnë të drejtën për tu zgjuar prej heshtjes së tyre. Poezia si hapësirë por jo vetëm e poezisë. Ajo që këtë çast dhimbjeje fiton të drejtën për tu bërë kryezonjë dhe të mbajë në duar fenerin për

të na ndriçuar drejt një udhe të re dhe të panjohur. Do të lëvizim të gjithë prej vendit për tu akomoduar sërish përballë diçkaje që vjen tani drejt nesh në një mënyrë tjetër. Në kohën që ne diku kërkonim koha sipër saj hidhte vazhdimisht mjegull. Të gjallët janë kaq të shumtë sa ringjallen vetëm kur vdesin. Me këtë lajm të freskët prej vdekjes së saj ne bëhemi njëherësh pronarë të një thesari të sapozbuluar. Testamenti i saj ka firmën e të gjithëve. Jemi të lirë të zgjedhim. Që prej sot kemi zgjedhur mes paavdekësisë dhe përditshmërisë të parën. Këtë kishim kërkuar kaq gjatë dhe u verbuam për një çast nga drita e këtij zbulimi. Me mbërritjen e lajmit edhe unë tani po rishikoj axhendën time. Do ta ngre poezinë në një rend më të lartë pasi poezia e Shimborskës tani ka heshtur. Një zë që na thërret për vazhdimësi. Poezia askëtu s'do të ndalet përveçse zbulohet në raporte të rinj, nën dritën e këtij lajmi kur ne patëm zbuluar atë që na mungonte. Le të thërrasim të urtë të tjerë sa janë të gjallë për të kuptuar senë ç'stad të një të ardhmeje ne gjendemi. Ajo kurbë që lëviz e shqetësuar ndërsa po fryjnë erërat e tjera të panjohura. Shimborska si njeri vdiq për t'i dhënë lirinë poezisë së saj. Ekzistenca kishte qënë ndoshta kjo pengesë që ne të bëheshim përfitues të një trashëgimnie. Mirë se erdhe Zonjë midis nesh-pëshpërisnim në lutje kujtimin e saj të ndjerë, që çlirohej prej një afshi të lirë në fluturimin tënd nëpër këtë qiell të mbëmjes. Duhej kjo vdekje mizore që ti të bëheshe krejt e jona. Tani që ti u ule në fron diçka ka për të ndryshuar në librin e lutjeve tona për tu falur me fjalë të poezisë tënde. Të gjallët vërtet janë kaq të mërzitshëm dhe të ditëpërditshëm. Dhe ja pse ne jemi të detyruar të paguajmë te harresa për tu bërë kujtesë.

2.2.12

ME POEZINË UDHË E MBARË DITË

Ishte ky zgjim i beftë që nuk e di prej ç'shaku më sollti në kujtesë poezinë Dora Markus të Euxhenio Montales. Ka qënë vërtet një bashkëbisedim i mrekullueshëm i inspiruar prej trishtimit të thellë të një humbjeje. Kujtimi i një gruaje, dashuria së cilës u bë e përjetshme. Një grua që prej këtij bregu është duke parë bregun tjetër të vendlindjes së saj dhe, ti ndjen se si ajo po shndërrohet në një torturë të ëmbël në përballje me të shkuarën. Dora Markus në vetvete u bë ndjesi e poetit. Një e ikur që po zgjohet në një vatër zjarri të shuar. Për tu bërë kohë e të gjithëve, e një dashurie të dikurshme dhe e një ikjeje fatale-far që të drejton drejt një bregu të ardhmë. Pesha e rëndë e këtij kujtimi bëhet gati e papërballueshme por vetëm një poezi si kjo mund të përballëj me të, përmes plagëve e dhimbjes. Nuk di si mund ta përfytyroj dikush tjetër por për mua është poeti që unë tani kam në mendje. I humburi që po përballlet me një humbje tjetër më të madhe për tu bërë kjo peshë e përbashkët me mendjen e lexuesit. E rëndë por me njëhir fisnikërie -ajo që e çonë gjer në platformën e saj për ta vendosur këtë statujë të Dora Markus në bregun tjetër. Montale e tërheq drejt vetes me stoiçizëm kujtimin e Dora Markusit kurse vet Dora është duke kryer një zbulim tjetër më të thellë të vendlindjes së humbur. Poezia tani është duke i çuar ndihma humanitare në qiell. Koridore ajri për të shkuar te shpirtrat tanë të përvuajtur. Poeti

zotëron me të thellësi dhe vjen për tu përplasur në kujtesën tonë me gjithë këtë ngarkesë që s'duhet kurrësesi të shkërmoqet. Ajo që meriton pavdekësinë është duke fituar hijerëndesën e një monumenti. Prej saj ne mbartim tërë humbjet tona në mënyrën më dinjitoze për t'ia dhënë së ardhmes sonë silajme jo dhe aq të mira. Por Dora Markusin s'kemi për ta lënë kurrësesi vetëm edhe pse ajo do të jetë përherë faqja e parë e një libri të grisur. Kjo shkrepëtimë vetëtimash-radar i imazheve të largët. Njeriut vet i ndalohet për t'i çuar të gjithë në vdekje. Dora Markus bëhet kështu pengu më fisnik që ia vlen për ta mbajtur në krahë si trofe të luftrave të Njeriut. Montale na sugjeron ngushëllim për dhimbjen, për tu njësuar paqësisht me natyrën. Dora Markus në përfytyrimin e saj është duke parë në botën e nënujit kocat që i tregojnë udhën për të kapur bregun tjetër. Dhe një tufëz fjalësh të urta që vijnë bashkë me të shkuarën që është duke ikur.

3.3.12

PËR DERRIDANË

Duke lexuar Derridanë përnjëmend më kapën ca spazma të çuditshme. Nuk po e gjeja dot burimin prej nga i vinin fjalët, për ku i çonte dhe për ç'fis të ardhmërisë i pat lënë aty të ngrinin qytetërimin e tyre të varfër. Derrida flet për poezinë sepse duket qart se sa ai prej poezisë ka vuajtur. Nuk ka asnjë mëshironjës tjetër kaq të përbindshëm sa t'i mbajë të tërë mbi krahë ndoshta dhe pa ditur se ku do t'i çonte. Që në hyrje të esesë "Ç'është poezia" Derrida na shfaqet pothuaj krejt i pamundur ndërsa përdor një lloj retorike që kurrë më parë nuk qe artikuluar në asnjë lloj gjuhe. Ai flet me sinqeritet për një gjë që nuk e di çfarë është por kompetenca e tij pas kësaj fraze lutëse dot nuk mund të fshihet. Ndërkohë që ne kuptojmë se poezia përherë do të ketë qënë ndonjëfarë shenje e Zotit që vazhdon të jetë një natyrë ku ne kemi dalë për të eksploruar vet origjinën tonë. Derrida flet i përlur për një gjë që e mba në dorë dhe nuk e di çfarë është dhe nuk di ku ta çojë ndërsa në duar kjo gacë zjarri po i digjet . Ky filozof që përpos çdo përkufizimi mund ta quajë të tmerrshëm, bëhet një nga brinjët e mia në pamundësi për tu zgjatur-pjesë ekëtij universi që gjallon brenda njeriut. Meqënëse s'mund ta përkufizojë siç ai s'mundi kurrë ta përkufizojë veten, edhe unë i dhash liri vetes për tu zhytur në atë univers për tu gjendur më në fund në thellësi të kësaj humnere të lemerishme. E lexova pjesë-pjesë sepse e tëra qe e

pamundur dhe, kur i bashkova me mundim të madh pjesët me njera-tjetrën, zbulova se ato ishin në perfeksion me pjesët më të panjohura të universit. Në fakt nuk jam i lodhur por ishte kënaqësia ajo që më shtynte drejt tij për tu bërë harakiri. Në çaste të rrallë ia kisha mbërritur dhe gjer te kjo pikë e kisha braktisur penën. Sidoqë ajo ishte një lloj përpjekje si dështim i radhës për t'i mbërritur një fundi të pamundur. Por unë kam përmbrojtës padijen time e cila të shëron prej çdo lloj mëkati. Bëj një tjetër stërmundim për tu zhvendosur për më tej këtyre shpjegimeve të pamjaftueshëm. Ndoshta për tu pajisur me një lloj identiteti ndaj kohës së cilës i kemi borxh pamjaftueshmërinë. Asaj që në një farë mënyre bëhet shkak për viktima të tjera të ekzistencës.

9.9.09

POETI NË BUST

Poeti ka një bust të vogël në një stacion treni të periferisë. Ka vdekur shumë i ri por la një vepër mbresëlënëse. Poetët që vdesin të rinj rrethohen detyrimisht me një auereolë që i afron edhe më tepër të pavdekësia. Poeti Llalla ishte një i tillë, një shenjë prej së cilës është e vështirë të mos mbetet i mahnitur vështrimi i çdo kalimtari. Ka një ngarkesë të thellë për vizionarët përkundër padrejtësisë së realitetit që i rrëmben nga jeta kaq shpejt këta misionarë të së ardhmes. Ose ata kanë ardhur në jetë enkas për të ikur shpejt si një lloj profecie që ne s'kemi arsye pse të mos i besojmë. Dritat në stacionin e Menidhit e rrethojnë çdo çast bustin e vogël ngritur mbi një pedestal të lartë gati dy metra. Për tu dhënë mundësinë për ta prekur dhe për ta parë nga afër jo nga lart për më tepër si një njeri mes njerëzve, në këtë lëvizje të pandalshme të mbrëmjes. Për të biseduar me poezinë e tij. Si diçka e ndërprerë para pak çastesh, si një lloj fryme e ndalur paksa për të gjetur rrjedhën e një mendimi. Këtu e kupton më mirë se si një poet mund të shndërrohet në një lloj tempulli ku ftohesh për të pirë një kafe, ku të lejohet të bësh edhe ndonjë shaka të vogël. Por në mëngjes gjen aty edhe diçka tjetër, dëshminë tronditëse që një poet ka aftësinë për ta parashikuar por jo për ta ndalur. Shiringa droge dhe blerës e shitës që zhduken para se të bjerë dita. Përfshihesh në një pikëllim të thellë në zemër edhe ajo të bëhet pjesë e

jetës tënde e të duket gati si diçka e pashmangshme. Njerëz të dëshpëruar kjo botë ka patur përherë dhe jo për çdo njeri mund të ketë një zgjidhje të vetën. Ka zgjidhje tepër të vështira dhe me kosto tepër të lartë. Është edhe brenda poezisë, ndryshe s'do të ekzistonte as dhimbja, ky motiv që i jepë një ritëm tjetër kohës, të shqetësuar dhe tragjik, ndërsa gëzimi dhe lumturia herë-herë të duket sikur s'kanë ekzistuar kurrë. Ky peizazh i stolisur kaq natyrshëm i jep mundësi poezisë t'i bashkohet jetës në të tëra çastet për ta njohur më mirë të vërtetën dhe pa e zbukuruar kurrë atë që tani është e trishtuar, duke e mbuluar me një vel lumturie. Poeti i ri Lalla në bustin e tij është pikërisht këtu në vendin e duhur për t'i mbajtur të gjallë imazhet e poezisë së tij dhe për të bashkëjetuar me dhimbjen dhe absurditetin e kohës. Ai thjesht mdoshta do kundruar si dëshmor i një dëshire të pambërritshme.

16.12.19

ART

Ato që te Kandinski duken një grumbull gjërash pa lidhje papritur shndërrohen në objekte dhe njerëz. Përmes dritës që çlirohet prej njerit të shfaqet një tjetër dhe tabloja nis e ndriçohet e tëra duke nxjerrë prej errësirës një hapësirë më të madhe se kaq sepse objektet janë afër qiellit Ndërsa poshtë është duke zbritur një luginë e cila edhe pse duket e ngushtë dhe e thiktë ndihmon për t'i dhënë lartësinë e nevojshme çdo objekti, i cili vendoset në një raport të caktuar me lartësinë. Ndërsa Pikaso ka më pak elementë por rrit shprehësinë e çdo njerit prej tyre derisa krijohet një figurë gati gjeometrike që ka brendësi të thella. Duhet një dritë tjetër për të zbuluar Pikasonë. Prej andej duke parë Kandinskin nuk mund të shohësh dot Pikasonë. Te arti realist zakonisht nuk ndodh kjo sepse ai të shfaqet i tëri pothuaj njëherësh. Edhe pse drama të forta ato e zbulojnë veten qartazi dhe janë bashkë dhe vrasësi dhe viktima dhe gjaku që prej tyre është duke rrjedhur. Si te Delakrua përshebull . Por duke parë një tablo të Pikasosë apo Kandinskit mund të pyesësh: Pse gjithë kjo vështirësi në interpretim? Është vallë metoda që e dikton një gjë të tillë apo vet epoka dhe njerëzimi i saj gjenden në vorbulla ndryshimesh ende të papërcaktuara? Mungon drejtimi apo perspektiva për ku ato vet janë duke ecur? Ndoshta, por arti duke qënë më i ndjeshëm është i pari që hynë në betejë ose thjesht ai është duke u paraprirë këtyre zhvillimeve. Falë intuitës dhe shqisave të shumta me të cilat percepton botën, ai e ndjenë se koha tani ka

të tjerë imperative. Nuk mjaftojnë më leksionet shkollareske për ta shpjeguar. Një frymë e re mistike e veshur me realitete që ngjajnë e s'ngjajnë të tillë, piktorët e rinj të shekullit XX nisin aventurën. Bota nuk është më një e tërë dhe e rrombullakët sa ç'duket. Ajo përbëhet prej pjesëve pa numër që tregojnë agresivitet të madh ndaj njera-tjetrës. Shprehja e këtij zbulimi ndoshta ka kërkuar dhe mënyra të reja interpretimi. Jo thjesht rinovimi i një metode por më tepër përmbysje, shpërthime atomike, miti dhe realiteti gjejnë shprehje në ide që pulsojnë nga brenda njeriut. Surealizëm, ekzistencializëm, kubizëm, imazhinizëm, impresionizëm... Duke sikur arti po vdes para se të marrë frymë për herë të fundit.

Gjithçka te një pikturë e Pikasosë apo Brak së pari mund të shpjegohet me një Mund e cila vetëm sa hap rrugën e zbërthimit të një vështirësie që gjer në fund besoj se do të mbetet e tillë. Mund të jetë kështu , mund të jetë ashtu dhe truri vihet në një lëvizje ushtruese të pazakontë. Po a i afrohem dot vallë ideve të autorit kur edhe ai vet ende me penel në dorë ato është duke i prishur? Ja të afrohem edhe pak ose të vendosem më mirë në dritë mos më shfaqet edhe një kuptim tjetër. Lojë e pakuptimshmërisë është vallë kjo pikturë që shitet miliona dollarë? E pamundur,por ky lloj intelektit gati i paklasifikueshëm nuk ka patur mundësi për tu shprehur ndryshe. Le të zhvillojmë një bisedë me vet objektin që ndodhet i ekspozuar në galeri, ndoshta prej aty do zbulojmë të vërtetën. Mund të ketë edhe mënyra të tjera duke e përçarë kaosin për të goditur te Thembra e Akilit. Prej kaosit lind rregulli, mirëkuptimi. Duhet të jemi të vëmendshëm ndaj çdo tingulli që mund të dëgjohet gjatë çarjes. Por mos jemi përsëri në rrugë të gabuar dhe do na duhet të kthehemi sërish te pika e fillimit? Por disnivele i madh që ekziston mes njerëzve të ndryshëm ose mungesa e interesit te

popujt primitivë do ta vonojnë përherë trenin e së ardhmes. Eleganca e Trojës apo dhe e Parisit të shek XIX janë gjëra që nuk kthehen. Tani është Dubai por mrekullitë s'kanë ç'na duhen pa njerëz. Në Dubai s'mund të shkojnë të gjithë dhe besoj se dhe ai do bjerë shumë shpejt siç bien në abis ëdnrrat. Pikaso ka ndërtuar botëra të së ardhmes duke parë në mënyrë ende të pashpjegueshme realitetet , në pikat më nevralgjike pikërisht atje ku përplasen tërë ndjesitë tona ose, njëlloj si vështrimet që e kanë të pamundur të shohin që prej këtu prapakthesat. Mundet që ne përfytyrojmë bëhen një ushtrim i jashtëzakonshëm për inteligjencën. Vetëdijet tona gjenden në një zgrip por kush ka mundësi të lexojë aq thellë edhe sipas këtij udhëzuesi që mund të ketë shpikur Pikasoja. Me Dubain e sotëm gjërat janë më të thjeshta edhe pse mrekullia e tij është verbuese. Prej shkretëtirës u përftua një oaz i cili besoj se do ketë efektin e një terapie të përkohshme, sepse tashmë shkretëtirat drejt nesh janë nisur. Gjithçka që nuk duket edhe kur përpiqesh të shikosh sa më thellë saj. Por nuk largohem dot prej pikturave të Pikasosë i mbërthyer prej një thellësie tjetër. Një lloj zbulimi i thellësiva tona si një përpjekje për të çliruar energji të munguara. Mos ndoshta vallë ky blerës i tablosë së Pikasosë është thjesht duke blerë formën e saj pa ditur se ç'ka brenda saj? Le të zbulojmë aty mjerimin tonë intelektual i cili nuk di as vet ç'mban të fshehur brenda. Dhe një Mund tjetër shpërthen prej spektrit dhe pasurohet përvoja e cila tashmë bëhet e prekshme nga njera anë dhe në një cep të vetëm të saj. Këto Mund-e të pafundëm do të çlirojnë përherë energji të papërfytyrueshme. Eksploratorët dhe vetëm ata pas kthimit do të na lajmërojnë se çfarë kishin zbuluar në ato toka të panjohura.

12.4.10-29.3.10

FJALA E LINDI NJERIUN

Po e nis tani me veten, d.m.th për të folur me veten dhe një mijë e një vështirësi që më shfaqen përpara, për t'i dhënë udhë fjalës së parë që është duke u përpjekur të marrë një shpejtësi prej së dytës. Është thelbi prej të cilit domosdoshmërisht duhet patjetër të lindet diçka tjetër. Po çfarë e pengon komunikimin që ai të bëhet i mundur? Në mos është vet lufta e tërë kundërshtive tona që e vështirësojnë të pamundurën për ta bërë edhe më të pamundur. Por megjithatë nevoja për të folur duket se ka qënë vet urdhri i një zoti që i shqyen këta gardhe dhe në një çast e kemi parë veten nën një drtië tjetër. E pamundura e vështirë në mos e kemi shpërthyer, së paku e kemi zhveshur nga anët duke i dobësuar koracën për të bërë të mundur që të tjerët të guxojnë për të hyrë më në thellësi të saj. Nuk e di sa të drejt kam të jem mospërfillës ndaj asaj që mendojnë të tjerët, por unë kërkoj leje për të performuar idetë e mia. A s'është edhe kjo një mënyrë komunikimi? Kam folur me përvojat pa u mbyllur kurrë ndaj tyre por këtë çast këtu, jam unë i ngarkuar me përgjegjësinë për ta mbajtur atë mbi shpinë. A s'është edhe ky një lloj nderimi ndërsa po komunikoj me të shkuarën, e cila do të gjej përherë një dritare hapur për ta përshkuar të tashmen? Unë që jam duke tërhequr pas fijet e saj vazhdoj një bisedë prej mijëvjeçarëve të largët. Nëse dritarja do të mbyllet me përdhunë godina e saj do të lëkundet nën goditje që sa vijnë e bëhen më

të rrezikshme. Hapu Sezam - kjo është thirrja e famshme që përplasat nëpër dyer e dritare. Hapu për të shpëtuar lëndën që po i vdes përbrenda shpirti. Shurdhëria ndaj gjuhës është një krim që nuk fajëson më dot armët ,të cilat nuk e kanë sensin e arsyes pa i fërkëtuar më parë për të dëgjuar urdhrat tanë të vjellin zjarrin e urrejtjeve tona. . Një temë që mbarështron të folmen dhe ne që jemi duke pritur aty për aty rezultatin e saj. Dhe në heshtjet tona do fisnikërohet edhe më tepër e folura. Ose para pasqyrës të cilën e spërkatim me pështymat më tepër se me frymë. Kudo që të ndodhemi jemi të dënuar prej fjalës e cila ka ngritur industrinë e së folurës. Kur për të shprehur të folurën, e shoqërojmë me mimikë dhe lëvizje që adreson fjalën në tabela që këtë çast po goditen prej plumbave. Para se të kthehej në art komunikimi fjala nuk e njihte metafizikën. Bashkëbiseduesit nuk kishin filluar ende të flisnin me perënditë. Lindnin e vdisnin duke mos uruar e ngushëlluar njeri-tjetrin kurrë dhe për asgjë.Ajo që shihej me sy mund edhe të mos prekej me dorë, por kjo nuk shkaktonte trauma sepse shpirti i njerëzor nuk kishte lindur ende.

8.4.10

LERE TË PUSHOJË PENËN MBI LETËR

Vendosa t'i dëboja prej shkrimeve të mi gjendjet e lehta, çaste që kërcenin përmbi shkronjat pa mundur dot të nguleshin aty për të hedhur rrënjë. Të shkruaja diçka që t'i depërtonte çdo syri në bebëz dhe ta çonte këtë shigjetë helmi me të vjellat e veta. Këtë kisha dashur të shkruaja por janë shumë të vështira të pamundurat e lexueshme dhe s'guxojnë e vendosin të mos shkruhen fare, thjesht se nuk munden, duke qënë ëndrra të këqija që ashtu siç u panë dhe u harruan. Ti nuk mund të shkruash dot-dëgjova dikë që më fliste në delir ndërsa prej meje me shpejtësi ishte duke ikur. – Ne jemi të pakapshme, ne jemi të pamundurat e tua vrasëse, ne të ikijmë prej duarve si kjo shigjetë e më mirë pranojmë të mbillemi si bimë nëpër toka të tjera se të vrasim. – Ti je vrasës- uilërinin ato duke ikur. – lere njeriun në paqe. A nuk po sheh se nëpër jetët e veta ai shtë duke nxituar. Kaq shumë brazda ta hapura që po marshojnë jo nën por mbi plugje pa numër. Njerëz të urtë që kanë shumë emra paraardhësish që i shoqëron një muzikë tjetër dhe pikërisht kjo muzikë që ti përpiqesh tu injektosh si helmin tënd në trup. As me magjitë e tua a'ke pse i shton dyshimet njeriut që në të drejtën e vet është duke ecur. Ata njerëz të urtë që kanë shumë emra paraardhësish të mi të vdekur prej shekujsh, të vdekur vetëm pse nuk guxuan të pinin këtë helm dhe u zhdukën pa nam e nishan. -Ti nuk mund të shkruash dot- thanë ata- edhe për shkak

të kësaj arsye të madhe që nuk u jep më asnjë shans të ngjallen të vdekurit. Atëhere nëpër qiej do navigonin shumë Akilër fluturues dhe Odise më të marrë se origjinali i tyre, që prenë kaq shumë monedha me fytyrat e veta, duke shkaktuar kaq shumë çarje të tokës për të krijuar Itaka pa numër.-Më mirë mos na shkruaj, për të vërtetën e madhe që dot s'mundesh ta shkruash. Ndryshe do të vrasësh jo vetëm ne por edhe lirinë tënde. Ti do të bëhesh i përveçëm, por ajo nuk arrihet duke grabitur lirinë e të tjerëve. Ti edhe tërë botën mund ta ndrysh në një burg të vetëm. Ti duke tërhequr pas fillin e saj më kot do përpiqesh për të shkruar një kryvëpër. Sepse edhe kjo thjesht është e pamundur, sepse në të vërtet asgjë më nuk është e mundur.

19.4.10

FJALË QË LINDËN TË VDEKURA

Më vonë e kuptova se gjithë kjo lëndë do të mbetet e tillë ndërkohë që mendja më nxirrte xeherorë të tjerë për të na i bërë edhe më të vështirë zbulimin nëpër to të së ardhmes. Më duket se po jetoj vetëm për hir të keqardhjes sime, kësaj ndjenje të madhe të njeriut e pafuqishme për të ndrequr botën. Fjalë të hedhura nëpër ide të fshehura megjithatë brenda tyre diçka gjej diçka të dobishme. Por dora ime është e lodhur ndërsa mendja punon me intensitet të jashtëzakonshëm. Po të ishte kjo diçka thjesht personale unë as që do kisha marrë mundimin për tu përsiatur rreth saj, sepse mund edhe të humbisja nëpër labirintin e mendjes sime. Nën akuzë tani po ve rrethanat e jetës sime që dhe ato s'mundet kurrësesi të jenë vetëm të miat. Në një sfond të gjerë shoqëror duke përzgjedhur disa kampionë prej saj, unë provova të hedh në tregun e fjalës ca fjalë të miat të cilat e rritën edhe më tepër konkurrencën, sepse mua më mungonte fuqia e reklamës. Ato sapo u shfaqën u zhytën përsëri në terr prej nga ku do të jetë e vështirë për të dalur. Dhe prej ëndërrimtarit lindi ky njeri realist që e pa veten të flakur e të përcudnuar. Kujdesi shoqëror ishte shndërruar në buxhet me një fond parash që jepte rezultate më të shpejtë të përzier me opium drogërash të shumta , që tani shiten me shumicë. Vetëm ata do t'i ngrejnë trarët e postbllloqeve për të kaluar. Ja pse unë nuk jam një viktimë e rastësishme por ndodhem këtu pikërisht si nevojë e të tjerëve,

për tu ngitur lart për të rrëmbyer prej pushtetit kredi me kushte mjaft lehtësuese. Në fakt shteti paguan jo mundin por përuljen ndaj pushtetit. Do ta quaja këtë dramë të Mosrealizimit që përgjithësisht fajin faji kryesor u faturohet ëndrrave. Ato që kishin guxuar aq shumë në atë fluturim pa fre ku njeriun e bëjnë të tërë gjithësisive. Njeriu i urtë është iracional ose siç duhet të jetë për të parandaluar katastrofat e pritshme. Këshillat e tij më së shpeshti nuk vijnë në kohë, ose marrësit ndodhen ende larg dhe do të kthehen së bashku me pendesën. Nuk gjejnë dot këtë ekuilibër të vetja sepse shenja e çmendurake e saj urtësohet papritur. Sikur unë të mos kem udhë tjetër e bëra përzgjedhjen time drejt një çmontimi të përgjakshëm, gjersa trupi ynë karakterinë të jetë martirizuar. Keqardhje për ty njeri që nuk arrite dot të bëheshe mjek për të shëruar plagët e tua. Ti kishe lindur prej një ëndrre dhe prej një ëndrre ke për të vdekur. Një pushtet të cilin ti e kishe duartrokitur nuk denjoi të vendoste mbi varrin tënd as edhe një tufë me lule.

31.1.12

FJALËT MARTIRE

Duke folur çoj ajër nëpër zgavrat e trurit. Heq ndryshkun që mund të ketë mbuluar kujtesën. Vizitat e shpeshta nëpër to e sjellin me një frymë të re fjalën tjetër. Përderisa jam gjallë dhe kur gjuha resht së foluri, zgavrat e trurit u bënë më të thella dhe kujtesa brenda tyre po çmendej. Fjala është duke e mbrojtur nëpër përplasjet e saj lëvizjen. Ajo që mund ta ndalë atë papritur me një urdhër. Brenda trurit tonë një furrë e madhe po digjet. Qoftë edhe për një fjalë të vetme që i mungon gjuhës. Qoftë edhe për një shprehje të vetme. Na lutet realiteti për t'i treguar ku ndodhet. Fjalë që bëhen hartë e përfytyrimeve. Fjalët që i mungojnë gjuhës janë fshehur edhe më thellë nëpër zgafellat e trurit. Sa herë ndjej një ngërç zhytem thellë e më thellë si palombarët. E di se përherë gjuha do më japë një mundësi tjetër. E frikshme është dalja sipër pas tërë këtyre përpjekjeve e fjalës tënde i shtohet veç një tingull i zbrazët. Sikur aty thellë të mos kenë mbetur më fjalë, gjuha sipër do kish nisur të vdiste. Kështu kanë vdekur shumë gjuhë aq sa nuk i mjaftuan as martirët e saj për të ruajtur lavdinë e saj të dikurshme. Por ka dhe fjalë që i nxjerrë me pincetë prej kujtesës si insekte të ngordhur. Fosile që çdo lidhje me to është këputur. Dhe përveçse ajo na shënon kohën e një lashtësie, na mbetet në dorë duke u lutur ta çojmë së paku në arkiva ose muze për ta ruajtur.

Maj, 2018

HERONJ TË KAPUR NË RRJETËN E HOMERIT

Po të mos kishin ndryshuar jetët tona ne s'do të ishim protagonistë të këti j takimi të çuditshëm. Do të kishim udhëtuar gati katër vjet bashkë e ndoshta edhe përmes një gjysmë shekulli dhe në krahët e njeri-tjetrit ende do të ishim duke fjetur. Ti më the se kjo mund të jetë thjesht punë e letërsisë por unë te tronditja jote ndjeja si po afrohej e shkuara e secilit prej nesh te ky çast i magjishëm. E njëjta kohë na kishte përshkuar mes për mes të dyve. Një harresë gati fatale, një mjegull që siç e çamë kështu kaq papritur e pas 40 vjetësh ballë për ballë i ishim shfaqur. Nuk ka më mure por vetëm kohë të njeriut dhe dhimbje të pashërueshme prej gurëve që na kishin sulmuar si Mojsiun. Iliada mu duk kaq e vogël sa e rreka atë në mendje me jetën e një njeriu të vetëm, pa ata shumë heronj të kapur në rrjetën e Homerit. Njeriu është përherë i lashtë dhe nuk e ndryshon dot ngjyrën e gjakut të vet dhe kur i pëlçet përmes tehut të thikës. Ai së pari do të shfaqet me frikën e vdekjes. Pak më vonë të dy u ndamë dhe dy gjysmësferat e globit u bashkuan sërish sikur asgjë të mos kishte ndodhur. Troja fle njëloj gjumë nën hirin e saj dhe ne do vazhdojmë të tjerrim po njësoj jetët tona prej përditshmërive të dënuar me vdekje. Sepse ne të dy kishim kaluar nëpër përvoja të tjera dhe sa herë zemëroheshim me të padrejtën, patëm kërkuar një rrugë tonën, por kishte qënë pothuaj e pamundur të mos zbuloje se asnjë rrugë e drejtë për

askund nuk qe hapur. Dhe duke falur ne po vinim drejt njeri-tjetrit për të futur në makinën llogaritëse gabimet dhe fajet, për të bërë një pakt të ri në kushte të tjera, sepse po vinte çasti për t'ia dorëzuar këtë përvojë të re vet Kohës.

31.1.10

PASQYRA E LËNDËS

NË VEND TË PARATHËNIES.....	3
PARA SE TË BËHET NATË.....	5
TË PARËT E MI.....	7
MIQTË E EKRANIT.....	9
NJERËZ NË UDHË.....	10
PËRBALLË TMERRIT TË FORCËS.....	11
NË NJË KËND TË UNIVERSIT.....	13
THJESHT, SEPSE JEMI TË VDEKSHËM.....	16
NJERIU I VESHUR ME BOMBA.....	17
MOSHA E NJË BURRI.....	20
URIA DHE ETJA.....	21
TRUPI I FEMRËS.....	22
PARA PASQYRËS.....	23
E FSHEHTA TORTURONJËSE.....	24
KASAFORTAT.....	25
DHIMBJA SI TUNEL I THELLË	
TURMAT SI NJË ZË I VETËM	
THIRRJE PËR NDIHMË	
NJERIU BRENDA KAFAZIT	
NJË NJERI BRENDA MEJE	
KOSTUMI	
KAPTERI	
VETJA TJETËR	
NJERËZ...	
RITMI I SHUMË KËMBËVE	

SI MUND TË MBËRRIHET GJER TEK ARSYEJA
PËRGJIGJE E PAMUNDUR
SI ISHULL
TRUPI SHQYEN RROBET E VETA
NJË TRUP BRENDA BURGUT
NË TEKNIKUMIN 'NAKO SPIRU' TIRANË
REVOLTA E PERSONALITETIT
UNË DHE UNIVERSI
DYSHIMI QË NA KTHEN NGA UDHA
CIKLI : KOHA
PËR NJË EKUILIBËR TË RI
NË ERRËSIRË ËSHTË MBJELLË FARA E DRITËS
HESHTJA SI LIBËR I PASHKRUAR
NJË ATDHE TJETËR
JETA SI NJË LUMË
PASQYRË TURBULLUESE
GJITHÇKA NIS MË PARË...
JETA NË NJË ËNDËRR
VRAPI I ÇMENDUR I MAKINAVE
NË TOKËN KU RRETET VETËM E VËRTETA
RETË...
PËRFYTYRIMI SI UDHË
PARA SE TË BËHET DRITË
TRE MANAT
EKSPRES PUBLISHING
RRETHIMI I GJELBËR
ZOGU QË LIND E VDES NË QIELL
TË SHKUARA TË LARGËTA
FIJE TË HOLLA TË PADUKSHME
NËN KURORËN E PEMËS
PËRTEJ DRITARES ËSHTË KOHË TJETËR

NJË VIZITË TË SHKUARËS SIME
KRIZË
PA MARRËVESHJE
NË PRITJE
JEHONË ZËRASH TË LARGËT
PESHA E ÇDO PËRDITSHMËRIE
PREJ NJË MAJE TË THEPISUR
TRIPTIK
DEMONI I FRIKËS
STALINI OSE ÇDO PUSHTET TJETËR
2014
LUFTA E FTOHTË
NJË FILM I PASHFAQUR ENDE
NË PARK NJË PASDITE PRANVERE
TOPI FLUTURUES
E ARDHMJA E FSHEHUR
SHPIRT I BRAKTISUR
ÇFARË DOJA TË ISHA
BOSHI
FRYMA
MË TEPËR LARG SE AFËR
Ç'LE PAS NJË ËNDËRR DUKE IKUR
KTHIM I DETYRUAR
HESHTJA
FRIKA PREJ SË SHKUARËS
RËNKIME QË VIJNË PREJ SË SHKUARËS
VULA DHE FIRMA E KOHËS
PAFUNDËSIA NDODHET PËRTEJ NJË BREGU
HISTORI QË BRAKTISET UDHËS
BOTA E PARË PREJ NJË DRITAREJE TJETËR
MAGJIA E SHKRIMIT.....

“KOMBËSIA” E LETËRSISË
NË SHTËPINË E ARTIT
NË DITËVDEKJEN E SHIMBORSKËS
ME POEZINË UDHË E MBARË DITË
PËR DERRIDANË
POETI NË BUST
ART
FJALA E LINDI NJERIUN
LERE TË PUSHOJË PENËN MBI LETËR
FJALË QË LINDËN TË VDEKURA
FJALËT MARTIRE
HERONJ TË KAPUR NË RRJETËN E HOMERIT

